

DISKURSI I LIDERIT POLITIK SHQIPTAR

Ornela Elezi

Dorëzuar:

Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale,
me profil Komunikim, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Asoc. Dr. Genciana Abazi-Egro**

Numri i fjalëve: 51431

Tiranë, Tetor, 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: **DISKURSI I LIDERIT POLITIK SHQIPTAR**, është shkruar nga unë, nuk është i prezantuar para asnjë institucioni tjetër për vlerësim, nuk është botuar në pjesë të veçanta apo si i tërë. Punimi gjithashtu nuk përmban pjesë të materialeve të shkruara nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Tiranë më, 03. 10. 2018

Doktoranti

Ornela ELEZI

Abstrakti

Dallimi në gjuhën e përditshme ndërmjet polikanëve dhe lidërshiptar nuk është i një natyre të lartë, kruciale dhe substanciale. Në të “faktet politike” dhe “faktet shoqërore” kanë shpesh diskrepanca konceptuale. Vërejmë, në fakt, në shoqëritë tona, që shumë dukuri nuk konsiderohen si politike. Vërejmë gjithashtu, që faktet jopolitike janë të politizuara. Diskursi politik i elitës politike shqiptare lë shumë për të dëshiruar si nga forma, ashtu edhe përmbajtja.

Qeveritë dhe ata që aspirojnë të qeverisin, i lejojnë parimet e tyre të stërhollohen nga rekomandimet e studiuesve të tregut. Ideologjitë dhe sistemet e vlerave braktisen në altarin e popullaritetit dhe aktiviteti i bindjes politike bëhet një reagim cinik ndaj çfarëdo gjëje që thotë sondazhi i javës. Jo vetëm politikën, por edhe liderët zgjidhen dhe hidhen sipas tekave të opinionit publik, pavarësisht cilësive të tyre intelektuale. Argumentohet se imazhi i liderit ka më shumë rëndësi se aftësitë e tij, sikurse shkathtësia e dërgimit të një mesazhi politik më tepër se përmbajtja e tij.

Tema e përzgjedhur nuk është një rastësi, përkundrazi vjen si një nevojë e brendshme për të analizuar më thellë dhe në prerje tërthore situatën e komunikimit politik dhe rolin e retorikës në politikën shqiptare. Nevojë për të parë përtej lustrës së fjalimeve, demagogjisë së momentit, kushtëzimit të situatave. Mendoj se pas më shumë se 20 vitesh pluralizëm politik, është mjaft interesante të analizohet gjuha me anë të së cilës ky pluralizëm materializohet dhe bëhet i prekshëm për publikun dhe sa kjo gjuhë ndikon në karrierën politike të secilit. Është e udhës të flasim për elementë të mirëfilltë komunikimi dhe analizën ta bazojmë tek të tillë syresh, duke mbajtur gjithmonë parasysh brishtësinë

e sistemit në fjalë, një marrëdhënie e vështirë dhe e komplikuar mes emetuesit dhe receptuesit.

Metoda e përdorur në këtë analizim është përshkruese. Kam marrë në analizë dhe përshkruar diskursin e liderëve shqiptarë. Kam ndërtuar gjithashtu edhe një intervistë me protagonistë politikë si dhe qytetarë të thjeshtë për të matur dhe konkretizuar objektin e marrë në analizë në këtë studim.

Fjalët kyçe: komunikim, diskurs, ligjërim, politik, shqiptar, fjalim, trajtim

Abstract

The difference in the everyday language between politicians and Albanian leadership is not of a high character, crucial and substantial, in both "political" and "social " facts. There are often conceptual discrepancies and substantive ones. We note in fact, in our societies, the phenomena are not considered political. We note, also, that the nonpolitical facts are politicized.

Governments, and those who aspire to govern, allow their principles to be refined by the recommendations of market researchers. Ideologies and value systems are abandoned at the altar of popularity and activity of political persuasion becomes a cynical reaction to whatever that says the survey of the week. Not only politics, but the leaders are elected and thrown by the whims of public opinion, regardless of their intellectual qualities. Is argued that the image of the leader is more important than his capabilities or his versatility of sending a political message rather than its content.

The theme selected is not a coincidence, but comes as an inner need to analyze deeper the political communication and the role of rhetoric in Albanian politics. Need to look beyond the luster of speeches, demagoguery of the moment, vesting of situations. I think that after almost 20 years of political pluralism is quite interesting to analyze the language by which this pluralism materializes and becomes vulnerable to the public and how it affects political career of each. It is appropriate to talk about the elements of authentic communication and analysis to base to such of them keeping always in mind the fragility of the system in question, a difficult and complicated relation between the issuer and receptor of the message.

The method used in this analysis is descriptive, where i describe the discourse of the Albanian leaders, by analyzing them and hence their discourse analysis methods have also built an interview with political protagonist and citizens to measure the matter and to concretize and crystallized with the country.

Key words: communication, discourse, politics, albanian, speech, treatment

Falenderim

Duke qenë mirënjohëse për të gjitha mbresat, të cilat kanë ndodhur që kur fillova studimet në UET, përvojat që kam fituar këtu do të përpiqem që t'i falënderoj disa prej shumë personave, të cilët ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia.

Falenderoj profesorin tim, mentorin Phd. Gilman Bakalli dhe Prof. Asoc. Dr. Genciana Abazi-Egro, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofruan përgjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e tyre të paçmuar në finalizimin e punimit, produkt i shumë orëve konsultimi dhe mbështetjeje. Faleminderit Profesorë!

Falenderoj familjen time për mbështetjen që më ka dhënë si dhe të gjithë miqtë e mi që më ndihmuan me anketimin dhe përpunimin e rezultateve të tij.

kushtuar familjes sime...

Me respekt,

Ornela ELEZI

Tiranë, 2018

PËRMBAJTJA

Deklarata e autorësisë	2
Abstrakti	3
Abstract	5
Falenderim.....	7
Shkurtimeve dhe simbole	11
KAPITULLI I.....	13
HYRJE	13
1.2. Diskursi konfliktual	14
1.3. Lideri politik.....	18
1.4. Metodologjia e përdorur	18
1.5. Qëllimi i punimit	20
1.6. Objekti i studimit.....	22
1.7. Hipotezat e punimit	24
1.8. Pyetjet Kërkimore.....	25
1.9. Burimet e përdorura.....	26
1.10. Përkufizimet e koncepteve kryesore të studimit.....	28
KAPITULLI II:	31
ANALIZA KRITIKE E DISKURSIT	31
2.1. Vështrim i përgjithshëm	31
2.2. Tezat e përbashkëta teorike	32
2.3. Drejtimit e ndryshme	34
2.3.1.Semiotika shoqërore	35
2.3.2.Rregullimet diskursive	35
2.3.3.Modeli socio-kognitiv	37
2.3.4.Modeli historik i diskursit.....	39
2.3.5.Grupi i Duisburgut	40
2.4. Përparësitë dhe mangësitë e Analizës kritike të diskursit.	42

KAPITULLI III:	45
PROCESI I KOMUNIKIMIT	45
3.1. Evolucion i komunikimit politik.	45
3.2. Procesi i komunikimit	52
3.3. Komunikimi politik dhe proceset demokratike	54
3.4. Diskursi politik, qëndrime dhe konsiderata	57
3.5. Komunikimi në Shqipërinë e pas viteve '90	64
KAPITULLI IV:	72
DISKURSI POLITIK, VLERAT DHE SJELLJA E LIDERIT POLITIK SHQIPTAR	72
4.1. Shekulli i ri i politikës shqiptare	72
4.1.1. Procesi politik;	72
4.1.2. Filozofia politike;	74
4.1.3. Format e organizimit politik dhe modelet e qeverisjes;	76
4.1.4. Përmasat e kulturës politike;	77
4.1.5. Politikat inovative;	79
4.1.6. E ardhmja dhe modernizimi politik në vazhdimësi;	80
4.2. Klasa e re politike në Shqipëri	82
4.2.1. Karakteristikat e ligjërimit politik në Shqipëri	87
4.3. Politika dhe vlerat politike shqiptare në qasje me komunikimin politik	85
4.3.1. Vlerat e komunikimit politik shqiptar	92
4.3.2. Etika e brendshme dhe e jashtme	95
4.4. Diskursi i politikanëve shqiptarë	97
4.5. "Politika simbolike" shqiptare e liderit politik vendor	105
4.6. Partitë e majta dhe të djathta në Shqipëri	107
4.7. Fjalori copëtues i së majtës	108
4.8. Fjalori politik i fushatës	114
4.9. Sharja në politikë	117
KAPITULLI V	122
LIDERI POLITIK, DY RASTE STUDIMI	122
5.1. Retorika e vjetër në gjuhën e re.	122

5.2. Cilësitë personale të liderit	125
5.3. A kanë liderët shqiptarë tendencën e centralizimit të pushtetit?	128
5.3.1 Kultura e komunikimit politik berishian.....	132
5.3.2 Kultura e komunikimit politik ramist	134
5.4. Pse ligjërimi politik i Tiranë është përgjithësisht i djathtë.	140
KAPITULLI VI.....	144
DISKURSI I LIDERIT NË SHQIPËRI - PYETËSORI DHE ANALIZIMI I TIJ	144
6.1. Mostra dhe modeli i anketimit.....	144
6.2. Pyetësi me qytetarë/ ekspertë/ analistë politikë	147
6.3. Pyetësor për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë.....	151
PERMBLEDHJE	153
BIBLIOGRAFIA	176
SITOGRAFIA	182

PËRMBAJTJA E FIGURAVE DHE TABELAVE

Figura 1 - Tabelë konceptuale.....	25
Figura 2. Skema	25
Figura 3 - Grafiku - A jeni të kënaqur me mënyrën se si komunikojnë liderët politikë të Shqipërisë?.....	146
Tabela 1 - A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?	147
Tabela 2 -Ligjërimi i liderëve politikë sa është konform standardeve europiane dhe sa kontribuon në krijimin e një klime relaksuese politike?.....	147
Tabela 3 - Sa ndikon në zhvillimet politike ligjërimi politik konstruktiv i liderëve?.....	148
Tabela 4 - Sa shpesh nga lista e mëposhtme, duke i vënë notën nga 1 në 10, keni pikasur të jenë përdorur nga liderët shqiptarë?	149
Tabela 5 - Pyetësor për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë.	149
Tabela 6 - A flisni ndonjë gjuhë të huaj?	150
Tabela 7 - Përvoja juaj në politikë?.....	150
Tabela 8 - Kur keni filluar punë?	150
Tabela 9 - A keni kryer ndonjë trajnim jashtë Shqipërisë?	150
Tabela 10 - A keni marrë pjesë në konferenca, seminare apo workshop-e të përbashkëta me funksionarë shtetërorë të BE, OECD mbi ecurinë e diskursit të përgjithshëm politik, lidhur me standardet europiane dhe bashkëkohore?	151
Tabela 11 - Si e vlerësoni diskursin politik të liderëve shqiptarë?.....	151
Tabela 12 - Cili është niveli i komunikimit ndërmjet zyrtarëve politikë në vend?	151

SHKURTIME DHE SIMBOLE

PD – Partia Demokratike e Shqipërisë

PS – Partia Socialiste e Shqipërisë

BE – Bashkimi European

KE – Komisioni European

KAPITULLI I

HYRJE

Diskursi politik përbën një nga llojet e ligjërimit publik. Ai përfaqëson një dukuri të përhapur dhe është një nga elementët bazë dhe të përhershëm të shoqërisë, sistemit politik, qeverisjes, marrëdhënieve politike dhe shoqërisë politike. Diskursi politik mund të përshfaqë një karakter të ndryshëm nga pikëpamja gjuhësore, psikologjike, emocionale, etike, etj.

Ne jetojmë në një epokë ku fjalët mund të kafshojnë, ku retorika zëvendëson arsyen. Gjykime të konsiderueshme shpiejnë në presionin e një reagimi të shpejtë. Gjykimet morale shpesh marrin shpjegime të shkurtra në diskutimet tona publike.

Ndërkaq diskursi publik - etika, ligji dhe e mira e përbashkët - quhet i tillë për tri arsye të thjeshta. Së pari, temat që ai mbulon kanë në qendër jetën publike. Së dyti, ne u qasemi këtyre temave duke përdorur metoda që në thelbin e tyre kanë ligjërimit publik, të hapura dhe lehtë të përtypshme për të gjithë qytetarët. Së treti, sepse në qendër të debateve tona publike janë çështjet etike – rreth të mirës dhe të keqes, të drejtës dhe të gabuarës, së ligjshmes dhe të paligjshmes.

Komunikimi politik është i vjetër sa edhe vetë politika. Në fillim me këtë term kuptohej të mësuarit e komunikimit ndërmjet sunduesve dhe të sunduarve. Më vonë shkëmbimi i diskutimeve ndërmjet politikanëve në pushtet dhe atyre të opozitës, më së shumti gjatë fushatës paraelektorale. Fusha hulumtuese zgjerohet dhe përfshihet roli i medimeve për formimin e mendimit politik, ndikimi i sondazheve sociologjike në jetën politike dhe sjelljen politike të njerëzve. Sot komunikimi politik përfshin të mësuarit e rolit të komunikimit në jetën politike në kuptim më të gjerë, që i përfshin si medimet

dhe sondazhet e mendimit publik, ashtu edhe marketingun dhe reklamën politike. Ky përcaktim i përbashkët është përqëndruar në faktin e numrit gjithnjë e më të madh të aktorëve politikë. Komunikimi politik është çdo lloj komunikimi që ka si objekt politikën. Ky përcaktim i shkurtër ka përparësi sepse përfshin dy karakteristikat më esenciale të politikës bashkëkohore: zgjerimin e sferës politike me rritjen e numrit të problemeve dhe të aktorëve të ngërthyer në fushën politike, dhe rritjen e rolit të komunikimit. Komunikimi politik jo vetëm që i shkatërron antagonizmat në politikë nëpërmjet debatit dhe nëpërmjet arritjes së konsensusit, por në fakt i jep saktësi antagonizmit politik të demokracisë bashkëkohore, e cila shprehet *në* dhe *nëpërmjet* komunikimit (dhe jo nëpërmjet, për shembull, revolucioneve). Sepse problemi më serioz sot është jo vetëm që të përkrahet modeli demokratik, por që ai të adaptohet ndaj një shoqërie, rrënjësisht i ndryshueshëm nga shoqëria ku është formuar modeli. Komunikimi politik është fushë përleshjesh e diskutimeve, të cilat kanë si objekt politikën dhe qëllimi i të cilave është pushteti i interpretimit politik të realitetit. Ideja themelore është se sot politika po e merr karakterin e vet publik nëpërmjet medimeve, domethënë politika “bëhet reale” jo nëpërmjet përvojës personale të njerëzve, por nëpërmjet pamjes së saj mediale.

Në mënyrë që të kuptojmë procesin efektiv të lidershit na duhet të kuptojmë rëndësinë e etikës në politikë e cila ndikon në marrëdhëniet në grup dhe impaktin që kanë drejtuesit.

1.1. Diskursi konfliktual

Ne nuk jetojmë në një vend neutral, ndonëse kemi privilegjin e të qenit në “shtëpinë tonë”. Mosmarrëveshjet dhe përplasjet ideologjike dhe praktike në të gjitha fushat e jetës shqiptare kanë nevojë për një çelës që do të zgjidhte shumë probleme të mbartura nga e kaluara dhe të lindura rishtaz. Ky çelës është komunikimi, i cili ndihmon për një përpunim konstruktiv të konfliktit. Këtë mënyrë funksionimi na kërkojnë edhe ndërkombëtarët, të

cilët bëjnë sondazhe dhe studime pa fund rreth konflikteve “made in Albania”. Mbase do të ishte disi e çuditshme të arrish që në fillim në përfundimin se shumë studiues vendas (profesorë ose mendimtarë) dhe vëzhgues të realitetit (siç janë gazetarët ose analistët) janë marrë shumë pak me zgjidhjen e konfliktit dhe e vërteta është se hulumtimet dhe përjasjet e tyre kanë mbetur thjesht te burimi dhe pasojat e fenomenit. Ata kanë treguar se komunikimi në konflikt është i penguar dhe shumë i kufizuar. Komunikimi luan një rol vendimtar në të gjitha metodat për zgjidhjen e problemeve të njëpasnjëshme, ndaj dhe përcaktimi: “Ai që të flet, nuk të gjuan!” merret si një teori a priori, tashmë e pranuar nga të gjithë, por që praktikisht realiteti ynë na ofron një imazh tjetër. Tek ne, ata që flasin jo vetëm të gjuajnë, por edhe të minojnë personalitetin, të diskreditojnë në mes të rrugës, duke thyer çdo normë etike dhe jetike. Premisa e parë për këtë këndvështrim do të ishte si të përpiqemi të kuptojmë se çfarë mendon tjetri. Por kërcënimet, fajësimet, pretendimet e tij nuk do të kishin vend kur ai nuk përdor dialogun dhe argumentin. Çështja më e rëndësishme që kërkon zgjidhje të menjëhershme është si mund të ndihmojë procesi i komunikimit për të vënë në vijë personat konfliktualë. Jam e mendimit se komunikimi redukton konfliktin përmes modelit të të shpjeguarit dhe të kuptuarit. Në këtë model bëhet fjalë për rregulla të përgjithshme në një zgjidhje konflikti dhe në një komunikim të ndershëm. Respekti reciprok dhe mirëkuptimi i ndjerë mundësojnë një përpunim konflikti pa “të humbur”.

Nga një konstatim i thjeshtë, vihet re se edhe në konflikt, forma më e preferuar e komunikimit është biseda përballë-vënese.

Përmendim këtu përballjen me Sali Berishës dhe Fatos Nanos në vitin 2002 në “Opinion” në Tv Klan, i cili u konsiderua edhe si debati më i famshëm dhe më i ndjekur në vend. Dy liderët politikë të asaj kohe “rrahën” mendimet ballë për ballë, nën

moderimin e gazetarit të emisionit Blendi Fevziu. Ishte hera e parë që liderët politikë të dy partive kryesore të vendit ballafaqoheshin në një përballje televizive, në një kohë kur kishte kaluar shumë nga viti i mbrapshtë 1997. Filozofitë dhe mendimet e ndryshme politike që i ndanin ishin të mëdha, por në fund të emisionit, debati u mbyll me një shtrëngim duarsh Nano-Berisha.

Emisioni “Opinion” është një nga ato programe televizive që synon pikërisht përballë-vënien e mendimeve të kundërta. I ideuar në atë mënyrë që personazhet pjesëmarrës në emision, në mënyrë krejt të natyrshme të gjenden në një debat, ku secili mbron tezën e tij duke sjellë argumente e fakte që synojnë hedhjen dritë mbi një çështje të caktuar.

Palët shpresojnë të realizojnë qëllimin e tyre, sepse situata e padëshiruar nuk ndryshon. Si shembull për të ilustruar le të marrim debatin më të fortë që po zhvillohet në vendin tonë, pra debatin politik. E marrim këtë model komunikimi edhe për vetë faktin, se palët janë në konflikt me njëra-tjetrën, madje në mënyrë të pandërprerë.

Por a e respektojnë ato parimin e komunikimit etik dhe transparent? Përgjigja do të ishte “jo”, sepse në këtë lloj komunikimi ka një parim të rëndësishëm, që thotë se lidhja nuk dëmtohet. Përkundrazi përmes komunikimit të ashpër dhe jashtë normave etike, politikanët japin mesazhin e ndarjes dhe të “luftës që nuk mbaron”. Çështja e komunikimit në konflikt nuk është aq e thjeshtë, por as shumë e vështirë në dukje. Karakteri ekscentrik i folësve në debate konfliktuale përballë një mjedisi konfliktual në formën dhe përmbajtjen e tij, nuk lë hapësirë për të dhënë një sugjerim të rëndësishëm që fatkeqësisht nuk zbatohet. Biseda të përgjithshme paraprake, të cilat shërbejnë për të përgatitur situatën, për të caktuar vende, orare dhe metoda pa tematizuar drejtpërdrejt vetë konfliktin do të ishin një nga ilaçet më të mira që do të shëronin sëmundjen tonë

dominuese në komunikim. Vini re folësit kur flasin me zë të lartë, ata nuk shprehen qartë dhe në mënyrë personale në thëniet e tyre, nuk arrijnë dot të shmangin mesazhet nënvlerësuese drejtuar bashkëbiseduesit, nuk e dëgjojnë tjetrin në mënyrë aktive dhe më e çuditshmja është se nuk arrijnë të njohin rrugëmbylljet e komunikimit, duke mos i shndërruar ato në dëgjim aktiv. Është e kuptueshme se në konflikt kemi të bëjmë me një komunikim të pastrukturuar mes palëve që përfundon shumë shpejt në një përshkallëzim të pakontrolluar të zënkave, fyerjeve dhe veprimeve të dhunshme (kujtoni fjalët rrugaçërore dhe grushtet e shkelmat që transmetohen në ekranet tona). Nëse do t'i referohemi studiuesit Thomas Gordon, i cili flet gjerësisht për konfliktin, dhe t'i përqasim idetë e tij me mjedisin shqiptar, do të na dukej shumë abstrakte zgjidhja që na jep: “Fund konfliktit i jepet nga komunikimi i ndershëm dhe i hapur” – pohon ai (Gordon, Th. 2000). Kjo do të thotë se qëllimi është të mësosh, se si mund të përpiqesh të plotësosh nevojat e tua pa shkelur nevojat e të tjerëve, në mënyrë që kështu të parandalosh frustrimin dhe nënshtrimin, të hapesh vetë (nevojat, ndjenjat, dëshirat, efektet e sjelljes së të tjerëve mbi mua) në vend që të analizosh apo të vlerësosh të tjerët. Ky është një koncept shumë humanist, prandaj problemi është më serioz se kaq, kur ne shqiptarët e dimë mirë se “nuk marrim vesh me të mirë” kur jemi në konflikt.

Në komunikimin konfliktual, qëllimi nuk ndërpritet për t'i lënë vend informimit dhe mirëkuptimit, saqë mund të parashtrojmë edhe pyetjen se a bëhet fjalë me të vërtetë për komunikim apo për luftë fjalësh. Qëllimi themelor bëhet dominimi, cilësimi (në llogari të tjetrit), përjashtimi. Gjuha shërben për betejë, fitore, sulm, kryengritje. Por ajo gjithashtu ka funksione të gjuhës që ekzistojnë bashkë me ato të përgjithshmet, të cilat i përmban në vetvete dhe të cilat dalin nga përmbajtja e komunikimit–shkëmbimit, informimi dhe kodi i përbashkët, domethënë mirëkuptimi.

1.2. Lideri politik

Liderët paraqesin faktorin më të rëndësishëm të zhvillimit të shoqërisë. Nga iniciativa dhe aktiviteti i tyre varet zhvillimi i ekonomisë dhe i shoqërisë së një vendi. Mënyra e sjelljes së liderëve ndaj vartësve për arritjen e objektivave të përcaktuara, apo siç quhet ndryshe stili i lidërshiptit ndërmarrës, varion nga njëri lider tek tjetri, si dhe në varësi të stilit të përdorur për arritjen e qëllimeve apo objektivave afatgjatë. Ajo çka i karakterizon të gjithë liderët është diskursi i tyre, duke i bërë ata përgjithësisht unikë dhe të veçantë për nga stili, temat e trajtuara, intonacioni dhe gjestikulacioni. (Bonsignori V. 2016).

Shumë nga problemet në shoqëri sot janë pjesërisht rezultat i lidërshiptit të papërgatitur për t'u përballur me kompleksitetin e realitetit të sotëm. Idetë moderne të lidërshiptit zakonisht bazohen mbi modele ushtarake ose mbi modele të mëpareshme politike. Zakonisht aftësitë e një lideri kërkohen në kohët kur ka vështirësi ose kur qëllimet ndryshojnë ose thellohen. Nëse asgjë nuk është duke ndryshuar, kërkohet supervizion, dhe jo lidërship. Liderët paraqesin faktorin më të rëndësishëm të zhvillimit, nga iniciativa e tyre varet suksesi i shoqërisë, pasi lidërshipi, si pjesë e rëndësishme e organizatës, duhet të reflektojë dhe prezantojë cilësitë më të mira drejtuese në arritjen e suksesit nëpërmjet organizimit të një grupi njerëzish për të arritur qëllimin e përbashkët.

1.3. Metodologjia e përdorur

Studimi kryhet përmes përdorimit në kombinim të dy metodave.

Metoda analitike – e cila analizon fjalimet, deklaratat, dokumentet e politikanëve; vlerat dhe normat e shoqërisë politike; sjelljen dhe qëndrimet e individit dhe shoqërisë shqiptare.

Metoda “krahasuese” – e cila analizon diskursin e politikanëve, vlerat/normat e shoqërisë politike, qëndrimet e individit dhe shoqërisë shqiptare përmes krahasimit të tyre me njëri-tjetrin dhe ndër vite.

Liderët politikë (partiakë, qeveritarë, parlamentarë) janë zgjedhur si raste studimore sepse ata shfaqin tipare të përbashkëta dhe të ndryshme.

Tiparet e përbashkëta të tyre përfshijnë këto elementë: 1) janë gjenerues diskursi, 2) etika e diskursit të tyre reflekton karakter problematik dhe 3) karakteri problematik i diskursit politik vihet re si kur janë në qeverisje (në pushtet), ashtu edhe kur nuk janë (në opozitë), si në parlament edhe jashtë në publik, apo në prononcime qoftë si individ privat, qoftë si person publik.

Tiparet e ndryshme të tyre përfshijnë: 1) shkalla e joetikës dhe 2) raporte të ndryshme me shoqërinë politike, individin, shoqërinë shqiptare

Ky kampion është përfaqësues tipik i klasës “politikanë-lider”. Periudha e marrë në analizë është nga ndërrimi i sistemit politik deri më sot. Është zgjedhur 1992 për shkak të pranimi të së drejtës së lirisë së shprehjes, gjë që nuk lejohej nga sistemi i mëparshëm politik.

Ky studim, për të analizuar karakterin e diskursit politik, marrëdhëniet lider – individ - shoqëri politike - shoqëri shqiptare si dhe efektet e këtyre marrëdhënieve mbi diskursin politik në Shqipëri, mbështetet në të dhëna dhe shifra që gjenerohen nga fjalime, deklarata, debate, prononcime të bëra në parlament, publik, media; nga pyetësorë dhe database që reflektojnë vlerat, normat, qëndrimet e individit, shoqërisë politike, shoqërisë shqiptare, lidërshiptit politik shqiptar.

Studimi fokusohet në marrëdhëniet e diskursit të liderit politik shqiptar. Gjithashtu ky punim ka për synim t’u japë përgjigje disa çështjeve të shprehura si kërkesa në pyetjet kërkimore që lidhen me trajtimin metodologjik, analitik si dhe funksional të diskursit politik, vlerat dhe sjellja e liderit politik shqiptar, diskursin e liderit, vlerat dhe normat e shoqërisë politike shqiptare si dhe diskursi i liderit në kontekstin e vlerave dhe

sjelljes se individit dhe shoqërisë.

Gjatë punimit është përdorur metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave, gjerësisht është përdorur pyetësi për mbledhjen e të dhënave. Kjo më ka ndihmuar për ta bërë më të lehtë krahasimin e variablave të ndryshme të përdorura për të testuar hipotezat e parashtruara. Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave në terren mbështetet në zhvillimin e intervistave në terren me persona të angazhuar në politikë dhe qytetarë/ekspertë të komunikimit apo analistë politikë. Pas analizimit të të dhënave sekondare, pra materialeve editoriale, kam ndërmarrë hulumtim në terren, ku jam përpjekur të identifikoj gjendjen nga terreni përmes matjes së variablave. Kjo përmes realizimit të intervistave të cilat synojnë vërtetimin të hipotezave.

Metodë tjetër e përdorur në këtë punim është metoda përshkruese, përmes së cilës janë përshkruar konceptet, parimet dhe konstatimet nga autorë të ndryshëm të përmendur në pjesën e rishikimit të literaturës.

Përmbledhtazi metodat e përdorura janë:

- Metoda analitike e studimit të procesit të dikursit politik të liderit shqiptar.
- Metoda krahasuese e të dhënave të nxjerra nga intervista me persona të angazhuar në politikë dhe qytetarë, ekspertë të komunikimit apo analistë politikë.
- Metoda e vlerësimit kritik - paraqitja e problemeve dhe rekomandimeve rreth kësaj çështjeje që do të ndihmojnë në evidentimin e gjendes së trajtuar.

1.4. Qëllimi i punimit

Diskursi politik në Shqipëri është marrë në studim për shkak të disa dukurive që vihen re në të:

Dukuria e parë: Karakteri problematik i diskursit politik shqiptar përse i përket terminologjisë (joetike, përdorimi i sharjeve).

Dukuria e dytë: Influenca negative e liderit politik mbi komunitetin dhe shoqërinë.

Dukuria e tretë: Korrelacioni midis karakterit të diskursit politik dhe karakterit të dobët të demokracisë shqiptare.

Dukuria e katërt: Vihen re marrëdhëniet lider – shoqëri politike – individ – shoqëri në përgjithësi.

Qëllimi i këtij punimi është që të evidentojë diskursin që përdorin liderët dhe rëndësinë e zhvillimit të kulturës së diskursit në shoqërinë politike shqiptare;

Të pasqyrojë diskursin e lidërshiptit shqiptar përmes analizës metodologjike analitike, përshkruese, krahasuese; të konkretizojë procesin dhe rëndësinë e diskursit në mbarëvajtjen politike në shoqëri;

Të analizojë diskursin e lidërshiptit shqiptar dhe ndikimin e këtij diskursi në jetën sociale dhe politike të qytetarëve, duke u bazuar në instrumentin matës të formuar përmes përzgjedhjes së deklaratave publike të liderëve vendorë;

Të analizojë diskursin publik të lidërshiptit shqiptar të kushtëzuar nga deklaratimet publike. Në këtë aspekt diskursi politik shihet në këto kontekste: parlament, fushatë elektorale, fjalime politike në parti/media.

Synohet që përmes përdorimit të metodave shkencore të hulumtimit të identifikohen dimensionet që ndikojnë në diskursin politik të lidërshiptit shqiptar, identifikimi i metodave të përhapjes së mesazhit politik dhe impaktit që ka në jetën sociale dhe politike të qytetarëve shqiptarë.

Në klasën e “Liderit politik” ky studim përfshin këto rrange politikanësh: kryetar partie; anëtar kryesie; funksionar shtetëror; kryeministër; ministër; funksionar politik; kryetar/sekretar partie; kryetar grupi parlamentar; anëtar parlamenti.

Logjika që i jep jetë këtij studimi lidhet me tentativën për të trajtuar aspektet kryesore dhe fizionominë që gjuha politike shqiptare ka marrë në disa momente të fundshekullit të shkuar dhe në këtë fillimshekull, me vetëdijen që asgjë më shumë se stili gjuhësor nuk i lidh më së miri këto dy epoka të historisë së politikës shqiptare, kalimet nga një kulturë në tjetrën, nga një kohë në tjetrën, nëpërmjet një çelësi siç është ai i retorikës, që përfaqëson tërësinë e një metode, një teorie dhe një teknike bashkë. Ky studim, pra, siç dukshëm vihet re edhe nga titulli, do të kontribuojë në nxjerrjen në pah dhe analizën e diskursit politik dhe synon ta analizojë e të hedhë dritë mbi këtë fenomen nga dy pikëpamje:

- Njëra anë ka të bëjë me dinamikën (shkallë/tendenca);
- Ana tjetër ka të bëjë me faktorët;

1.5. Objekti i studimit

Por çfarë është saktësisht diskursi politik?

Diskursi politik përcaktohet dhe identifikohet nga aktorët apo autorët e tij, politikanët. Pjesa më e madhe e studimeve mbi diskursin politik flet për të shkruarit e të folurit e politikanëve dhe të institucioneve politike, si presidenti, kryeministri, të tjerë anëtarë të kabinetit qeveritar, parlamenti apo partitë politike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Politikanët në këtë kuptim janë grupe individësh që paguhen për aktivitetet e tyre politike, të cilët përzgjidhen apo emërohen (apo vetëemërohen) për të qenë në qendër të lojës politike. Kjo mënyrë e të përcaktuarit të diskursit politik është rrënjësisht e ndryshme

nga ajo e të përcaktuarit të diskursit mjekësor apo ligjor me aktorët respektivë pjesëmarrës.

Studimi i diskursit politik ka vlerë në dy dimensione: teorik dhe praktik.

Në aspektin teorik, fenomeni është intrigues për tri arsye: Dallimet në diskursin politik dhe interesi i studiuesve për ta shpjeguar atë dhe perspektivat; Faktorët me të cilët shfaq marrëdhënie; Tiparet e faktorëve dhe grupet e faktorëve sipas secilës perspektivë; Debate që bëhen (pyetjet që ngrihen) dhe argumentet që ofrohen (tezat që mbrohen);

Nga pikëpamja praktike fenomeni është intrigues për shkak të impaktit mbi komunitetin, shoqërinë dhe cilësinë e demokracisë së një shoqërie.

Ky studim e analizon diskursin politik nga një perspektivë socio-politike dhe të komunikimit. Në qendër të analizës janë marrëdhëniet mes diskursit politik, vlerave dhe sjelljes së liderit politik, vlerave dhe normave të shoqërisë politike, si dhe sjelljes e qëndrimeve të individit dhe shoqërisë. Studimi zgjedh të analizojë diskursin politik në kontekstin e këtyre marrëdhënieve për tre arsye bazë:

Së pari, për shkak të besimit se ndonëse diskursi politik ka lidhje dhe mund të influencohet nga shumë faktorë të natyrës gjuhësore, psikologjike, ligjore, ekonomike, e kulturore, ai influencohet dhe përcaktohet në një masë të konsiderueshme edhe nga marrëdhëniet që ekzistojnë mes liderit politik nga njëra anë dhe individit, shoqërisë politike dhe shoqërisë në përgjithësi, në anën tjetër.

Së dyti, për shkak të besimit se vlerat dhe sjellja e liderit politik reflektojnë edhe marrëdhënien që ekziston midis shoqërisë politike dhe individit e shoqërisë në përgjithësi.

Së treti, për shkak të besimit se si diskursi i liderit politik, ashtu edhe vlerat dhe normat e shoqërisë politike reflektojnë në esencën dhe bazën e vet, vlerat dhe qëndrimet e individit dhe të shoqërisë.

Ngritur mbi këto tri premisa, studimi e analizon diskursin politik nga pikëpamja e shkallës, tendencave dhe karakterit të tij.

Diskursi shihet i lidhur me rolin dhe influencën e shoqërisë politike e shprehur në kulturën e kësaj të fundit, si dhe të individit dhe shoqërisë të shprehur në vlerat dhe besimet që qëndrojnë në themel të sjelljes së tyre sociale dhe vlerësimit e qëndrimit të tyre ndaj politikës.

1.6. Hipotezat e punimit

Ky model konceptual tregon marrëdhënien mes diskursit politik dhe klasës politike, kulturës politike, lidërshit politik, mesazhit, transmetuesit dhe marrësit. Efektiviteti të cilit i referohet termi të bësh/thuash atë që duhet në kohën dhe mënyrën e duhur, element i cili përcakton diskursin politik përmes mënyrës, formës së transmetimit të mesazhit të lidërshit politik.




Figura 1 - Tabelë konceptuale

Hipotezat:

Ky studim ngrihet mbi këto supozime bazë:

H1: Në formimin e diskursit politik të Shqipërisë luan rol të rëndësishëm edhe kultura dhe në veçanti kultura politike, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në formëzimin e diskursit politik në Shqipëri.

H2: Lidershipi politik ka një ndikim të madh në karakteristikat dhe veçoritë që ka fituar diskursi politik në Shqipëri pas viteve '90.

1.7. Pyetjet kërkimore

Kur flasim për komunikimin rëndom kuptojmë shkëmbimin e informatave, njohurive, mendimeve, vlerësimeve dhe interpretimeve. Vetë termi “komunikim” na

shpie në një realitet social, te i cili shkëmbehen informata që merren, kapen dhe transmentohen nga të gjithë pjesëmarrësit në aktin e komunikimit.

Njëkohësisht me këtë, konflikti, lufta, rivaliteti janë përditshmëri që i krijon shoqëria. Mbetet të supozojmë se edhe në lëmin e linguistikës, përkatësisht të gjuhës, nuk është çdo gjë harmonike.

Kjo tezë na shpie drejt pyetjeve:

1. Si është ndërtuar diskursi politik në Shqipëri?
2. Si lind dhe funksionon komunikimi konfliktual, nga se dallon nga ai jokonfliktual dhe a ka lidhje komunikimi konfliktual me kulturën politike shqiptare?
3. Sa ndikon diskursi politik në mbarëvjetjen e jetës sociale dhe politike të qytetarëve?
4. Si ka ndikuar ligjërimi i Berishës në diskursin politik?
5. Si ka ndikuar ligjërimi i Ramës në diskursin politik?
6. A ndikojnë cilësitë personale të liderit në ligjërimin e tij?

1.8. Burimet e përdorura

Në këtë pjesë të punimit paraqiten burimet e referimit dhe literatura e përdorur, duke u bazuar në libra shkencorë dhe akademikë, në revista shkencore dhe profesionale dhe në punime, të botuara në Konferenca ndërkombëtare shkencore në lidhje me diskursin politik, lidershipin në politikë, kulturën, etikën, influencën në grup, rritjen, stilet e lidershipit.

Po ashtu kam shfrytëzuar edhe burimet e verifikuara të referimit nga interneti si dhe gjetjet dhe të dhënat e mbledhura në vendngjarje me anë të mënyrave të ndryshme, të anketimit dhe intervistimit.

Shtjellimi teorik paraqitet prej artikujve të botuar, kapitujve të librave deri tek monografite dhe antologjite që kanë lidhje me këtë disertacion.

Liderët i kryejnë rolet e tyre në stile të ndryshme: autokratikë, demokratikë, pjesëmarrës, laissez-faire (liberalë) etj. Shpesh, stili i lidershipit varet nga situata, duke përfshirë dhe ciklin e jetës së politikës.

Komentet dhe analizat e bëra nga studiuesit Arnold dhe Robertson (1998), Katz dhe Kahn (1978) dhe Mullins (1999) konkludojnë se elementët bazë të cilat ndikojnë në suksesin dhe zhvillimin e lidershipit janë: kultura kombëtare, ndryshimet kulturore, mënyrat/format e sjelljes dhe së fundmi stilet e drejtimit.

Çdo mjet i ri i komunikimit ka transformuar thellësisht kulturën dhe shoqërinë. Të kuptuarit se si teknologjite e komunikimit të së kaluarës kanë ndikuar ndryshimet shoqërore, është mjet për të kuptuar ndryshimet sot dhe për t'u përpjekur për t'i adresuar ato (M. Marshall, 1994).

Temat kryesore të komunikimit politik të trajtuara nga akademikë të ndryshëm të shkencave politike dhe sociale, lidhen në pjesën dërrmuese me tema të tilla si: 1. Procesin e Marketingut dhe impakteve në Komunikimin Politik dhe demokratizimit të medias, (Maarek 1995, Dalhren 2009, Mazzoleni dhe Scultz 1999, etj); 2. Problematikat e pronarëve politikë të mediave dhe komercializimit të tyre, (Bennet 2008, McNair); 3. Problematikat dhe pasojat e “ndërtimit” të lajmit, teknikat bindëse të komunikimit politik, (Grabes, Smith 2005); 4. Teoritë konjiktive në lidhje me perceptimin e mesazheve politike, (Goldstein, Fredman, 2002); 5. Procesin e komunikimit në zgjedhjet elektorale, (Sh. Iyengar, A. F. Simon 2000); 6. Komunikimi politik në erën e mediave sociale, (Norris 2009, Kushin dhe Yamamoto 2008, Grabes 2011 etj.);

Mes eksperimenteve të kryera rreth efektshmërisë së komunikimit politik dhe menaxhimit të impresionit politik tek votuesi janë edhe studimet e Rosenberg dhe MC Caferty dhe De Landsheer dhe De Vries (Christ De Landtsheer, Philippe De Vries & Dieter Vertessen 2008).

Teoritë e sotme në kuadër të shkencave të ligjërimit, që trajtojnë marrëdhënien mes politikës e gjuhës, kanë parasysh perspektivën e mësipërme. Meqenëse shumë frytdhënese për analizën në fushën e politikës, çështja e marrëdhënies së ligjërimit publik dhe pushtetit shpesh injorohet në literaturën e shkencave politike (Chilton, 2004).

1.9. Përkufizimet e koncepteve kryesore të studimit.

a. Ligjërimi:

I referohet mënyrës se si ne mendojmë dhe komunikojmë me njerëzit, gjërat, organizimin e shoqërisë dhe marrëdhëniet mes të treve. Diskursi zakonisht shfaqet nga institucionet sociale si media dhe politika (ndër të tjera) dhe në sajë të dhënies së strukturës dhe rendit të gjuhës dhe të mendimit, ai strukturon dhe urdhëron jetët tona, marrëdhëniet me të tjerët dhe shoqërinë. Kështu formon atë që ne jemi në gjendje të mendojmë dhe të dimë çdo moment e kohë. Në këtë kuptim, sociologët e rregullojnë diskursin si një forcë prodhuese, sepse ai formon mendimet, idetë, besimet, vlerat, identitetet, ndërveprimet me të tjerët dhe sjelljet tona. Kësisoj, ai prodhon shumë nga ato që ndodhin brenda nesh dhe brenda shoqërisë.

b. Ligjërimi politik:

Është një tekst i përcaktuar nga tema e shprehjes dhe pohimit të interesave të subjekteve politike që kuptohen në një situatë të komunikimit politik.

Ligjërimi politik është një fushë e ligjërimit e cila fokusohet në forume politike, siç janë debatet, fjalimet dhe seancat, si fenomen me interes.

Ndoshta më shumë se çdo lloj tjetër diskursi, diskursi politik është thelbësisht ai më ideologjiku. (Van Dijk, 2006)

c. Ligjërimi konfliktual:

Është ai ligjërim në të cilin qëllimi nuk ndërpritet për t'i lënë vend informimit dhe mirëkuptimit, saqë mund të parashtrojmë edhe pyetjen se a bëhet fjalë me të vërtetë për komunikim apo për luftë fjalësh. Qëllimi themelor bëhet dominimi, cilësimi (në llogari të tjetrit), përjashtimi. Gjuha shërben për betejë, fitore, sulm, kryengritje.

d. Lidershipi:

Është arti ose procesi i influencimit mbi njerëzit me qëllim që përpjekjet e tyre të orientohen drejt arritjes së objektivave të organizatës (Llaci, 2010).

e. Lidershipi transformues:

Është lidshipi që sjell ndryshime në individë e sisteme shoqërore. Në formën e tij ideale, krijon një ndryshim të vlefshëm dhe pozitiv tek pasuesit me qëllimin përfundimtar të kthimit të ndjekësit në udhëheqës. Udhëheqja transformuese rrit motivimin, moralin dhe performancën e pasuesve përmes një shumëllojshmërie mekanizmash. (Bass, Avolio, 1994).

f. Lidershipi transaksional:

Është ai lidship që përdor mekanizmin e kontrollit dhe shpërblimeve për të motivuar në nivel të jashtëm vartësit e tij (Bass, Avolio, 1994).

g. Lidership laissez-fair:

Është lloji i liderit që në vetvete orientohet drejt mungesës ose shmangies së udhëheqjes. Udhëheqësit laissez-faire nuk marrin vendime, i vonojnë veprimet, injorojnë përgjegjësitë, nuk përdorin asnjë lloj pushteti dhe shmangen duke mos u përfshirë. (Bass dhe Riggio, 2006).

h. Përshtatshmëria:

Është shkalla me të cilën një politikan ka aftësinë për të ndryshuar sjelljen, strukturat dhe sistemet, me qëllim mbijetesën në vijim të ndryshimit mjedisor, si përgjigje ndaj kushteve të jashtme (Denison, Mishra, 1995).

i. Përfshirja:

I referohet nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën politike, si dhe krijimin e ndjesisë së pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në jetën politike (Lawer, 1996 Gillespie, 2007).

j. Polemika:

Na shpie te ideja e konflikteve verbale ndërmjet politikanëve. Por konflikti nuk është karakteristikë vetëm për elitën politike, ai funksionon në të gjitha nivelet e shoqërisë.

KAPITULLI II:

ANALIZA KRITIKE E DISKURSIT

2.1. Vështrim i përgjithshëm

Marrëdhënia mes ligjërimit dhe politikës është trajtuar qysh nga filozofët e kohës antike. Platoni kishte shprehur frikën nga pushteti fiktiv i gjuhës në shtetin ideal. Retorika klasike merrej me marrëdhënien mes përsiatjes së të vërtetës dhe moralit, dhe i frikësohej mundësisë që ofronte gjuha për keqpërdorimin e pushtetit. Teoritë e sotme në kuadër të shkencave të ligjërimit që trajtojnë marrëdhënien mes politikës e gjuhës, kanë parasysh perspektivën e mësipërme. Meqenëse shumë frytdhënëse për analizën në fushën e politikës, çështja e marrëdhënies së ligjërimit publik dhe pushtetit shpesh injorohet në literaturën e shkencave politike (Paul Chilton, 2004). Kjo temë ka gjetur vend në kuadër të shkencave të ligjërimit dhe është objekt i kërkimeve në gjuhësi që nga vitet '60. Për të shpjeguar e qartësuar marrëdhënien mes ligjërimit e politikës kanë kontribuar veçanërisht gjuhësia kritike dhe analiza kritike e diskursit. Megjithëse që të dyja koncentrohen në kritikën e përdorimit të gjuhës ato dallohen në një pikë: sipas përfaqësuesve të gjuhësisë kritike, ideologjitë mbështesin riprodhimin e marrëdhënieve aktuale të pushtetit, përderisa analiza kritike e diskursit shkon më tutje dhe e trajton rolin e gjuhës edhe gjatë konstruktimit dhe transformimit të marrëdhënieve të pushtetit. Përfaqësuesit e analizës kritike të diskursit bazohen në tezat e gjuhësisë kritike dhe i zhvillojnë e i thellojnë më tutje ato në studimet e tyre.

Nga aspekti i rregullimeve shoqërore, studiuesit e analizës kritike të diskursit mbështeten para së gjithash në punimet e Shkollës së Frankfurtit dhe përfaqësuesve të teorisë kritike shoqërore si: Teodor Adorno, Marx Horkheimer, Herbert Markuse, Jürgen

Habermas, Stuart Hall dhe Pierre Bourdieu. Për kornizën teorike të Analizës kritike të diskursit janë të rëndësishme, gjithashtu, traditat e kritikës ideologjike të Althusser dhe Gramscit, sipas të cilëve çdo përdorim i gjuhës në politikë është ideologjik dhe i nënshtrohet luftës së klasave. Disa përfaqësues të analizës kritike të diskursit mbështeten para së gjithash në teoritë e pushtetit të Foucault-së (*Foucault, 1982*). Përfaqësuesit e analizës kritike të diskursit, në studimet e tyre, mëtojnë të dëshmojnë e shpjegojnë ndërvlerësinë ndërmjet gjuhës, kulturës e politikës dhe vënë bazën për një vështrim kritik të përdorimit të gjuhës e komunikimit në politikë. Analiza kritike e diskursit e nënkupton gjuhën e shkruar dhe të folur si një praktikë shoqërore, e cila jo vetëm që reflekton marrëdhëniet shoqërore, por edhe i konstrukton dhe organizon ato. Nga teza teorike mbi konstituimin e dyanshëm të diskursit dhe realitetit shoqëror, rrjedh detyra e analizës kritike të diskursit që në njërin anë të nxjerrë në pah e të sqarojë ndërvlerësinë mes mjeteve gjuhësore e ngjarjeve diskursive, dhe në anën tjetër të sqarojë ndikimin e ndërsjellë të praktikave diskursive dhe realitetit politik e shoqëror. Në këtë pikë dalin në pah dy veçori të interesit kërkimor: pushteti mbi diskursin dhe pushteti i vetë diskursit (Van Dijk T. 1993). Megjithatë analiza kritike e diskursit deri më tani nuk ka ndonjë koherencë sa i përket bazamentit të saj teorik, metodologjisë si dhe marrëdhënies së saj me fushat e tjera studimore (përfshirë këtu gjuhësinë, sociologjinë, sociolinguistikën dhe politologjinë), ekzistojnë teza teorike të cilat janë të përbashkëta për të gjithë studiuesit e kërkimet në këtë fushë.

2.2. Tezat e përbashkëta teorike

Analiza kritike e diskursit sipas Wodak “nuk ka qenë asnjëherë dhe nuk përpiqet të jetë, apo të ofrojë një teori të vetme apo specifike” (Wodak R., 2006: 2). Drejtimet e ndryshme brenda kësaj disipline dëshmojnë se ato kanë disa të përbashkëta në aspektin e tezave

teorike dhe qëllimeve të tyre. Kështu shumica e studiuesve në punimet e tyre shkencore marrin për bazë, apo mëtojnë të dëshmojnë se:

1. Diskurset janë ideologjikë dhe nuk ekziston arbitraritet i shenjës gjuhësore;

2. Në fokus nuk është gjuha si sistem, por si ligjërim, si pjesë e proceseve kulturore dhe shoqërore. Objekt studimi i Analizës kritike të diskursit janë problemet që janë të natyrës jogjuhësore, në të vërtetë realiteti shoqëror. Koncepte qendrore janë ideologjitë dhe pushteti. Si pjesë përbërëse e politikës këto dy kategori ndërlidhen me gjuhën. Gjuha mund të jetë objekt konfliktesh dhe të reflektojë asimetri shoqërore, por edhe t'i krijojë ato. Gjuha mund të shërbejë si barrierë për të ardhur në pushtet dhe për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes.

3. Analiza kritike e diskursit e vëzhgon marrëdhënien mes gjuhës dhe shoqërisë jo vetëm si një rrugë njëdrejtimëshe, në kuptimin që gjuha reflekton strukturat shoqërore, por ajo e sheh këtë marrëdhënie si të dyanshme. Sipas Fairclough: “Diskursi formohet dhe konstruktohet nga strukturat shoqërore në kuptimin më të gjerë dhe në të gjitha nivelet: nga marrëdhëniet klasore dhe nga marrëdhënie të tjera shoqërore, nga marrëdhënie specifike të institucioneve të caktuara, nga sistemet e klasifikimit, nga norma dhe konvencione të ndryshme të natyrës diskursive dhe jodiskursive. Në anën tjetër diskursi formon shoqërinë. Diskursi kontribuon në formimin e të gjithë atyre dimensioneve të strukturave shoqërore, të cilat në mënyrë direkte apo indirekte e përbëjnë atë: normat dhe konvencionet e saj, e gjithashtu edhe marrëdhëniet, identitetet dhe institucionet të cilat qëndrojnë pas tyre” (Fairclough, 1992: 64).

4. Analiza kritike e diskursit e analizon diskursin në procesin e tij dinamik dhe historik. Gjuha dhe shoqëria nuk e vëzhgohen si diçka statike dhe e momentit, por si diçka që ka karakter procesi. Kjo rrjedh edhe nga definicioni i diskursit të cilin Jäger e definon

kështu: “Diskursi është një rrjedhë e dijes, respektivisht akumulimeve të dijes shoqërore përgjatë kohës, të cilat e përcaktojnë veprimin individual dhe kolektiv” (Jäger S., 2001: 82).

5. Analiza kritike e diskursit, si teori e metodë, nuk është neutrale, por e pozicionuar. Ajo ka edhe një dimension emancipimi. Përmes vëzhgimit kritik të përdorimit të ligjërit, analistët e diskursit përpiqen që me ndihmën e mjeteve gjuhësore të shpjegojnë se si përmes diskursit transportohen identitete dhe role shoqërore e gjithashtu edhe mendime, qëndrime dhe sisteme vlerash. Në qendër të studimeve janë dekodimi dhe dekonstruktimi i marrëdhënieve të pushtetit dhe ideologjive përmes gjuhës. Analiza kritike e diskursit politik merret posaçërisht me reproduktimin e pushtetit politik, keqpërdorimin e pushtetit dhe dominimin përmes diskursit politik, përfshirë forma të ndryshme të rezistencës apo kundërpushtetit si reagim ndaj këtyre formave të dominimit përmes diskursit (Van Dijk T., 1997: 11). Në këtë kuptim, analiza kritike e diskursit është një angazhim shoqëror dhe ka për qëllim të sjellë ndryshime në shoqëri.

6. Analiza e diskursit është interdisiplinare. Sipas Van Dijk, “Analiza Kritike e Diskursit kërkon multidisiplinaritet dhe të merret parasysh ndërvarësia e natyrshme mes tekstit, të folurit, njohjeve shoqërore, pushtetit, shoqërisë dhe kulturës” (Van Dijk T., 1993: 253).

2.3. Drejtimit e ndryshme

Pa marrë parasysh të përbashkëtat e parimeve teorike, të vetëdijes kritike dhe të qëllimit intervencionist, paradigma e Analizës kritike të diskursit nuk është e njësuar sa i përket mënyrës së arritjes deri te vërtetimi i tezave të saj. Dallimet brendapërbrenda drejtimeve të Analizës kritike të diskursit kanë të bëjnë kryesisht me instancat

ndërmjetësuese të cilat bëjnë lidhjen mes teksteve si mikrostrukturë dhe rregullimeve shoqërore si makrostrukturë. Në këtë aspekt, brenda Analizës kritike të diskursit dallohen këto drejtime:

2.3.1.Semiotika shoqërore

Njëri nga përfaqësuesit kryesorë të semiotikës shoqërore, Gunther Kress, mbështetet mbi teorinë e M. A. K Halliday për ndërlidhjen mes sistemit gramatikor dhe nevojave individuale e shoqërore, të cilave duhet t'u shërbejë gjuha. Kress merret para së gjithash me shenjën si një lidhje mes kuptimit dhe formës. Ai përpiket “të ndërlidhë të veçantat e formës në çfarëdo mediumi me të veçantat e organizimeve dhe të historive shoqërore” (Kress G., 1993: 176). Sipas teorisë së tij, gjuha duhet të kuptohet si sistem semiotik në të cilin kuptimi konstruktohet drejtpërdrejt e jo si sistem gjuhësor në të cilin kuptimi vihet në lidhje me formën gjuhësore.

2.3.2.Rregullimet diskursive

Ndryshe nga Kress, Fairclough përpiket të lidhë analizën gjuhësore me teoritë mbi shoqërinë. Këtë përpiket ta bëjë përmes kombinimit të tekstit dhe ndërveprimit në një kuptim më tepër shoqëror (Fairclough 1992: 4).

Konvencionet të cilat janë themelore për ngjarjet diskursive, Fairclough i quan, duke u mbështetur tek Foucault, “rregullime diskursive”. Totaliteti i praktikave diskursive dhe marrëdhënieve të tyre në një fushë të caktuar shoqërore është rregullimi diskursiv i asaj fushe. Rregullimi i përgjithshëm diskursiv i një shoqërie të caktuar përbëhet nga rregullimet diskursive lokale dhe lidhjet mes tyre.

Sipas Fairclough, “diskurset e ndryshme formësojnë entitete kyçe në mënyra të ndryshme dhe i pozicionojnë njerëzit si subjekte shoqërore në mënyra të ndryshme. Janë këto efekte shoqërore të diskursit në të cilat përqendrohet analiza e diskursit” (Fairclough,

1992: 20).

Në librin *Discourse and Social change* (1992), Fairclough trajton teorinë e tij mbi diskursin, shoqërinë dhe ndikimin e ndërsjellë të ligjëritimit dhe shoqërisë. Sipas modelit të tij, çdo ngjarje diskursive duhet të shihet si tekst, si praktikë diskursive e gjithashtu si praktikë shoqërore. Këto tri fusha kanë ndikim të ndërsjellë në njëra-tjetrën. Praktika shoqërore përmes praktikës diskursive lë gjurmët e saj në tekst dhe anasjelltas tekstet përmes praktikës diskursive ndikojnë në praktikën shoqërore. Transformimet diskursive mund të vërehen gjatë analizës së teksteve. Ato paraqiten në formë të gërshetimeve të ligjëtimeve dhe gjedheve të ndryshme të teksteve, të cilat me kalimin e kohës ndikojnë në ndryshimin e raportit mes praktikave diskursive të ndryshme brenda institucioneve dhe në këtë mënyrë shpjen deri te lëvizja e kufijve të rendeve të deriatëhershme të diskurseve (Fairclough, Wodak, 1997: 265).

Në veprën *Media Discourse (Diskursi mediatik, 1995)*, Fairclough paraqet argumentet e tij se si gjuha e medias ndikon në marrëdhëniet e pushtetit dhe anasjelltas, se si ndikojnë marrëdhëniet e pushtetit në media. Ai e vë theksin posaçërisht në ideologjinë e mediave, të cilat realitetin e paraqesin nga një kënd i caktuar. Sipas Fairclough, mediat si pasojë e varësisë ekonomike ndihmojnë marketimin dhe konvencionalizimin e ligjëtimeve publike, duke i shndërruar ato në ligjërime bisedore. Përmes analizave të diskurseve mediatike ai synon të tregojë se si në këto tekste përmes gjuhës krijohet një tension mes informacionit e argëtimit dhe mes diskursit publik e atij privat. Në veprën e tij *Discourse and Power (Diskursi dhe pushteti, 1989)*, Fairclough paraqet rezultatet e kërkimeve të tij mbi lidhjen mes ideologjisë, pushtetit dhe gjuhës. Objekt kryesor i hulumtimit janë pushteti dhe diskursi institucional. Ai vjen deri në përfundimin se si ndryshimi i ideologjisë së partive konservatore, nga konservatizmi tradicional drejt një

idologjie neoliberale shprehet edhe në ndryshimet në diskursin politik si dhe si ky diskurs kontribuon në ristrukturimin e drejtimit politik. Ndërtimin e diskursit thaçerist ai e paraqet në shembullin e një radio-interviste me ish-kryeministren Margareth Thaçer, dhe përmes analizës selektive të veçorive tekstore ai ilustron sesi realizohet praktika diskursive hibride në tekste heterogjene. Përmes analizës gjuhësore ai tregon se si konstruktohet identiteti i zonjës Thaçer si grua dhe si figurë politike, identiteti i publikut të fjalimit të saj dhe raporti mes politikanit dhe publikut. Fairclough arrin në përfundimin se format imperative të foljeve dhe modalitetet kategorike përdoren shpesh për të theksuar autoritetin. Më tutje del në pah tensioni mes marrëdhënies autoritare dhe solidarizuese me publikun. Ai analizon përdorimin e përemrave dhe nxjerr si përfundim që përemri “ne” përdoret si formë gjithëpërfshirëse për të krijuar lidhje me publikun, por ky përemër përdoret për t’u identifikuar me partinë politike të cilës ajo i takon.

Në artikullin e tij *Political Correctness: the Politics of Culture and Language* (*Korrektësia politike: politikat kulturore dhe gjuha*), ai analizon mundësitë e realizimit të politikave afirmative përmes ndryshimit të diskurseve. Fairclough vjen në përfundim se “politika e kulturës dhe gjuhës, nëse dëshirojnë të kenë sukses, duhet të jenë pjesë e strategjive politike, ato duhet të integrohen në një politikë strukturore dhe habitëse, në një politikë hegjemoniste, sipas Stuart Hall, e cila bashkon intervenimet në nivele të ndryshme të jetës shoqërore. (Fairclough 2003: 17-28). “Sipas Fairclough, pa këtë strategji të përfshirjes gjuhësore e kulturore në praktika politike, do të ishte e vështirë të pranoheshin diskurset e reja sepse “ngulitja e tyre nuk do të jetë e plotë, nëse njerëzit u ekspozohen diskurseve të reja pa i pranuar ato - ata mund t’i përdorin ato si retorikë, për qëllime strategjike e instrumentale” (Fairclough, Norman, 2005: 76-94).

2.3.3. Modeli socio-kognitiv

Përderisa për Fairclough rregullimet diskursive janë pjesa lidhëse mes tekstit e shoqërisë, në analizën e studiuesit holandez Van Dijk si instancë ndërmjetësuese mes praktikës gjuhësore e shoqërore janë strukturat e dijes shoqërore. Sipas pikëpamjes së tij nuk mund të krijohen ndërlidhje të drejtpërdrejta mes makrostrukturave tipike shoqërore si: sundimi, pushteti institucional dhe pabarazia shoqërore, në njërën anë dhe mikrostrukturave si: teksti, ligjërata apo interaksioni komunikues, në anën tjetër. Ky deficiet teorik duhet të shmanget duke adaptuar një pikëprerje sociokognitive si pjesë lidhëse teorike e empirike mes strukturave shoqërore e gjuhësore, respektivisht mes diskursit e pushtetit (Van Dijk 1993: 251). Detyra e Analizës kritike të diskursit duhet të bëjë një përshkrim, sqarim e kritikë të asaj se si diskurset hegjemoniale, përmes krijimit të modeleve të të menduarit, formojnë dijen e përbashkët shoqërore, normat, vlerat, qëndrimet dhe ideologjitë (Van Dijk, 1991: 258). Në studimet e tij, Van Dijk merret me keqpërdorimin e pushtetit dhe reproduktimin e pabarazisë shoqërore përmes ideologjive. Në veprat *Prejudice in Discourse (Paragjykimet në diskurs)* dhe *Communicating Racism (Komunikimi i racizmit)*, Van Dijk paraqet studimet e tij mbi konstruktimin e të menduarit etnik dhe ideologjive në diskursin e përditshëm. Sipas Van Dijk, strategjia e ligjërit mbi tjetrin kombinon një paraqitje pozitive të vetvetes me një paraqitje negative të tjetrit. Në një nga artikujt e tij, Van Dijk studion rolin e medias në riprodhimin e racizmit. Përmes kombinimit të analizës kualitative dhe kuantitative të raportimit të shtypit gjerman dhe britanik, Van Dijk dëshmon se temat të cilat gjejnë vend në shtyp (emigrimi si invazion, emigrantët si nxitës të kriminalitetit, dhunës dhe ndryshimeve kulturore), përputhen me paragjykimet etnike në bisedat e përditshme (Van Dijk 1991: 108-120).

Paul Chilton, një përfaqësues tjetër i drejtimit sociokognitiv, mbështet gjithashtu argumentin e lidhjes së praktikës shoqërore dhe asaj gjuhësore përmes ndërtimit të

strukturave të dijes. “Gjuha dhe sjellja politike mund të thuhet se bazohen në pajisjet kognitive të mendjes njerëzore më tepër se në praktika shoqërore. Gjuha dhe sjellja shoqërore janë të ndërlidhura ngushtë njëra me tjetrën, me siguri në mekanizmat imanent, apo të zhvilluar në mënyrë imanente të mendjes dhe me siguri si rezultat i adaptimeve evolucionare” (Chilton 2004: 28).

Chilton është i përqendruar në dikursin politik. Ai hulumton legjitimimin e politikës përmes mjetit të përsiatjes i cili krijon korniza, apo skema në shoqëri. Për Chiltonin, për procesin politik gjuha është e rëndësishme gjatë krijimit të reprezentimeve mendore. Ai argumenton se gjatë hulumtimit të ligjërimit politik ndeshemi në përdorimin e përsëritur të strukturave të caktuara gjuhësore. “Jo të gjitha strukturat linguistike kanë një funksion socio-politik, por kur e hulumtojmë në mënyrë të mjaftueshme diskursin politik, do të ndeshemi në mënyrë të vazhdueshme me përdorimin e strukturave të caktuara gjuhësore” (Chilton, Paul, 2004: 23). Sipas tij, roli i diskurseve qëndron në etablimin e një kornize konceptuale socio-politike të përbashkët.

“Janë veçoritë e gjuhës së përdorur, të praktikave gjuhësore, të cilat mund të thuhet se luajnë rol në krijimin e kornizave konceptuale gjatë procesit të socializimit. Njerëzit do të shkëmbejnë më shpesh lloje të caktuara të konceptualizimit për arsye të neksusit politik e social të interaksionit. Këto konceptualizime do të kenë gjuhën si motor” (Chilton 2004: 27).

2.3.4. Modeli historik i diskursit

Një drejtim tjetër në kuadër të Analizës kritike të diskursit është modeli historik i diskursit. Ky drejtim është zhvilluar që nga vitet ‘90 nga grupi i kërkuesve austriakë me në krye me Ruth Wodak, gjatë studimeve të shumta rreth konstruktimit të dallimeve (p.sh.

diskursi antisemitik, diskursi racist, diskursi seksist, diskursi mbi kombin etj.). Përfaqësuesit e këtij modeli përpiqen që gjatë analizës dhe interpretimit të teksteve dhe fjalimeve të integrojnë në mënyrë sistematike të gjitha informatat themelore që kanë në dispozicion. Ky model dallohet nga ato të tjerët përmes ndërlidhjes me kontekstin historik të diskurseve dhe aplikimit të metodës së triangulacionit - përdorimit të materialeve dhe metodave të llojllojshme gjatë analizës. Në një studim të vitit 1990 mbi antisemitizmin në Austri pas Luftës së Dytë Botërore, Wodak dhe kolegët e saj përpiqen të dëshmojnë konstruktimin e antisemitizmit, të ndikuar nga paragjykimet në diskursin publik të fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve presidenciale të Kurt Waldheim. Wodak tregon se konteksti i ligjërimit ndikon në strukturën, funksionin dhe përmbajtjen e thënieve antisemitike. Modeli i Ruth Wodak dhe kolegëve të saj përqendrohet në konstruktimin e realiteteve përmes diskurseve. Në studimin e botuar në vitin 1998 të quajtur “*Zur diskursiven Konstruktion nationaler Identität*”, (Mbi konstruktimin diskursiv të identitetit kombëtar), në fokus qëndron konstruktimi i njëjtësisë. Gjëja themelore për këtë proces është dallimi i tre dimensioneve të analizës të ngërthyer në njëri-tjetrin: dimensionit të përmbajtjes, dimensionit të strategjive argumentuese dhe dimensionit të mjeteve gjuhësore në nivelin e fjalëve, fjalive dhe teksteve që shpjen në realizimin e këtyre dy të parave. Analizat sjellin përfundimin se, varësisht nga rasti dhe përbërja e grupeve, formohet një identitet kombëtar i ndryshëm.

2.3.5. Grupi i Duisburgut

Ky grup asocohet veçanërisht me studiuesit Jürgen Link dhe Sigfried Jäger. Për të dy, diskursi ka të bëjë me “prodhimin e realitetit i cili ndodh i ndërmjetësuar nga njerëzit aktivë” (Jäger, Sigfried, 2001: 147). Për Jäger, sikur edhe për Link, objekt kërkimi është

diskursi politik dhe funksioni i tij për legjitimimin e dominimit në shoqëritë kapitaliste.

Gjatë analizës së diskursit, Link vë në pah mjetet gjuhësore dhe ikonografike me ndikim, e posaçërisht simbolet kolektive, të cilat shërbejnë si teknika për sigurimin e legjitimitetit të pushtetit në ligjërim. Link krijon një model analize të ligjërit, të cilin ai e quan Modeli i Sistemeve Sinkronike të Simboleve Kolektive (SYSYKOL), të cilat përmbajnë diskurse speciale dhe të cilat e mbajnë bashkë dijen e përgjithshme kulturore të një shoqërie dhe me këtë të diskursit të përgjithshëm shoqëror (Jäger, Sigfried/Link, Jürgen, 1993: 152-163). Me simbolikë kolektive ai nënkupton: “tërësinë e të ashtuquajturit figurativitet të një kulture, tërësinë e alegorive dhe emblemave, metaforave e shembujve, modeleve të ilustrimit dhe temave orientuese, krahasimeve e analogjive të saj më të përhapura” (Jäger, Sigfried/Link, Jürgen 1993: 152-163). Link i quan këto simbole kolektive për arsye se ato mësohen, përdoren dhe kuptohen nga të gjithë njerëzit e një shoqërie. Për arsye se SYSYKOL e mban bashkë diskursin e përgjithshëm shoqëror, ai ka ndikim tek të gjithë anëtarët e një shoqërie në atë mënyrë që ata e shohin, kuptojnë dhe interpretojnë realitetin përmes sistemit të tyre të simboleve (Jäger, Sigfried/Link, Jürgen, 1993: 152-163).

Në teorinë e tij mbi diskursin dhe shoqërinë, Jäger mbështetet në konceptin e Foucault për diskursin. Ai me diskurs nënkupton “veprim (kolektiv) *sui generis*, i cili është material dhe praktik sikur ndërtimi i një shtëpie”. Në veprën e tij *Kritische Diskursanalyse, eine Einführung (Analiza kritike e diskursit. Një hyrje, 2001)*, Jäger paraqet konceptin e tij të diskursit dhe të lidhjes mes gjuhës e shoqërisë, si dhe zhvillon një metodë të analizës së diskursit me të cilin hulumtohet raporti mes veprimit, të menduarit dhe të folurit në kontekst të caktuar. Jäger e sheh lidhjen mes diskursit dhe shoqërisë në rolin që ka diskursi në konstituimin e objekteve dhe subjekteve. Për Jäger

diskurset nuk janë vetëm ideologji, por ato prodhojnë subjekte dhe realitete shoqërore (Jäger, Siegfried, 2001: 147). Në këtë vepër Jäger përpiqet të zhvillojë edhe standardet e kritikës së diskurseve. Sipas tij, analiza e diskursit është kritike nëse ajo vë në pah strukturat e fshehta dhe bëhet kritike në kuptimin e mirëfilltë, nëse ndërlidhet me arsyetime moralo-etike. Këtu Jäger zhvillon edhe një metodë të Analizës kritike të diskursit e cila mundëson të përfshihet diskursi i përgjithshëm shoqëror. Sipas Jäger, ndikimi i diskurseve qëndron në përsëritjen e vazhdueshme të argumenteve, përmbajtjeve dhe formave të caktuara, si dhe në fuqinë ndikuese të simbolikës gjuhësore. Për këtë arsye, analiza e diskursit duhet të tregojë se me cilat mjete gjuhësore dhe për çfarë lloj realitetesh dhe të vërtetash krijohet pranimi në shoqëri. Pra, analiza kritike e diskursit duhet t'i përgjigjet pyetjes se me ndihmën e cilave implikatura, të cilave simbole kolektive dhe strategjive të argumentimit krijohen përmbajtje të caktuara dhe në interes të kujt përdoren ato (Jäger, Siegfried, 2001: 171).

2.4. Përparësitë dhe mangësitë e Analizës kritike të diskursit.

Në studimet e fushës së Analizës kritike të diskursit vërejmë se ajo i qëndron shumë afër praktikës, për arsye se përpiqet të vë në pah probleme të ndryshme sociale, sidomos keqpërdorimin e pushtetit për ta vetëdijesuar publikun. Për më tepër, për modelet e Analizës kritike të diskursit është karakteristike transparenca, dinamika dhe kombinimi i metodave, përmes të cilave arrihet deri te përgjithësimet për fenomenet e studiuar. Me gjithë këto përparësi, një kërkues që përdor modelet e Analizës kritike të diskursit si metodë për kërkimet e tij empirike do të ndeshet me sfidat në vazhdim.

Këto modele shërbejnë me metoda kualitative, që do të thotë se janë të destinuara për analizë cilësore të sasive të vogla të teksteve (Fairclough 1992: 230, Jäger 2001: 171-172). Te shumica e studimeve ekzistuese nuk mund të gjendet përgjigje për atë se si të

vijmë deri te konkluzione të përgjithshme e të vlefshme, duke u nisur nga rezultate të kërkimeve të pakta, pra si të përgjithësohet, për të ardhur deri tek përfundimet, të cilat do të ishin të vlefshme edhe për kontekste, institucione, respektivisht grupe të mëdha shoqërore të tjera. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, Siegfried Jäger propozon që gjatë analizës empirike të mbështetemi në tufën e diskurseve, apo në prerjet sinkronike të tufave të diskurseve.

Nëse e zbatojmë këtë udhëzim do të ndeshemi me sasi të mëdha të materialeve, të cilave vështirë se u dilet ballë. P.sh. për të vendosur se cilët shembuj janë tipikë, apo përfaqësues për praktika të caktuara shoqërore, Fairclough propozon të mbështetemi në mendimet e studiuesve të tjerë të disiplinave relevante, të cilat i marrim parasysht gjatë analizës sonë. Një mundësi tjetër për t'i zgjedhur shembujt tipikë, sipas tij, është të përqendrohemi në momentet e krizave, apo siç e quan ai “cruces”, por ai nuk jep hollësira të mëtejshme se si të zgjedhim njësitë kërkimore që janë reprezentative (Fairclough 1992: 226). Në këtë aspekt, Sigfried Jäger propozon të bëjmë një kombinim të metodave kuantitative me ato kualitative. Ai propozon që korpusi të kufizohet përmes precizimit të hollësishëm të pyetjeve kërkimore dhe përmes përzgjedhjes së diskurseve për të analizuar. Një mënyrë tjetër, sipas tij, do të ishte të koncentrohemi në një sektor të një fushe të diskursit, përzgjedhjen e të cilit do ta arsyetonim dhe argumentonim mirë. P.sh. të analizojmë diskursin e shtypit ditor, ku si korpus për analizë do të merrnim gazeta të caktuara, apo ngjarje të caktuara diskursive. Një përzgjedhje e tillë e korpusit do të ishte e arsyeshme, sepse do të mund të thoshim se përmbledh një diskurs në tërësinë e tij.

Problemi tjetër me të cilin do të sfidohemi nëse përdorim analizën e diskursit si metodë, është kategoria kërkimore. Sa i përket instrumenteve të analizës, shembuj të ndryshëm në literaturën e Analizës kritike të diskursit ofrojnë një inventar të pasur. Ky

instrumentarium i përshkruan tekstet në tërësinë e tyre në të gjitha fushat gjuhësore dhe i përfshin fenomenet në nivelin e tekstit, fjalisë dhe fjalëve. Përveç kësaj u kushtohet rëndësi edhe veçorive gjuhësore si: modaliteti, nominalizimi, pasivizimi etj., dhe fenomeneve të tjera si retorika e aludimi. Sa i përket emërimit, konceptimit, terminologjisë dhe hierarkizimit të këtyre kategorive në kuadër të analizës nuk ekziston një pajtim mes përfaqësuesve të analizës kritike e diskursit. Përshkallëzimet në sistemin e kategorive ndryshojnë në bazë të njohjeve që synohen të arrihen dhe strukturimit të ndryshëm të korpusit.

Fairclough zhvillon një model analize i cili është shumë i pasur në nivelet mikrogjuhësore, por i cili nuk është i përshkallëzuar. Sipas këtij modeli, me tekst nënkuptohen edhe fenomenet si kohezioni, modaliteti e mirësjellja. Dimensionet e ndryshme të cilat e lidhin tekstin me strukturat shoqërore janë praktika diskursive, interdiskursiviteti, diskursi e zhanret (Fairclough, po aty, 26-30). Jäger nuk i hierarkizon kategoritë, por i grupon ato. Ai dallon sipërfaqen e tekstit, në të cilën përfshin edhe qëllimin argumentativ, të cilin ai e barazon me qëllimin e veprimit si dhe mjetet retorike. Sipërfaqja e tekstit, sipas tij, është struktura e përgjithshme e analizës, ndërsa mjetet gjuhësore-retorike janë pjesë e mikro-analizës. Sipërfaqes së tekstit i takojnë kategoritë e tilla si: qëllimet e argumentimit dhe strategjitë e argumentimit. Mjeteve retorike gjuhësore u takojnë sintaksa dhe leksiku (Jäger 2001: 209).

Van Dijk operon në strukturën sipërfaqësore të teksteve me terme si stili dhe retorika. Sipas tij, stili paraqet mendimin personal të autorit, dhe retorika përfshin mjetet me të cilat synohet të ndikohet publiku (Van Dijk 1991: 209).

Qasja metodike në grupin e Ruth Wodak karakterizohet në përshkallëzimin e kategorive përmes një sistemi shumëdimensional të kategorive. Konceptet linguistike si:

korniza, skema, modeli dhe skripti, sipas Wodak, i takojnë kategorisë së strategjisë. Strategjitë ajo i definon si: “plane pak a shumë të automatizuara, që bazohen në modele të aktiviteteve pak a shumë përgjithësuese dhe stereotipa, në rastin tonë diskursive, të cilat janë të lokalizuara në nivele të ndryshme të organizimit mendor e kognitiv dhe të cilat janë pak a shumë të elaboruara” (Wodak, De Cillia, Reisigl, Liebhart 1999, 34).

Në një vend tjetër Wodak e përkufizon strategjinë si “plan i praktikave (përfshirë edhe praktikët diskursive) i cili është pak a shumë i përshtatshëm dhe i qëllimshëm dhe i cili adaptohet për të arrirë qëllime të caktuara shoqërore, politike, psikologjike apo gjuhësore”. Sa u përket strategjive, këto janë pak a shumë mënyra sistematike të përdorimit të gjuhës (Wodak, Ruth/de Cillia, Rudolf/ Reisigl, Martin/Liebhart, Karin, 1999: 72).

Ky heterogjenitet ka anët e tij pozitive dhe negative: nga njëra anë hulumtuesve të rinj u jep mundësinë të jenë inovativë dhe duke u bazuar në modelet e ndryshme të krijojnë dizajne studimi për vete, por nga ana tjetër mund të lind dyshimi se dizajni i studimit është krijuar në atë mënyrë që të mbështesë tezat e hulumtuesit.

KAPITULLI III:

PROCESI I KOMUNIKIMIT

3.1. Evolucionin e komunikimit politik.

Aftësia për të komunikuar ka qenë e rëndësishme në evolucionin e njeriut dhe përparimin e tij kulturor. Për këtë arsye kërkimi i burimeve dhe teknologjive të

përshtatshme për të manaxhuar dhe kontrolluar informacionin ka karakterizuar historinë e çdo qytetërimi. Çdo mjet i ri i komunikimit ka transformuar thellësisht kulturën dhe shoqërinë. Të kuptuarit se si teknologjitë e komunikimit të së kaluarës kanë ndikuar ndryshimet shoqërore, është mjet për të kuptuar ndryshimet sot, dhe për t'u përpjekur për t'i adresuar ato (Marshall, 1994). Mjeti i parë i komunikimit që njerëzimi ka zhvilluar, dhe padyshim më i rëndësishmi, ishte shkrimi. Efektet e shpikjes së shkrimit ishin të mëdha në transformimin e mendjes së njeriut më shumë se çdo shpikje tjetër. Me kalimin e kohës, shkrimi është parë gjithnjë si një funksion natyror. Për më tepër, sistemi i përfaqësuar nga mendimi abstrakt, jo me figura, por me alfabetin çoi në lindjen e koncepteve të arsytimit racional dhe të menduarit në një mënyrë më analitike. Përhapja e njohurive dhe informacionit përforcohet me lindjen në shekullin e tetëmbëdhjetë të gazetave të para me informacion periodik. Gazetat kishin pësuar një pasurim të madh ndërmjet klasave të reja shoqërore, në të cilat këto gjetën një mjet të rëndësishëm për përçimin e ideve, dhe një instrument të betejës politike dhe kulturore. Kështu lindi koncepti i “opinionit publik”, së bashku me idetë e një mjeshtri të informacionit publik i mjaftueshëm për të bërë gjykime mbi ngjarjet politike dhe aktivitetet kulturore. Nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, historia e medias dhe e komunikimit është e lidhur përgjithmonë me zhvillimin teknologjik dhe industrial, e cila pësoi një përshpejtim mbresëlënës. Media sillte edhe dy rrisitë kryesore të shekullit të kaluar si: 1) lindjen e sistemeve të para të komunikimit (radio, telefon); 2) zhvillimin, e teknologjive të para të imazhit (film, animacion, fotografi). Ndërmjet viteve 1830 dhe 1840, shpikja dhe përhapja e telegrafit elektrik bëri të mundur për herë të parë transmetimin e një sinjali në një distancë në kohë reale; lindi kështu telekomunikacioni. Në të njëjtin vit, Daguerre

Louis zhvilloi fotografinë, e cila për herë të parë lejonte prodhimin e imazheve të realitetit me anë të një aparati mekanik.

Një shpërthim i vërtetë në teknologjinë e komunikimit ndodhi në dy dekadat e fundit të shekullit. Në vitin 1876, Aleksandër Graham Bell shpiku telefonin, duke mundësuar komunikimin me zë në distancë. Thomas Edison, shpiku sistemin e parë për incizimin mekanik të riprodhimit të zërit: fonogramin. Hyrja e vërtetë triumfuese në shekullin e mediave ishte në vitin 1895, kur vëllezërit Lumiere në Paris arritën të zhvillojnë sistemin për krijimin dhe rishikimin e imazheve në lëvizje duke bërë të mundur zhvillimin e kinematografisë. (Collins, 2009). Në pak vite, rreth kësaj teknologjie të prodhimit dhe riprodhimit të imazheve lëvizjet zhvilluan formën e parë të vërtetë të industrisë së argëtimit, duke nisur një proces që përshkon gjithë shekullin e XX përmes komunikimit në industrinë e sotme dhe industrisë së spektaklit. Shekulli XX është shekulli i mediave. Në vitin 1920, falë hulumtimeve nga Guglielmo Marconi në transmetimin e zërit në një distancë nga modulimi i valëve elektromagnetike, në Shtetet e Bashkuara filluan transmetimet e para radiofonike. Radio ishte sistemi i parë i komunikimit nga ku mund të dërgoheshin mesazhe në kohë reale për miliona njerëz në të njëjtën kohë dhe në shtëpitë e tyre: lindi kështu dhe komunikimi masiv. Kjo është arsyeja pse media ka pasur një rol kaq të rëndësishëm në komunikimin politik të atyre viteve. Në nëntor të vitit 1936, BBC në Londër hap shërbimin e parë të transmetimeve televizive. Brenda tridhjetë viteve televizioni u përhap në mbarë botën, duke u bërë mjeti i komunikimit masiv më efektiv dhe më bindës që njeriu ka zhvilluar deri më tani dhe, mbi të gjitha, duke kontribuar në një ndryshim radikal në stilin e jetës dhe marrëdhëniet me partnerët socialë në të gjitha vendet e Perëndimit dhe më tej, në të gjithë botën.

Pasojat politike të ndryshimeve në forma tradicionale të mediumit të lajmeve dhe rritja e përdorimit të internetit është një nga fushat më të nxehta të studimeve vitet e fundit. Interneti ka gjeneruar mënyra alternative të vizionit në lidhje me të ardhmen. Perspektiva më pozitive lidhet me optimistët mbi teknologjinë të cilët theksojnë mundësitë e shumta të internetit në përfshirjen e rendit të ditës mes qytetarëve dhe demokracisë direkte të cilat kanë impaktin e tyre për hartimin e buxheteve financiare të promovimit të çdo subjekti.

Diskursi politik është një pjesë esenciale e marketingut politik. Pasi hartohet programi i politik që do t'u ofrohet zgjedhëseve sipas segmenteve të tregut politik, faza tjetër është komunikimi i këtij mesazhi. Temat kryesore të komunikimit politik të trajtuara nga akademikë të ndryshëm të shkencave politike dhe sociale, lidhen në pjesën dërmuese me tema të tilla si: 1. Procesin e Marketingut dhe impakteve në Komunikimin Politik dhe demokratizimit të medias, (Maarek, 1995; Dalhren, 2009; Mazzoleni/Scultz, 1999); 2. Problematikat e pronarëve politikë të mediave dhe komercializimit të tyre, (Bennet, 2008) 3. Problematikave dhe pasojat e “ndërtimit” të lajmit, teknikat bindëse të komunikimit politik, (Grabes, Smith, 2005) 4. Teoritë konjiktive në lidhje me perceptimin e mesazheve politike, (Goldstein, Fredman, 2002); 5. Procesin e komunikimit në zgjedhjet elektorale, (Iyengar, Simon 2000). 6. Komunikimi politik në erën e mediave sociale, (Norris, 2009; Kushin, Yamamoto, 2008; Grabes, 2011).

Në procesin e komunikimit politik përfshihen disa aktorë, qëllimi i të cilëve është përcjellja e mesazhit sipas formës së dëshiruar nga dërguesi. Sipas Brian McNair në librin e tij “Hyrje në Komunikimin politik” (Iyengar, Simon, 2000), aktorët që marrin pjesë në procesin e komunikimit politik janë organizatat politike, media, dhe qytetarët”.

Gjatë analizës së rolit që luajnë të gjithë këta aktorë në procesin e komunikimit politik, Mc Nair gjithashtu parashtron tezën se në epokën e së drejtës universale të votës

dhe të një elektorati masiv, partitë/kandidatët duhet të përdorin masmedian përmes përdorimit të taktikave dhe strategjive të cilat do shpinin në një proces më transparent për të gjithë aktorët. (McNair B. 2003). Kështu në fokus të studimit tonë janë teknikat dhe elementët e komunikimit politik të cilat mundësojnë arritjen e segmentit të votuesve të synuar dhe në rastin konkret elektoratit rinor. Përmes analizimit të aktorëve politikë, McNair shtjellon dhe kanalet e shfrytëzimit të medias për promovimin e aktiviteve si, konferencat e partisë, deklaratat e shtypit, manaxhimi i imazhit etj. Media përmes shtypit, transmetimit televiziv, internetit, luan dy role, atë të transmetuesit dhe dërguesit.

Studiues të ndryshëm të fushës së komunikimit politik përpiqen të japin kontributin e tyre teorik dhe praktik në lidhje me një proces të efektshëm të komunikimit përmes aktorëve politikë dhe qytetarëve. Gjithashtu artikujt e shumtë të botuar në dy dekadat e fundit, përpiqen të shtjellojnë, kuadrin e evoluimit të teknikave të komunikimit, dhe formës se si kanalizimi të mesazheve politike. Funkcioni i shpërndarjes në marketingun politik, ka një lidhje pozitive dhe të fortë me komunikimin politik. Ajo që argumentohet dhe pranohet është se në marketingun politik partitë/kandidatët duhet të mbajnë një raport afatgjatë me qytetarët dhe mediat në mënyrë që të përcillet feedback-u sipas kërkesave të secilës palë. Kjo do të mundësonte nga ana e partive politike krijimin dhe hartimin e një mesazhit të qartë dhe transparent për ofrimin e informacionit të nevojshme tek votuesi si dhe nga ana tjetër qytetarët, në rolin e votuesit apelimin përmes blogjeve, letrave, sondazheve në lidhje me kërkesat e tyre duke shfrytëzuar median si transmetues i këtij procesi. (Islami K. 1999).

Të kuptuarit të efekteve të mesazheve të komunikimit politik, parashtrojnë nevojën për kërkime të mëtejshme mbi reagimet që krijohen nga audienca. Sondazhet e opinionit publik lidhen me përzgjedhjen e mostrës duke shqyrtuar mundësinë e përfaqësimit sa më

të gjerë. Ka disa institucione ndërkombëtare sondazhesh si psh: Gallup, MORI, PIEPOLI, të cilat investojnë shuma të konsiderueshme mbi arritjen e një shkalle saktësie të lartë mbi efektet e komunikimit politik në grupe të synuara të elektoratit. Këto sondazhe nuk shërbejnë thjesht për të matur efektet e komunikimit politik, por, në të njëjtën kohë edhe për të ndikuar në perceptimet e elektoratit në lidhje me fituesin e mundshëm. Këto kompani kërkojnë të ndikojnë dhe në sjelljen e audiencës lidhur me idenë se perceptimi individual, priret të jetë pozitiv drejt personave me imazh “fitues”. Gjithsesi nëse cilësia e audiencës, nuk është asimiluese, atëherë dhe cilësia e mesazhit, sofistikimit dhe ndërtimit të tij do të kishte një impakt të vogël. “Nëse nuk e përtyp premisën tënde kryesore, nuk ka rëndësi sesa shumë shpenzon ose sa mirë janë prodhuar reklamat e tua, ata nuk do të funksionojnë” (Morris, 1996). Në përgjithësi efektet e komunikimeve politike nuk përcaktohen vetëm nga përmbajtja e mesazhit, por njëkohësisht ato varen edhe nga konteksti social, politik, ekonomik dhe teknologjik. Komunikimi politik përfshin të gjithë elementet të tillë si: elementet verbale (të folurit, timbri i zërit, gjuha e trupit, apo të shkruara, por edhe elementët pamore sic janë veshja, modeli i flokëve, make-up, stili personal etj. Në studimet e ndryshme të realizuara në Britaninë e Madhe, kompania MORI në vitin 1987 arriti të identifikonte disa nga përcaktuesit e sjelljes gjatë votimit dhe që lidheshin me 3 elementë: imazhi i partisë (44%), imazhi i votuesve për liderin e partisë (35%) dhe imazhi të vetë partisë (21%) (Worcester, 1991). Mes eksperimenteve të kryera rreth efektshmërisë së komunikimit politik dhe menaxhimit të impresionit politik tek votuesi janë edhe studimet e Rosenberg dhe MC Caferty dhe De Landsheer dhe De Vries (Christ’l De Landtsheer, Philippe De Vries, Dieter Vertessen, 2008). Ekspertët e marrëdhënieve me publikun, mund të manipulojnë pikëpamjet e publikut rreth një kandidati politik. Kështu autorët Landsheer dhe De Vries në artikullin

e tyre të botuar në revistën Journal of Political Marketing, sjellin disa konkluzione lidhur me ndikimin e aspekteve fizike të kandidatit të cilat perceptohen pozitivisht nga votuesit. Rosenberg dhe MC Caferty në 1987 për të provuar hipotezën se imazhi ka rëndësi në formimin e sjelljes politike, zgjodhën një grup studentësh të universiteteve amerikane të cilëve iu ekspozuan fotografi të ndryshme të kandidatëve të rremë politikë. Fotot ndryshonin në mënyrë që të zgjonin reagime negative dhe pozitive, si shtimi ose pakësimi i një buzëqeshjeje etj. Gjetjet treguan se ndryshime të tilla tregojnë se individit perceptohet si më i përshtatshëm për një post publik kur mbart krahas aftësive verbale apo folëse dhe cilësi të tjera si: tërheqje, integritet dhe kompetencë. Studime të ngjashme janë realizuar edhe në Gjermani, Belgjikë etj., të cilat kanë mundur të sintetizojnë disa cilësi të aspekteve fizike të kandidatit të cilat ndikojnë në një qëndrim pozitiv tek votuesit. Një ekzaminim i disa karakteristikave të veçanta të kandidatëve politik lidhura me një profil të lartë/të ulët, mundësojnë identifikimin e elementëve specifikë të prezantimit pamor të cilat kontribuojnë në një prezantim të favorshëm të imazhit. Imazhi ideal për politikanët meshkuj, konsiderohen ata të cilët i përkasin moshës 35-40 vjeç, të cilët kanë ngjyrë të errët të flokëve, veshje klasike. në ngjyrë të errët me këmishë të bardhë ose blu e hapur si dhe një kravatë me ngjyra. Meshkujt politikanë bjondë, veshje me ngjyra të forta apo me xhaketë skoceze konsiderohen me një imazh më pak të favorshëm.

Gratë politikane nga ana tjetër preferohen dhe perceptohen pozitivisht nëse i përkasin moshës 40-45 vjeç. Ato duhet të kenë flokë të errëta dhe të modeluara në formë klasike, me një gjatësi mesatare të flokëve. Fustani formal është më i përshtatshmi me një xhaketë klasike. Studimet e marketingut politik dhe komunikimit politik i dedikojnë një kujdes të veçantë imazhit të kandidatit, partisë si një faktor i rëndësishëm në formimin e sjelljes gjatë votimit. Efektet e komunikimit politik në sjelljet dhe qëndrimet lidhet me

kanalet e shpërndarjes dhe mediumit të komunikimit. Efekti i reklamave politike apo spoteve siç njihen në Amerikë, është një përbërës i rëndësishëm në komunikimin politik modern që konsumon burime të mëdha financiare si para fushatës elektorale ashtu edhe në periudhën e ndërmjetme. Gjithsesi nuk duhen nënvlerësuar një sërë faktorësh të tjerë, të cilët ndërhyjnë në marrëdhëniet komunikues-marrës, të cilët lidhen me kuptimin e mesazhit dhe ndikimin e tij në elektorat.

3.2. Procesi i komunikimit

Në një epokë më të hershme të studimeve rreth komunikimit, pyetje rreth tij bëheshin rrallë. Mesazhi supozohej se vepronte mbi një individ gati si një shiringë që futet nën lëkurë ose si një gur bilardoje, të cilët shkaktojnë një efekt të drejtpërdrejtë, që mund të parashikohej dhe të matej. Modeli i futjes nën lëkurë të efekteve të medias u përqafua gjatë viteve 1930 si nga sociologët europianë, ashtu edhe nga ata amerikanë. Nga njëra anë, si përgjigje ndaj rritjes së fashizmit në Europë dhe ndaj përdorimit gjerë, në dukje të suksesshëm, që i bënë nazistët teknikave të propagandës dhe nga ana tjetër, të nxitur nga fuqia e reklamës për të shitur mallra, fuqi që sa vinte e po bëhej më e evidente. Të dy fenomenet nxitën përkrahjen për një model relativisht të thjeshtë, dhe me efekt të fortë. Për fat të keq, studime të gjera empirike nuk qenë në gjendje të provonin efektet specifike të medias, duke duke pranuar në vitet 1950 se efektet ishin të kufizuara, ose më saktë, të ndërmjetësuar nga një sërë faktorësh shoqërorë dhe kulturorë që ndërhyjnë mes mesazhit dhe audiencës së tij. Modeli i efekteve me ndërmjetësim të kufizuar mbizotëroi fushën e studimeve të komunikimit gjatë gjithë viteve 1960, deri sa u zhvillua dhe u stërhollua nga shkolla semiologjike, me veprën e Umberto Eco dhe të tjerëve. Sipas kësaj tradite, të kuptuarit e efekteve të mesazheve të medias kërkonte të kuptuarit e semiotikës

sociale të një situate të dhënë komunikimi, duke pranuar mundësinë e përhershme të deshifrit të diferencuar të mesazhit, të shumësisë së kuptimeve që mund të fitojë sipas larmisë së grupeve dhe individëve që përbëjnë audiencën e tii, si dhe të larmisë së reagimeve që ai mund të provokojë. Për t'i kuptuar këto mesazhe dhe për t'u dhënë një përgjigje, do të varet së pari nga konteksti i marrjes së mesazhit, duke ndërfutur faktorë të tillë si përkatësia politike, mosha, prejardhja dhe gjinia e marrësit, dhe së dyti, nga lloji i mesazhit të transmetuar.

Duke përdorur listën e pozicioneve me deshifrim të diferencuar të hartuar nga Stuart Hall (1980), mund të ngremë me të drejtë hipotezën se një emision i Partisë Laburiste do ta shtyjë një mbështetës laburist drejt një deshifrimi dominant, në të cilin marrësi ndan botëkuptimin që qëndron në thelb të ndërtimit të emisionit, interpretimin e tij të fakteve pas debateve aktuale politike dhe ekonomike, si dhe zgjidhjet e tij të parapëlqyera. Votuesi i lëkundur, duke i munguar lidhja e fuqishme me një parti të veçantë, fare mirë mundet të përvetësojë një deshifrim të diskutuar, të bjerë dakord me disa nga aspektet e mesazhit dhe t'i refuzojë të tjerat. Një reagim i tillë do të sillte pranimin e nevojës për një shpërndarje më të drejtë të të ardhurave, apo refuzimin e propozimeve të veçanta për rritjen e taksave, duke i vlerësuar ato si tepër të ashpra. Mbështetësi konservator, nga ana tjetër, do të përvetësojë një pozicion deshifrimi kundërshtues, duke i refuzuar si propozimet për vlerat edhe ato për politikat specifike në emisionet televizive politike. Emisionet e partive të tjera do të ndeshen me të njëjtat reagime të shumëllojshme. Shkurt, dijenia e dikujt se një copëz komunikimi është partiake, do të mbizotërojë në një shkallë të gjerë mënyrën se si ai e lexon atë. Nga ana tjetër, nëse një mesazh politik komunikohet përmes një rubrike lajmesh, një interviste në 'talk show', apo gjatë një debati të drejtpërdrejtë në fushatën zgjedhore (të gjitha kontekstet, në të cilat kontrolli editorial mbi

mesazhet shihet se qëndron përtej vetë politikanit), audienca mund të përfitojë nga rasti për t'i gjykuar aftësitë dhe politikat nga një perspektivë më objektive. Në procesin e komunikimit do të ketë më pak nënkuptime dhe audienca mund të jetë më e hapur. Si rregull i përgjithshëm, efektet e komunikimeve politike të çfarëdolloji nuk përcaktohen vetëm nga përmbajtja e mesazhit, qoftë edhe parimisht, por nga konteksti historik në të cilin ato shfaqen dhe sidomos nga mjedisi politik që mbizotëron në çdo kohë. Cilësia e një mesazhi, aftësia dhe sofistikimi i ndërtimit të tij nuk kanë fare vlerë, nëse audienca nuk është asimiluese. Këshilltari për mediat i presidentit Clinton në fushatën zgjedhore të vitit 1996, Dick Morris, shkruan në kujtimet e tij se nëse publiku nuk e përtyp premisën tënde kryesore, nuk ka rëndësi se sa shumë shpenzon ose se sa mirë janë prodhuar reklamat e tua, ato nuk do të funksionojnë (Morris, 1997: 152). Çështjet e lartpërmendura janë vështirësi konceptuale që ngrihen nga kompleksiteti i vetë procesit të komunikimit. Ato na kujtojnë se komunikimi i suksesshëm i një mesazhi (politik ose i ndonjë lloji tjetër), nuk mund të merret si i mirëqenë, por duhet të përpunohet nga dërguesi.

3.3. Komunikimi politik dhe proceset demokratike

Një alternativë për qasjen empirike, e cila thekson efektet e komunikimit politik në sjelljet dhe qëndrimet, është të merret parasysh ndikimi i saj në vetë procesin demokratik. Padyshim që ka diçka cilësisht të ndryshme në një sistem politik, ku mjetet kryesore të komunikimit janë mediat masive.

A kanë këto ndryshime ndërlikime pozitive apo negative me idealin demokratik, siç u vërejt në kapitullin e kaluar?

Butler dhe Kavanagh vëzhgojnë se tani, më tepër se kurrë më parë, fushatat elektorale menaxhohen dhe orkestrohen. Secila parti orvatet ta formësojë axhendën e vet në atë mënyrë, që media të pasqyrojë për të çështjet e favorshme. Opinioni publik

monitorohet përmes sondazheve përkatëse. Një fushatë elektorale po shihet gjithnjë e më tepër nga drejtuesit si një ushtrim marketingu dhe, shumë nga zotësitë për t'u shitur klientëve mallra dhe shërbime, tani aplikohen për elektoratin. Këto zhvillime e kanë rritur vëmendjen e ekspertëve për sondazhet e opinionit, për reklamim dhe për marrëdhëniet publike, rritje që ndonjëherë shpie në tensione me politikanët dhe zyrat e partisë. Për shumë vëzhgues, prirjet e përshkruara nga këta autorë janë të rrezikshme dhe të dëmshme për procesin politik. Nëse politikanët janë bërë shumë të ndjeshëm ndaj opinionit publik, siç e tregojnë sondazhet, shpesh argumentohet se ata po ashtu janë bërë robër të atij opinionit publik, duke e lejuar atë të dominojë proceset e formulimit të politikës dhe të vendimmarrjes. Qeveritë, dhe ata që aspirojnë të qeverisin, i lejojnë parimet e tyre të stërhollohen nga rekomandimet e studiuesve të tregut. Ideologjitë dhe sistemet e vlerave braktisen në altarin e popullaritetit dhe aktiviteti i bindjes politike bëhet një reagim cinik ndaj çfarëdogjëje që thotë sondazhi i javës. Jo vetëm politikat, por edhe liderët zgjidhen dhe hidhen sipas tekave të opinionit publik, pavarësisht cilësive të tyre intelektuale. Argumentohet se imazhi i liderit ka më shumë rëndësi se aftësitë e tij ose të saj, shkathtësia e dërgimit të një mesazhi politik më tepër se përmbajtja e tij.

Padyshim, tani mendohet se imazhi është më i rëndësishëm nga sa ishte më parë. Ronald Regani pranohet, në mënyrë universale, se nuk ishte një president i madh amerikan për shkak të intelektit të tij të fuqishëm, por sepse me ndihmën e formimit të tij si aktor, ai i artikulonte mesazhet e tij të thjeshta e praktike. Ai ishte "komunikuesi i madh", dhe jo mendimtari i madh. Nga ana tjetër, Michael Foot, lideri i Partisë Laburiste nga 1980 deri në 1983, pranohej nga mbështetësit dhe kundërshtarët gjithashtu se ishte një intelektual i mahnitshëm dhe një menaxher i zoti në parti. Në kohën e televizionit, për fat të keq, ai nuk dukej dhe nuk tingullonte "mirë". Pas rënies së laburistëve më 1983 ai

u tërhoq në ndenjëset e pasme të parlamentit, për t'u zëvendësuar me Neil Kinnock, më "i afërt me median". Shembujt e Regan dhe Foot (dhe mbase deri në njëfarë mase, kandidatët demokratë për presidentë në SHBA në vitet 1984 dhe 1988, Walter Mondale dhe Michael Dukakis), citohen rregullisht nga ata që ankohen për pushtetin e imazhit si një faktor vendimtar në sjelljen e votuesve. Prirja supozohet të përfaqësojë një largim nga racionaliteti i idealit demokratik drejt një procesi politik më iracional e të paqëndrueshëm, në të cilin çështjet "e vërteta" marginalizohen prej konsideratave të rëndomta për pamjen dhe personalitetin. Një argument kundërshtues shpjegon se rëndësia e imazhit është e tepruar. Po këta zëra pyesin, si ia doli George Bush, njeriu i padukshëm i Doonesbury-t, të fitojë zgjedhjet presidenciale të vitit 1988? Si ia doli Xhon Mejxhëri, të cilin kukulla e tij e portretizonte me një zbehje të thellë gri, të mposhte më karizmatikun Kinnock në 1992? Prej këtij del fakti që votuesit janë më pak të predispozuar të manipulohen nga imazhet shkëlqyese sesa mendohet dhe se, në çdo rast, lideri tërheqës e praktik për një votues, është një bataçqi artificial për votuesin tjetër. Suksesi i Xhon Mejxhërit në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1992, sipas disave ka ardhur nga fakti që ai nuk ishte ambalazhuar si Reagani, Thatcheri ose Kinnocku, por shfaqej thjesht me gjithë dobësitë e tij. Disa vëzhgues në vitet 1990 diktuan një lëkundje lidhur me përqendrimin e partive tek imazhi (Bruce, 1992), dhe një kthim në taktikat autentike të të bërit fushatë, edhe pse kjo parapriu zgjedhjen e Toni Blerit si lider i laburistëve më 1994 dhe fitoret e shkëlqyera masive të partisë së tij në zgjedhjet e ardhshme të viteve 1997 dhe 2001. Të dyja ngjarjet janë perceptuar me të drejtë si triumfe të marketingut politik dhe të menaxhimit të imazhit (rimodelimi "i Ri" i Partisë Laburiste dhe Toni Bleri si tipi i mirë, i ri, dinamik dhe që e donte familjen, në kontrast të plotë me gogolët e krahut të majtë të laburistëve një vit më parë).

Ngritja e krijuesit të imazhit është e lidhur me ngritjen e imazhit dhe është e ilustruar me historinë e Partisë së Re Laburiste. Këtu shohim pikëpamjet e shumë vëzhguesve, që politika në rastin më të mirë duhet të udhëhiqet nga politikanët e jo nga radhët në rritje të sondazh-bërësve profesionistë, reklamuesve, këshilluesve të marketingut dhe nga ekspertët e marrëdhënieve me publikun, të cilët tani punësohen rëndom nga organizata, për të hartuar dhe organizuar strategjitë e komunikimit të tyre politik. Nëse politikat përcaktohen gjithmonë e më tepër nga opinioni publik, atëherë hartimi dhe prezantimi i politikës u delegohen atyre, interesat e të cilëve nuk janë medoemos ato të publikut.

3.4. Diskursi politik, qëndrime dhe konsiderata.

Në sistemin shoqëroro-politik ka qëllime plotësisht të qarta, prej të cilave themelor është ai që e përkrah dhe modifikon përparimin social. Realizimi i këtij qëllimi e detyron politikën të kërkojë njëfarë ballansimi – jo në kuptimin e konservatizmit apo mohimit të ndryshimit, por në kuptim të “balancimit të sistemit”: balancim ndërmjet ndikimeve të brendshme dhe të jashtme, balancim ndërmjet nënsistemeve. Në esencë, ekziston një balancim qendror në çdo sistem politik: mirëkuptim ndërmjet sunduesve dhe të sunduarve. Nëpërmjet arritjes së tij sistemi politik bëhet njëkohësisht garant për pranimin e regjimit nga ana e të sunduarve dhe i të gjithë asaj që përfshinë ai, si dhe i mundësisë që sunduesit t’i imponojnë vendimet e tyre që i kanë marrë. Në fakt, këto janë dy aspektet e komunikimit politik. Pajtimi ndërmjet sunduesve dhe të sunduarve sqaron pse masat e pranuar nga sistemi politik paraqiten dhe zbatohen në shoqëri. Kështu sistemi politik luan rolin e rregullatorit të atij rendit – harmonizimin e tij, si dhe rënia e tij është rezultat i veprimit të tij, që në njëfarë mënyrë varet nga shkalla e lartë e funksionimit efektiv të komunikimit. Çdo qytetar i pakënaqur nga sistemi duhet të ndikojë në sistemin politik,

që të mund të arrijë ndryshimin e rendit. Kjo kërkesë e përcaktimit të ri të rendit kolektiv ka si rezultat prishjen e ballansimit në shoqëri, periudhën tranzitore, kur vlerat e vjetra janë “harxhuar”, ndërsa ato të reja janë përcaktuar keq. Komunikimi duhet të lejojë sigurimin e legjitimitetit të vlerave, të cilat janë të reja, ose nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë tek këto, ose nëpërmjet imponimit të simboleve të reja. Me fjalë të tjera, vlerat të cilat shoqëria i thekson nëpërmjet sistemit politik, duhet të jenë ato, që shoqëria i kërkon, pranon, i njeh, ky pajtim në esencën e vet është rezultat i komunikimit ndërmjet sunduesve dhe të sunduarve. Që nga paraqitja e politikës janë ndërtuar dhe janë bërë angazhime për teknika dhe metoda të ndryshme të realizimit efektiv të komunikimit ndërmjet politikanëve dhe popullit. Forma e parë historike e komunikimit në fushën e politikës është propaganda. Shfrytëzimi i propagandës lidhet në radhë të parë me të shkaktuarit e veprimeve konkrete. Në radhë të dytë, propaganda ka për qëllim ta armatos politikën me metoda efikase dhe së fundi t’i japë vendimeve politike kontinuitet të qëndrueshëm. Hulumtues të ndryshëm e definojnë propagandën në mënyra të ndryshme. Por në të gjitha përkufizimet veprimtaria “propagandë” lidhet me shkallën e caktuar të mashtrimit dhe manipulimit. Karakteri manipulues i propagandës rrjedh nga esenca e mundit të komunikimit. Propaganda synon të formojë konstrukte të qëndrueshme, të cilët do t’i motivonin sjelljet konkrete politike. Arritja e këtyre konstrukteve të qëndrueshme lidhet me formimin e vlerave dhe socializimin e personalitetit, domethënë me adaptimin e individit ndaj shoqërisë, nëpërmjet konformizmit të tij.

Termi “polemikë” na shpie te ideja e konflikteve verbale ndërmjet politikanëve. Por konflikti nuk është karakteristik vetëm për elitën politike: ai funksionon në të gjitha nivelet e shoqërisë. Harmonia sociale dhe konflikti social paraqesin dy situata sociale, të cilat janë realisht të njëjta. Vetëm se ato i nënshtrohen dy logjikave të ndryshme të kundër

sociale. Domethënë duhet dalluar konfliktin social dhe konfliktin gjuhësor. Gjatë konfliktit gjuhësor bëhet fjalë për një realitet specifik gjuhësor dhe diskurziv, i cili mund të ndërpritet (por nuk është i domosdoshëm, nga konflikti social). Kuptimi i komunikimit konfliktuoz është në përpjekje që të vësh kundërshtarin në vendin saktësisht të caktuar (social dhe politik). Kur e cilësojmë, për shembull, bashkëbiseduesin tonë “si socialdemokrat” përpiqemi ta vëmë në vendin (në këtë rast politik), i cili me siguri nuk është pozicioni i tij. Në fakt, me diskutin konfliktuoz përpiqemi të realizojmë “zhvendosjen” e personalitetit të kundërshtarit tonë, ashtu që të fitojmë betejën kundër diskutit të tij. Më shpesh bëhet fjalë për zhvendosje të mundshme. Personi i atakuar përpiqet t’i mbrojë qëndrimet e veta personale dhe esencën e tyre, dhe në këtë rast ai hyn në konflikt.

Me diskursin didaktik përpiqemi t’i japim recipientit informatë, të cilën ai nuk e di, ndërsa me diskutin konfliktual synojmë të hedhim poshtë informatën që e ka marrë recipienti ose që mund ta marrë. Në fakt diskursi konfliktuoz gjithnjë është kontradiskurs. Autori i tij gjithnjë ka parasysh dy kushte: kundërshtarin dhe publikun – dëshmitarin. Qëllimi i tij është:

1. Lufta kundër ideve, tezave dhe qëndrimeve të kundërshtarit;
3. Triumfi apo fitorja e tezave dhe qëndrimeve të veta;
4. Ndarja e fitores me publikun, i cili është dëshmitar i konfliktit. Recipienti, domethënë nuk është vetëm kundërshtar konkret por edhe shumicë e madhe. Në fakt, qëllimi i diskursit konfliktual (posaçërisht në politikë) është që një numër sa më i madh i recipientëve të tërhiqen dhe të fascinohen me fitoren, në fakt të shndërrohen në pjesëmarrës në betejë dhe të ndajnë triumfin e fitores. Domethënë diskursi konfliktual

paraqet shndërrimin e konfliktit në spektakël, i cili duhet të vlerësohet nga publiku në të kundërtën kuptimi i konfliktit humb.

Diskursi konfliktuoz është “kontradiskurs” edhe në kuptimin se autori i tij e pranon diskursin e kundërshtarit në të njëjtën kohë, që ta hedhë poshtë dhe ta imponojë të vetin. Rregulli në këtë rast është që asnjëherë të mos merret diskursi i kundërshtarit ashtu siç është, ai duhet të ndryshojë, të manipulohet, dhe së tepërmi, të falsifikohet duke marrë parasysh qëllimet dhe synimet tona.

Diskursi politik shihet në këto kontekste: parlament, fushatë elektorale, fjalime politike në parti/media.

Diskursi politik i ka rrënjët e tij në kohërat e demokracisë antike. Për grekët e lashtë termi *polis* nuk korrespondonte me termin qytet, ashtu siç ne e kuptojmë. Në vend të kësaj, me termin polis identifikohet një komunitet në të cilin çështjet publike ishin punë e të gjithë qytetarëve. Parlamenti nuk i kërkonte pjesëmarrësit e tij e as gjykata nuk i kërkonte anëtarët e jurisë. Athinasit e lashtë bëheshin vetë pjesë e këtyre si dhe e shihnin demokracinë radikale si një detyrë dhe një besim në komunitet dhe pjesëmarrje, në çështjet që kishin të bënin me ata vetë. Ata, të cilët ishin më pak të pasur mund të merrnin pjesë duke qenë të pranishëm në parlament. Nga ata më të pasurit pritej më shumë siç ishte p.sh. tregtimi me anije, apo ndërtimi i ndërtesave publike. Natyra e sistemit kërkonte pjesëmarrje, por gjithashtu kjo kërkonte edhe që qytetarët të flisnin. Pas një kohe u vu në dukje se aftësia primare politike e kësaj kohe, ishte aftësia për të folur në mënyrë efektive, me qëllim të mbrojtjes së interesave.

Struktura institucionale e demokracisë antike kërkonte pjesëmarrje dhe në mënyrë strukturore, kjo pjesëmarrje duhej të ishte në të folur: qytetarët me qëllim që të merrnin pjesë duhej të flisnin. Për grekët e lashtë praktika e retorikës ishte praktika e shkencës

politike. Prej strukturës së praktikës politike greke mund të themi se grekët e shihnin politikën si një proces social multidimensional, për të shtyrë politisin që të punojë. Në secilën pikë të procesit dikush nga qytetarët ishte ngarkuar me detyrën për të marrë vendime. Këto vendime merreshin përmes shqyrtimit dhe votimit të fjalimeve. Për grekët të flasësh do të thoshte të qeverisësh.

Si shembull i komunikimit politik të drejtëpërdrejtë në kohën antike mund të merret Agora. Agora ishte tregu/pazari, në të cilin nuk shkëmbeheshin vetëm mallra, por edhe informacione dhe opinione. Agora ishte një forum politik, komunikativ dhe aktiv nga i cili dilte opinioni publik.

Në nivelin elementar gjuha paraqitet si përmbledhje tingujsh. Në nivelin sekondar këto tinguj kombinohen me idenë të shkaktuar prej tyre që të fitohet gjuha e shoqërisë.

Gjuha është njëkohësisht krijim i individëve të caktuar, por, gjithashtu edhe fenomen social, rezultat i përpjekjeve të shoqërisë. Por ajo gjithnjë është rezultat dhe institucion i së kaluarës. Në të tashmen ne veprojmë nëpërmjet gjuhës, të krijuar në të kaluarën. Prandaj në gjuhë rëndësi të posaçme kanë konstruktet dhe normat, nëpërmjet të cilave “është arritur” kuptimi i logjikës.

Logjika fshihet jo vetëm në fjalë, por edhe në të ashtuquajturin komunikim jo verbal - gjeste, mimikë, të folurit e trupit, që jo vetëm mund ta plotësojë gjuhën, por shpesh edhe vet janë bartës të logjikës.

Në politikë roli i gjuhës është i madh, sepse ajo e shpreh dhe e garanton demokracinë. Ashtu siç Tukididi ia tërhoqi vërejtjen Perikliut: “njeriu i cili di të mendojë, e nuk di si t’i shprehë mendimet e veta, është në nivelin e atij që nuk di të mendojë”. Problemi në politikë shprehet jo vetëm me zotësinë e të shprehurit të mendimeve. Ai qëndron edhe në mundësinë që të ngrihet kodi i përbashkët (të kuptuarit e përgjithshëm të logjikës)

ndërmjet sunduesve dhe të sunduarve. Së këndejmi rëndësia e komunikimit është në aftësinë e politikanëve t'ua sqarojnë qëllimet dhe solucionet e tyre qytetarëve, ndërsa zotësia e qytetarëve është që t'i shprehin interesat dhe dëshirat e tyre ashtu që politikanët të mund t'i kuptojnë ato.

Funksionet e fjalës publike mund të përmbliidhen në dy qëllime të lidhura reciprokisht dhe të kushtëzuara reciprokisht: të njoftojmë “informojmë” dhe të bindim. Paraqitja e mendimeve, ndjenjave, përvojave, njohurive, ideve mund të quhet informim. Ndikimi e një informate të caktuar në vetëdijen, mendimet, ndjenjat, dhe sjelljen mund të quhet bindje. Të dyja aktivitetet lidhen me një proces të komunikimit. Njeriu nuk kryen kurrfarë veprimi nëse nuk beson se ekziston ndonjë kuptim për ta kryer; nëse nuk është i bindur se do të arrijë diçka. Bëjmë këmbimin e informatave, sepse në të kundërtën nuk do të mund të jetojmë dhe të zhvilloheshin në shoqëri. Shprehemi, sepse besojmë se atij që i flasim do të na besojë, do të mund ta bindim në vlerën e shkëmbimit të mendimeve. Nga ana tjetër, që ta detyrojmë ndonjë të na besojë, duhet ta bindim me të drejtën tonë, duhet ta ndajmë me të informatën, me të cilën ndërtohet bindja jonë. Kështu që informata përmban elemente të bindjes, ndërsa bindja është e pamundshme pa informatë. Në praktikën e komunikimit duke pasur parasysh situatën konkrete, njëri nga dy aktivitetet rëndom dominon. Kjo na jep të drejtë të flasim për dy lloje të fjalimit publik - informativ dhe bindës. Gjatë gjithë jetës sonë ne jemi objekt dhe subjekt të bindjeve. E drejta që të bindësh dhe të bindesh i karakterizon shoqëritë demokratike, sepse është poetike nga imponimi me dhunë i vullnetit të shumicës.

Komunikimi jo verbal, i njohur gjithësisht “gjuhë e gjesteve”, përfshin forma të tilla të shprehurit, që nuk bazohen te fjalët dhe simbolet e tjera të folurit. Që të mesohemi të kuptojmë gjuhën e komunikimit jo verbal është e rëndësishme për disa arsye. Së pari,

me fjalë mund të transmentohen vetëm njohuritë faktike, por që të shprehen ndjenjat, nuk mjaftojnë vetëm fjalët. Së dyti, njohja e kësaj gjuhe tregon se sa ne jemi të zotë të sundojmë vetveten. Nëse oratori e ka të vështirë të ballafaqohet me mllefin, ai e rrit zërin, sillet përreth, ndërsa ndonjëherë sillet si grindavec. Gjuha jo verbale do ta shprehte edhe atë, se çka mendojnë realisht për ne dhe për ata që na rrethojnë. Pavarësisht, se njerëzit i masin fjalët e veta dhe ndonjëherë i kontrollojnë gjestet e tyre shpeshherë mund të “shpërthejë” ndonjë ndjenjë e fshehur nëpërmjet mimikës, gjesteve dhe intonacionit të zërit. Të gjithë këta elemente jo verbalë të komunikimit mund të na ndihmojnë të bindemi në rregullshmërinë e asaj, që është thënë me fjalë ose, siç ndodh përherë, ta vëmë atë që është thënë në dyshim.

Nga shekulli i 18-të deri më sot njëra nga mënyrat më të përhapura të komunikimit publik është shtypi. Me konceptin “shtyp” nënkuptohen dy grupe të mëdha të botimit: gazetatat dhe revistat. Gazetat janë kryesisht të përditshme dhe javore. Kriteret themelore për zgjedhjen e mediumeve si mjet komunikimi janë: Ana periodike (të përditshme - të mëngjesit dhe të pasditës, javore); përfshirja territoriale (nacionale, rajonale, lokale dhe të brendshme të ndërmarrjeve); tirazhi; veçoritë e auditoriumit, madhësia dhe formati (standarde dhe tabloide). Karakteristikë e shtypit të Europës është edhe ekzistenca e edicioneve partiake. Viteve të fundit ekziston tendenca e botimit të gazetave, të cilat nuk janë organe të partive politike, por paraqesin qëndrime të caktuara idelogjike dhe përkrahin qëndrimin e partive të caktuara. Në fakt, ende në Evropën Juglindore dhe Qendrore (ish-vendet socialiste) hasen gazeta dhe revista të cilat janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të partive. Rëndom, pas proklamimit të zhurshmëm të disa botimeve, “të pavarura” fshihen grupe të fuqishme ekonomike, të cilat shfrytëzohen për të krijuar mendimin e mirë publik sipas interesave të tyre personale dhe fianciare.

3.5. Komunikimi në Shqipërinë e pas viteve '90

Rënia e Perdes së Hekurt ashtu si në mbarë Evropën Qendrore dhe Lindore solli ndryshime thelbësore edhe në shoqërinë shqiptare. Edhe pse më vonë se në vendet e tjera të Lindjes, rënia e komunizmit solli një metamorfozë të gjithanshme në politikë e ekonomi, por jo vetëm. Tronditja në shoqërinë shqiptare nuk mund të linte pa prekur edhe themelet e sistemeve të vlerave, tek të cilët qenë bazuar një larmi marrëdhëniesh sociale e njerëzore që e panë veten të zbuluar në një sistem të ri, fare të panjohur. Watzlawick tërheq vëmendjen për domosdoshmërinë e ekzistencës së një kornize elementesh që merren në shqyrtim në studimet e ndryshimeve të këtij lloji (Watzlawick, 1980). Ajo çka është interesante për punimin tim është analizimi i realitet të ri në fushën e komunikimit në dinamikën e re në të cilën u futën institucionet shtetërore shqiptare. Por çfarë trajtash merr procesi i komunikimit dhe si ndryshon ai në realitetet e reja , me të cilat përballet politika shqiptare pas viteve '90? Si janë zhvilluar elementët e tij si p.sh. gjuha në raport me zhvillimet e vrullshme që jo gjithmonë kanë qenë konstruktive? Duke u përpjekur të hulumtoj sendërtimin e procesit në përgjithësi nuk mund të anashkaloj edhe tipet kryesore të komunikimit që vihen re në shoqërinë shqiptare, por jo vetëm. Në fakt procesi i klasifikimit dhe analizimit të llojeve të komunikimit është standard dhe në ndihmë më vijnë ekspertë dhe teoricienë tradicionalë të fushës si McLuhan, i cili analizon rolin dhe funksionin e alfabetit si mënyrë komunikimi. Ai ngul këmbë në rëndësinë e procesit të transformimit të civilizimit European nga një civilizim që bazohej në të dëgjuarin në një syresh që në bazë të tij kishte leximin dhe ky transformim ishte thelbësor për procesin e komunikimit që tashmë përveç shqisës së të dëgjuarit përcillej tek ajo e të lexuarit. Siç u përmend më sipër, ai në kundërshtim me teoritë Marxiste, i mvesh medias meritën e stërmadhe të transformimit të njerëzimit duke ia hequr këto grada ekonomisë, politikës

apo shkencës që i kishin mbajtur deri në atë moment. Por komunikimi me anë të alfabetit (këtu nuk nënkuptohet vetëm media e shkruar, por edhe libri dhe dimension i kulturor dhe profesional që përfshin) nuk mbeti si një fidan i vetëm në hapësirën e pafund të komunikimit. Zhvillimi i zinxhirit komunikativ që sugjeron McLuhan nga dëgjimi në lexim shkon më tej duke përfshirë këtu edhe figurën edhe zërin e mediumit audioviziv siç sugjeron Fuga si një mënyrë për të kuptuar edhe ndryshimin e brezave në marrëdhëniet socio-kulturore dhe padyshim si pjesë thelbësore e procesit të komunikimit. (*Fuga, 2009*). Ajo që vlen të përmendet është pikërisht implementimi i këtij evoluimi të procesit zinxhir në shoqërinë shqiptare të pas viteve '90. Me etjen e një shoqërie të mbetur thuajse në errësirë, çelja gazetave të para u prit si uji në shkretëtirë për t'i dhënë lexuesit të pamësuar me shumëllojshmërinë e lajmit dhe burimeve, mundësinë e zgjedhjes dhe seleksionimit të tij. Gjithnjë në valën e komunikimit alfabetik lulëzuan edhe botimet e ribotimet jo vetëm të veprave të reja e bashkëkohore, por edhe të atyre që më parë ishin përballur me censurën e regjimit. Gjithsesi kjo formë tradicionale e komunikimit nuk hasi në qëndresë se në thelb të saj nuk përbënte ndonjë risi në formë, por lulëzimi i medias audiovizive dhe boom-i i saj i pas viteve 2000 pati vështirësi. Shqipëria e fillimit të viteve '90 ndryshon ndjeshëm nga ajo e vitit 2009 sa i përket larmisë së informacionit. Komunikimi alfabetik nuk është mënjeluar, por nuk mban më monopolin siç ndodhte dikur. Zhvillimi i vrullshëm teknologjik i medias audiovizive me lindjen dhe rritjen e shumë kanaleve televizive, radiove dhe oferta e pasur që ato sjellin në treg e ka bërë qarkullimin e informacionit shumë të shpejtë për të mos folur për elemente të tilla siç janë interneti dhe rrjetet sociale që mundësojnë shpërndarjen e tij në kohë reale. Por gjithsesi nuk mendoj se ka vend për eufori. Shqipëria është vendi i paradokseve dhe disniveleve të mëdha, mungon njëtrajtshmëria në zhvillim dhe paradigma e mësipërme nuk shtrihet në të gjithë

territorin. Ish-Kryeministri i vendit Sali Berisha deklaroi në 19/10/2008 në Bajzë të Malesisë së Madhe:

“Brenda muajit mars të vitit që vjen do të përfundojë instalimi i kabinetëve të informatikës në të gjitha shkollat e vendit dhe më pas, hapi tjetër do të jetë shtrirja e përdorimit të internetit në çdo familje dhe kudo në komunitet”.

Të njëjtën retorikë përdori ai edhe në një takim elektoral në Jug të vendit, në Kucovë më 06/06/2009 kur thotë se:

“Për ne, Shqipëria evropiane, Kuçova evropiane do të thotë që fëmijët tuaj të mësojnë në shkollë të standardeve evropiane. Sot interneti është në çdo shkollë. Ne do ta shtrijmë moshën digjitale në të gjithë vendin”.

Bazuar në retorikën e përdorur mund të analizojmë në hollësi cilësinë e komunikimit jo alfabetik. Shkolla tradicionale ruan me fanatizëm rëndësinë e komunikimit alfabetik të bazuar në peshën e shkronjës dhe në kapitullin në vijim grupi i politikanëve të intervistuar do të ballafaqohet edhe me këtë temë dhe ndërsa në retorikën e tyre vendin më të madh e zë dixhitalizimi i popullsisë, në realitet ata veprojnë ndryshe.

Në fakt bën përshtypje preferenca e tyre për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë me elektoratin duke mos i zënë fort besë mjeteve moderne të komunikimit masiv si interneti dhe rrjetet sociale të tipit Facebook apo Youtube që në kohë dhe hapësirë thyejnë çdo rekord por ajo ç’ka duhet mbajtur parasysh është dhe fizibiliteti i një komunikimi të tillë.

“Duke qenë se kostot e komunikimit tradicional vijnë gjithnjë e në ngritje, rrjetet me bazë Internetin i kanë ulur kostot e komunikimit aktivist”. (*Pels, Corner, 147*)”.

Shqipëria në 10 vjeçarin e parë të pas komunizmit, ka patur një infrastrukturë teknologjike që nuk i kalon kufijtë e kryeqytetit apo qyteteve më të mëdha pa u rrekur të shpërndahet në çdo cep të vendit dhe ky element nuk është për t’u injoruar. Politikanët preferonin të mos rrezikonin dhe për këtë arsye i qëndronin besnikë mënyrave klasike për

të mbërritur pranë elektoratit. Një shembull për këtë tezë është edhe rasti i sipërpërmendur i ndërtimit të shkollave apo restaurimi i tyre dhe pajisja me një klasë me kabinetin e informatikës, por sa i vlefshëm është ai në mungesë të energjisë elektrike të vazhdueshme, element shumë bazik që zhvleftëson gjithë investimin në fjalë. Pra në kushte të tilla si mund t'i besohet vetëm komunikimit të avancuar teknologjikisht? Skepticizmi ndaj tij nuk është i pavend edhe pse modelet që klasa politike shqiptare përdor janë të lidhura pazgjidhshmërisht me avancimin teknologjik.

Në vitet e fundit situata e komunikimit është përmbysur. Janë hapur dhjetëra platforma online që kanë në qendër të vëmendjes përcjelljen e mesazheve politike tek populli. Sot mund të thuhet pa frikë që mesazhi i përçuar nëpërmjet mediave online, mund të mbulojë rreth 80% të popullsisë. Përmendim këtu dy platformat kryesore politike, të administruara nga lideri historik i partisë demokratike, Sali Berisha, platforma “Qytetari dixhital”, si dhe platforma “ERTV” (akronim i Edi Rama TV).

Një formë tjetër e komunikimit që trajton Fuga është edhe komunikimi me shifra dhe këtu nuk bëhet fjalë për asnjë alfabet mors të përdorur çuditshëm (Fuga A., 2008). Ky komunikim bën të mundur vendosjen e një ure mes qytetarit dhe shtetit, institucioneve dhe legjitimitetit të tyre. Jo rastësisht në çdo fushatë elektorale komunikimi shifror bëhet më i pranishëm për t'u përdorur si retorikë në njërin apo tjetrin kah të saj me qëllime të pastra përfitimi politik. Por sa i besueshëm është ai? A është pre e mosbesueshmërisë së përgjithshme që zotëron në Shqipëri sa i përket këtij procesi? Në plan të parë mund të mendohet që jo sepse shifrat lënë pak hapësirë për spekulim dhe të gjithë faktorët janë shumë të interesuar për të qenë të qartë mbi elementët siç janë buxheti, investimet, niveli i papunësisë dhe shifrat duket sikur nuk lënë vend për interpretime, por në fakt edhe ky komunikim ka pikat e veta të dobëta në shoqërinë shqiptare duke marrë parasysh si ai bie

pre i retorikës. Ajo çka e bën komunikimin shifror të mos ndryshojë në besueshmëri nga tipet e tjera është metodologjia e përdorur për të arritur në shifrat aq të dashura dhe tek të cilat ne përpiqemi të mbahemi aq fort. Por në fakt ky besim biblik tek shifrat fashitet sapo në analizojmë se kush i ka nxjerrë ato, si i ka përpunuar, sa të besueshme kanë qenë të dhënat e mbledhura dhe sa përfaqësuese janë ato. Në këtë prizëm problemi pushon së qeni përllogaritës dhe thjesht statistikor dhe nis kalvari i dyshimit me sfond politik. Sa i pranishëm është ky problem në procesin e gjerë të komunikimit në Shqipëri do ta tregojnë shembujt e mëposhtën, që fatkeqësisht nuk janë të vetmit. Në hapjen e fushatës elektorale Edi Rama, kryetar i Partise Socialiste në datë 01/06/2009 thotë se:

S'mund të ketë në Shqipërinë si gjithë Europa 1/5-ën e territorit të vendit pa këmbë mjeku e infermieri dhe pa asnjë lloj pike shërbimi shëndetësor, ndërkohë që në pjesën më të madhe të hapësirës rurale ky shërbim ekziston vetëm në listëpagesa mjekësh që duken vetëm për të marrë rrogën. Janë mbi 40% qytetarët shqiptarë që nuk janë të mbuluar nga sigurimet për shkak të varfërisë dhe që në rast nevojë u duhet ose të paguajnë nën dorë ose të vdesin kur s'kanë të paguajnë. Dhe janë mjekët e infermierët, që padrejtësisht, janë vënë në shënjestër si fajtorët për një gjendje alarmante që prej 18 vjetësh nuk alarmon politikën, po vetëm të sëmurët e familjarët e tyre.

Po e njëjta situatë ndodh edhe në kahun tjetër të politikës kur ish-Kryeministri Berisha në 27. 05. 2009 në një fjalim elektoral deklaroi se:

"Ne kemi asfaltuar tërësisht rrugët e komunës Xhafzotaj, po asfaltojmë tërësisht rrugët e Katundit të Ri, kemi ndërtuar një sërë shkollash, kemi shtrirë internetin në të gjitha shkollat e fëmijëve tuaj, kemi rritur pensionet e të gjithë fermerëve të fshatit 100 për qind, kemi rritur pensionet në qytet nga 50 deri në 70 për qind, kemi dyfishuar pagat e mësuesve, mjekëve dhe infermierëve." (Berisha, 2009).

Por sa të besueshme janë këto shifra? Ku bazohen ato? Çfarë metodologjie është përdorur për të arritur në të tilla përfundime? A është ky vetëm një përdorim i retorikës për interesa të pastra elektorale?

Të njëjtën pamundësi për t'i verifikuar faktet e sipërpërmendura shfaq edhe polemika në distancë sa i përket relacionit për buxhetin 2008-2009:

“Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 treguesit afatshkurtër statistikor të cilët paraqesin performancën e sektorit real tregojnë për ecuri pozitive të ritmeve të rritjes. Vlen të theksohet se të gjithë treguesit afatshkurtër (PBB tremujore, etj) tregojnë për një rritje pozitive të ekonomisë në intervalin 4-6 përqind, gjë e cila e rendit ekonominë tonë, si një nga ekonomitë më pak të prekura nga kriza ekonomike globale. Informacioni që japin treguesit statistikorë afatshkurtër për tremujorin e parë mbështetet gjithashtu edhe nga disa indikatorë “indirekt” të performancës së disa prej taksave kryesore, si p.sh TVSH-ja. Gjithashtu një rritje prej 19 përqind u regjistrua në të ardhurat nga Akciza të mbledhura nga prodhimi vendas i mallrave me akcizë”.

Ky paragraf i shkëputur është cituar në kontekst me paragrafin e mëposhtëm për të dhënë idenë e kontrastit dhe kundërshtisë së shifrave.

Në një deklaratë për shtyp Sekretari për Programin në Partinë Socialiste shprehet se:

“Në mënyrë të përsëritur, për disa muaj rresht administratat tatimore dhe doganore vijojnë të mos mbledhin të ardhurat e programuara. Deficiti i krijuar nga mosmbledhja e të hyrave është 185 milionë dollarë. Deficiti i krijuar nga mosmbledhja e të ardhurave në tatime e dogana është 155 milionë dollarë. Realizimi i planit të tatim fitimit vetëm me 84% dëshmon qartë për vështirësitë që kalojnë sipërmarrjet shqiptare. Realizimi i planit të kontributeve të detyrueshme vetëm me 94% dëshmon përsëri qartë se nuk kemi rritje të punësimit siç është premtuar nga qeveria. Në 8 muajt e parë të 2009 është mbledhur si tatim mbi vlerën e shtuar vetëm 4.3% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2008. Në kushtet që 70% e TVSH-së mbledhet në dogana dhe në kushtet e zhvlerësimit të monedhës vendase me të paktën 6% krahasuar me një vit më parë, rezulton se ekonomia shqiptare nuk është rritur në 8 muajt e parë të vitit 2009. Kjo është e dhëna më e saktë, e dalë nga raportimet zyrtare të vetë ministrisë së financave që dëshmon se deklaratimet e Kryeministrit dhe Ministrit të Financave për rritje ekonomike janë të gënjeshtërt (Beqja, 2009)”.

Shifrat kontradiktore që paraqiten si argumente të palëve të përfshira në debat nuk bëjnë gjë tjetër veçse çorientojnë totalisht receptuesin dhe në këtë mënyrë edhe komunikimi me shifra humbet besueshmërinë që i jep origjina e tij dhe për hir të metodave dhe përdorimit politik nuk bën gjë tjetër veçse kthehet në një retorikë boshe dhe aspak të vlefshme. Ajo çka lipset është bërja me dije e metodologjisë dhe transparencës së mënyrës së daljes në shifra të tilla që tashmë nëse humbin besueshmërinë, nuk lënë më me gojë hapur asnjë me gjuhën e tyre precize.

Periudha e viteve 1990-2015 karakterizohet nga një realitet shumë interesant në një

përpyjekje të vazhdueshme për të instaluar një regjim demokratik, pjesë e të cilit është padyshim dhe klasa politike dhe mënyra sesi ajo ka ndërtuar marrëdhëniet jo vetëm mes shtresave të ndryshme brenda vetes, por edhe me ambientin e jashtëm. Një tranzicion i stërzgjatur që mbart me vete shumë dramë dhe traumë, tronditje të rëndë të vlerave morale dhe adaptimin e një sistemi të ri ekonomik të shoqëruar me kriza të vazhdueshme ekonomike, sociale dhe politike.

Pjesë e kësaj panorame është edhe sistemi komunikues që politika ka ndërtuar me publikun, sistem ky që nuk mund t'i shpejtojë luhatjeve dhe tensioneve që vetë shoqëria shqiptare ka përjetuar në këto vite duke mos pasur një strategji orientuese, por duke u udhëhequr nga spontaniteti dhe sporadizmi dritëshkurtër.

Mungesa e kësaj strategjie ka çuar në raste ekstreme siç janë imitimet e këqija të modeleve ndërkombëtare pa u përpyekur t'i përkthejë në përvojë të vetën, por duke ndjekur shabllone shumë të huaja për realitetin specifik shqiptar ose duke ndjekur kokëfortë një rrugë të pashkelur më parë e duke sfiduar çdo rekomandim e këshillim, duke e futur veten në qorrsoakë institucionale e politike që vështirë se mund të harrohen. Më poshtë do të vijojë dhe zbërthimi hap pas hapi i tematikës së këtij punimi duke shpjeguar dhe metodologjinë kërkimore.

Situata e komunikimit në Shqipëri do të vijë nëpërmjet një vështrim të përgjithshëm, vështrim ky që do të hulumtojë rolin e medias si pjesë sendërtuese e procesit të komunikimit në shoqërinë shqiptare pas viteve '90 duke u ndalur në tiparet e komunikimit, por jo vetëm. Një pyetje që do të marrë përgjigje gjatë këtij punimi është edhe ajo, e cila i referohet funksioneve të medias në procesin e komunikimit dhe kjo do të arrihet nëpërmjet analizës së llojeve të komunikimit dhe marrëdhënies mes gjuhës dhe komunikimit. Elementë shumë të rëndësishëm të komunikimit në Shqipëri konsiderohen

edhe ai fetar dhe etnik, elementë këta që do të gjejnë pasqyrimin e duhur. Por si sillen media me politikën dhe vice - versa?

Çfarë lloj marrëdhënie kanë ndërtuar ata dhe sa ndikon kjo e fundit në procesin e komunikimit me publikun? Prodhon politika lajm në media, apo është media që prodhon politikë dhe nëse po, si e realizon këtë proces?

KAPITULLI IV:
DISKURSI POLITIK, VLERAT DHE SJELLJA E LIDERIT POLITIK
SHQIPTAR

4.1. Shekulli i ri i politikës shqiptare

Politika shqiptare që pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë e deri më sot duhet shikuar, para së gjithash, si një proces politik me të gjitha fazat që zakonisht i përmban një proces. Në fakt, të kuptuarit e zhvillimeve politike dhe të sistemit politik të një shteti apo kombi bazohet në njohjen e fazave të procesit politik.

4.1.1. *Procesi politik;*

Shqiptarët sikurse çdo qytetërim tjetër europian bëjnë një përmbledhje të arritjeve, por edhe të dështimeve të njëqindvjeçarit të kaluar. Megjithatë, me këtë rast që të ndriçojmë këtë proces politik në përmbledhjen e këtij qindvjeçari, para së gjithash, mendohet për parimet dhe vlerat e politikës shqiptare. Po ashtu në këtë kapërcyell duhet të kemi njëkohësisht parasysh edhe platformat mbi të cilat duhet të bazohet shekulli i ri i politikës shqiptare. Kuptohet që në të dy drejtimet e kësaj përmbledhjeje të politikës shqiptare duhet marrë parasysh në vazhdimësi edhe ambjentimi me nevojat imediate të politikave të kohërave të reja dhe sfidave të reja, sikurse nuk duhet të harrojmë edhe faktorin tjetër determinues të ruajtjes së vlerave autoktone politike dhe të elementeve të tjera të strumbullarit të vizionit dhe procesit politik shqiptar.

Po ndodh shpeshherë që vrojtuesit politikë të kohës së sotme kur flasin për politikën shqiptare në shikim të parë ta shohin atë si një fenomen që asociohet me zënkat dhe konfliktet në skenën politike. Mirëpo, ky perceptim (më tepër asociues sesa i thellë) përfshin në vetvete vetëm një politikë çasti. Zënkat dhe konfliktet në skenën politike

shqiptare në parim nuk kanë të bëjnë as me traditën e as me kulturën politike shqiptare. Ato janë vetëm një flesh-imazh i kohëpaskohshëm nga tërësia e procesit politik. Shfaqje si ajo e ‘çizmes’ së famshme të Monika Kryemadhit në vitin 2017 apo ‘përleshja’ me vezë e miell në sallën e parlamentit shqiptar, nuk mund të përbëjnë traditën politike shqiptare.

Sikurse çdo proces politik, edhe procesi politik shqiptar përbëhet nga segmente të ndryshme përfshirë ndonjëherë edhe zhvillime negative dhe atipike. Meqë nuk duhet të harrojmë se gjeneza e një procesi politik në parim është ekzistenca e shumëllojshmërisë së interesave, të cilat ndonjëherë mund të rezultojnë edhe me kërkesa dhe sjellje të ndryshme. Prapëseprapë, edhe përkaj imazheve të tilla atipike, tërësia e zhvillimeve politike shqiptare paraqet një proces politik që në esencë mbështetet në vlerat e paqes, demokracisë, konstruktivitetit dhe tolerancës.

Procesi politik njëqindvjeçar i shqiptarëve në thelb është një rrugëtim shumë i gjatë, tejet dinamik dhe aspak i rëndomtë. Pa marrë parasysh të gjitha luhatjet, ngritjet e rëniet, sidoqoftë ky proces politik në kontinuitet ka arritur që të sillet në kuadër të kornizës së vet tipike dhe origjinale që në esencë mbështetet në vlerat e universale e të humanizmit. Kuptohet këto dy kategori vlerash të përgjithshme i identifikojmë nëse procesi i politikës shqiptare vrojtohet nga një perspektivë objektive e reale, duke e parë këtë proces nga një këndvështrim më i gjerë e global, e jo vetëm siç jemi të prirë që gjërat fatkeqësisht t’i shohim në kuadër të kornizës më të ngushtë të një pikturë të vogël, që shpeshherë na bën që aty të mashtrohemi.

Procesi i politikës shqiptare fillon shumë më herët se në vitin 1912. Ky proces fillon qëkurse nis rrugëtimi i gjatë i përgatitjes së lançimit të projekteve për themelimin e shtetit shqiptar dhe qëkurse nis beteja disashekullore për liri, përgatitjet e së cilës janë të

përcjella dhe të frymëzuara gjithë kohën me mendimin politik të rilindasve shqiptarë. Porse si çdoherë edhe deri në vitin 1912 (sikurse edhe tani në shumë procese) shpeshherë na mungojnë vlerësimi dhe implementimi i hapit të fundit, sikurse edhe hapi që shpie drejt rrumbullakimit të simbolikes në proces. Kështu që viti 1912 duhet të konsiderohet si viti i zyrtarizimit dhe përmbylljes së simbolikes në Shpalljen e Pavarësisë së shtetit shqiptar modern. Me këtë vit nis rrugëtimi i politikës moderne shqiptare. Në fakt kjo politikë që në fillimet e saj e këtij profilizohet si një politikë moderne evropiane që për fanar të vetin njeh mendimin politik humanist dhe universal të rilindasve shqiptarë, pra duke e ndjekur e mbajtur gjithnjë rrugën e profilimit të politikave të tjera moderne evropiane, të cilat në thelb po ashtu mbështesin politikat e tyre tek mendimi politik dhe filozofik i iluministëve dhe i humanistëve të dalluar europianë.

4.1.2. Filozofia politike;

Që të kuptosh filozofinë e procesit politik shqiptar, në asnjë moment nuk duhet lejuar që të harrohet edhe historia e ndikimit të mendimit politik të rilindasve shqiptarë, idetë dhe frymëzimi i të cilëve formësuan parimet, vlerat dhe orientimin perëndimor të politikës moderne shqiptare të njëqindvjeçarit që lamë pas.

Rrjedhimisht, mendimi politik i rilindasve shqiptarë paraqet njëkohësisht një nxitje, por dhe sfidë intelektuale për studimin e politikës së re shqiptare dhe zhvillimin e mëtejshëm të mendimit politik që nga periudha antike e deri më sot. Ky mendim ndikon dukshëm në formimin e politikës moderne shqiptare, por edhe të politikave të mëhershme shqiptare. Sami Frashëri¹ në veprën e tij të traktatit politik mbi çështjen shqiptare, të titulluar "*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*", i cili u bë manifesti i Rilindjes

• ¹ Frashëri S., *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet* (1899)

Kombëtare Shqiptare, sintetizoi programin e lëvizjes, strategjinë dhe taktikën e saj. Në të u shprehën idealet demokratike të zhvillimit politik e shoqëror të vendit, të zhvillimit të arsimit, të kulturës e të shkencës.

Ky mendim politik njëkohësisht ndikon qoftë me aktivitete të drejtpërdrejta, qoftë si formë frymëzimi edhe në formësimin e politikave dhe institucioneve të shumë kombeve të tjerë gjatë shekujve të kaluar, ashtu sikurse sot që shumë shqiptarë me aktivitetet e mendimet e tyre i dhurojnë civilizimit bashkëkohor idetë dhe kontributin e tyre në përpilimin e strategjive, doktrinae e politikave publike në nivel botëror.

Në thellësinë e politikës moderne shqiptare qëndron filozofia morale e cila në teori identifikohet si ai lloj i filozofisë që fokusohet në ekzistencën e njerëzve dhe prandaj njihet edhe si humaniste. Materia e studimit të saj është bota shoqërore, ose thënë me fjalë të tjera natyra njerëzore dhe vlerat njerëzore. Përpjekjet e vazhdueshme për një liri kuptimplotë dhe gatishmëri të vazhdueshme për bashkëpunim me kombet me fat të njëjtë të përvuajtur e liridashës kanë bërë që në fokus të filozofisë politike shqiptare të gjendet pikërisht natyra njerëzore dhe vlerat njerëzore.

Si vazhdim i një tradite të tillë të udhëheqjes nga një filozofi humaniste, politika moderne shqiptare që nga pavarësia e Shqipërisë e këtej, ndryshe nga shumë popuj të tjerë të Ballkanit, në asnjë moment nuk përpilon e as nuk përdoret me platforma destruktive, as me doktrina të ekspansionit me çmim ndaj humanes. Sepse procesi politik shqiptar zhvillohet gjithë kohën në frymën e filozofisë së tij humaniste dhe mendimit të sendimentuar politik të rilindasve shqiptarë, pavarësisht fazave dhe vështirësive të periudhave të ndryshme. Ato janë premiset e filozofisë politike shqiptare dhe vlerat e procesit politik shqiptar. Dhe ato nuk zhbëhen e nuk ndryshohen lehtë, meqë thjesht është logjika që e formëson politikën moderne shqiptare.

4.1.3. Format e organizimit politik dhe modelet e qeverisjes;

Të shkruash për karakteristikat reale, idealet dhe diskursin objektiv të politikës shqiptare gjatë qindvjeçarit të kaluar do të thotë që të kesh parasysh periudhat edhe të shumë patriotëve e tradhtarëve; edhe të ditëve të lavdishme, por shpeshherë edhe të turpshme, edhe të dështimeve, zhgënjimeve e tradhtive, edhe të korrupsionit e udhëheqjeve autokratike dhe jo vetëm të kesh parasysh elementet glorifikues të procesit politik.

Shumë pak popuj të tjerë në botë kanë përjetuar fatin e rëndë dhe janë aq të përvuajtur siç ka ndodhur me rastin e popullit shqiptar. Mbase, mes të tjerash, përpos faktorëve globalë e rajonalë, kjo ka ardhur edhe si rezultat i llojeve të ndryshme të praktikimit të organizimit dhe udhëheqjes politike. Shqiptarët, si rrallë ndonjë popull tjetër në historikun e civilizimeve bashkëkohore, vetëm brenda 100 viteve kanë përjetuar gati të gjitha format e sistemeve politike dhe kanë qenë të udhëhequr nga të gjitha format e llojet e lidërshipeve politike që njeh tipologjia e shkencave politike.

Politika shqiptare është fare pak e studiuar, fare pak është shkruar për të me një qasje shkencore politikologjike. Kryesisht është shkruar në aspektin historik apo flesh tipareve të politikës ditore. Mbetet një sfidë jo e vogël gjatë viteve të ardhshme edhe për shkencëtarët politikë që të fokusojnë hulumtimet e tyre rreth modeleve të qeverisjeve dhe formave të krijimit të politikave shqiptare, që të shtrijnë në një rrafsh empirik këto hulumtime dhe të dalin nga klishetë e zakonshme të përzgjedhjes së ombrellës së hulumtimeve tanimë të stëreksplatuara të integritimeve evropiane herë duke hulumtuar rastin e Shqipërisë, herë të Kosovës e herë të Maqedonisë e që tanimë kanë vërsuar komunitetin akademik. Kurse, në fakt një hapësirë e tërë oqeanike e mendimit politik shqiptar, e formave të organizimit politik, udhëheqjes, modeleve të qeverisjes, vlerave

(siç janë toleranca e rezistenca politike), të gjitha këto kanë mbetur akoma gati fare të paprekura nga hulumtimet shkencore. Kjo potencialisht do të ndihmonte kombin për identifikimin dhe planifikimin e procesit të politikës të shekullit të ri të politikës shqiptare.

Intensifikimi i hulumtimit shkencor politikologjik mbi procesin e politikës shqiptare do të ndihmonte për dimensionimin e vizioneve dhe elitave të reja shqiptare. Dhe nga kjo nuk duhet të kemi frikë. Nga ana tjetër, edhe ne si mësimdhënës është koha që të orientojmë studentët tanë drejt eksplorimit të atyre mijëra temave lidhur me politikën moderne shqiptare që presin për t'u trajtuar. Atëherë, mbase në mënyrë më të përhapur do ta kuptojmë me më pak konfuzion edhe ecurinë e politikës shqiptare dhe do të mund të kuptojmë shumë më qartë se si duhet të marrë frymë e të hapërojë ajo në të ardhmen. Atëherë do të bëjmë edhe përgatitjet që të fillojmë ta krijojmë terrenin edhe për lëndë mësimdhënie lidhur me mendimin politik shqiptar apo politikën shqiptare, ashtu siç kanë bërë universitetet dhe pedagogët e shumë demokracive të tjera.

4.1.4. Përmasat e kulturës politike;

Ndonëse fenomenet e përçarjeve politike, përdorimi i dhunës në proceset zgjedhore, votimi masiv në ditën e zgjedhjeve, korrupsioni në politikën ditore dhe udhëheqja autokratike e despotike nuk përkojnë me vlerat e politikës shqiptare e as të idealeve të rilindasve shqiptarë, megjithatë po ndodh që shpeshherë kohëve të fundit ato të rëndojnë procesin politik shqiptar dhe të krijojnë një fotografi të rrejshme për përmasat e kulturës politike shqiptare. Kurse në fakt ato janë vetëm se një flesh imazh tranzicioni i procesit politik shqiptar. Gjykuar në bazë të asaj që kultura politike konsiderohet të jetë aspekti që ndikohet më shumë nga përvojat e së kaluarës së një kombi mes aspekteve të sistemit politik bashkëkohor, këto fenomene negative e imazhe çasti të politikës shqiptare nuk janë pjesë e natyrshme e nuk janë as përmasë tipike e kulturës politike shqiptare, edhe

pse historikisht për shkak të amputimeve nga anash ka pasur dhe akoma ka tendenca të tilla. Prandaj ato nuk duhet lejuar që të zërë rrënjë dhe të shndërrohen në vlerë të procesit politik shqiptar.

Qëndrimi i shqiptarëve në politikë ndaj autoritetit si një nga përmasat e konceptit të politikës shqiptare në parim nga natyra është barazitar. Por, meqë jo të gjithë shqiptarët në faza të ndryshme kanë qenë dhe janë të barabartë në mundësitë e tyre për të marrë role politike dhe për të bërë gjykime politike, shpeshherë ndodh që të jenë të pranishme segmente të procesit politik, ku disa njerëz janë më të kualifikuar për të qeverisur se të tjerët, duke bërë kështu që detyra e të tjerëve të jetë bindja e verbër. Me këtë shpesh po shënohet paraqitja atipike e përmasës së qëndrimit autoritarist. Me një punë më intensive në vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin sa më të gjithanshëm politik, në shekullin e ri të politikës shqiptare mund të vijmë deri në arritjen e situatës ndoshta më dëshiruar të të ashtuquajturit qëndrim respektues. Kjo përmasë e kulturës politike të shqiptarëve në politikë ndaj autoritetit, e cila nënkupton që disa njerëz të jenë më të kualifikuar për të zënë role udhëheqëse, por këta njerëz kanë një detyrim për të qeverisur në interesin e përgjithshëm dhe duhet t'u kërkohet llogari për rezultatet e qeverisjes së tyre.

Kulturat politike janë dinamike, sepse ato janë të mbjella në mjedise të ndryshueshme historike, sociale, ekonomike, kulturore dhe politike që i gdhendin ato dhe që i ndryshojnë. Rrjedhimisht në rastin e shqiptarëve në dekadat e para të shekullit të ri të politikës shqiptare kur flasim për kulturën politike është i nevojshëm, para së gjithash, një konsensus mbi kulturën politike, që ajo të jetë e formuar në bazë të një marrëveshjeje të mbështetur në parimet demokratike, ekonominë e tregut, individualizmin, si dhe qeverinë që jep përgjegjësi. Çështje qendrore këtu duhet të jetë ndryshimi i qasjes së rolit të kulturës politike në transformimin e pushtetit në autoritet dhe në sfida të autoritetit.

4.1.5. Politikat inovative;

Këta që i shohim sot që kinse bëjnë ndonjë politikë apo përfaqësojnë shqiptarët gjithandej Ballkanit, këta nuk janë politika shqiptare. Nuk ka nevojë për zhgënjim apo frustrime nga këto imazhe çasti të transicionit të përfaqësimit të politikës shqiptare. Disa vërtet përfaqësojnë në bazë të meritave. Por akoma shumicën prej tyre (duke u buzëqeshur fati) i ka sjellë rastësia në përfaqësimin e politikës shqiptare. Prandaj edhe shumicën prej tyre i përcjell vetëm shterpësia e ofertave dhe i udhëheq botëkuptimi i despotizmit. Jo të gjithë janë eksponentët e politikës shqiptare, meqë shumë prej tyre janë të shkëputur nga bota e vlerave dhe e parimeve të politikës moderne shqiptare. Politika shqiptare janë studentët tanë, sepse ata po përgatiten për ta vazhduar pjesën tjetër të procesit politik në kuadër të shekullit të ri të politikës shqiptare që do të karakterizohet me politika të reja publike inovative. Pa harruar vlerat dhe parimet historike të politikës moderne shqiptare, politikat inovative të shekullit të ri të politikës shqiptare do të duhej të bazoheshin, para së gjithash, në një mënyrë të re të politikëbërjes, e cila është imediate. Në shekullin e ri të politikës shqiptare është më se i nevojshëm funksionimi i një procesi politik të plotë, pa ndërprerje që në vetvete do t'i inkorporonte të gjithë hapat që e përbëjnë tërësinë e një procesi demokratik politik: krijimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të shqiptarëve. Kështu shqiptarët do të jenë shumë më afër vendosjes së parimeve të funksionimit të politikave publike gati në çdo sferë e veprimtari. Ky parakusht do të mundësonte gjenerimin e politikave të reja inovative të shqiptarëve në shekullin XXI me asnjë qëllim ekspansionist, por, para së gjithash, për avancimin e mirëqenies sociale të shqiptarëve dhe një status të qëndrueshëm politik konform sfidave të reja të epokës së integritimeve. Për vendosjen e funksionimit të procedurave të tilla që do të karakterizonin një proces normal politik, natyrisht që nuk do të jetë lehtë dhe do të

haset potencialisht në rezistencë nga të gjithë ata që synojnë të mbajnë apo ushtrojnë monopolin dhe ekskluzivitetin kur është në pyetje performimi i politikave të shqiptarëve. Prandaj, që në dekadën e parë të shekullit të ri të politikës shqiptare do të duhet të punohet në vazhdimësi në ngritjen e aktivizimit dhe pjesëmarrjes politike, pavarësisht vështirësive dhe tendencës së kontrolluar të apatisë politike. Pjesëmarrja politike në vendet e zhvilluara dhe demokratike mundëson mjete nga të cilat qytetarët në një mënyrë apo tjetër kontrollojnë pushtetin, që është vendimtar në zgjedhje dhe që përcakton se kush do të udhëheqë. Rrjedhimisht që edhe në rastin e shqiptarëve fuqia e vetme e votës për të ndryshuar ata që udhëheqin bën një forcë për shumë modele të pjesëmarrjes dhe sërish çdo devijim nga votimi i lirë dhe demokratik bie ndesh jo vetëm se me parimet e politikave të reja publike shqiptare, por edhe me vetë vlerat nismëtare të kulturës politike shqiptare.

4.1.6. E ardhmja dhe modernizimi politik në vazhdimësi;

Politikat inovative publike të shekullit të ri shqiptar duhet të zhvillohen në frymën e modernizimit politik që paraqet një proces mjaft dinamik dhe kërkon akomodim në vazhdimësi ndaj trendeve bashkëkohore të praktikave demokratike perëndimore (si udhërrëfyes i përcaktimit strategjik të shqiptarëve). Karakteristikat përcaktuese të këtij modernizimi politik të shekullit të ri të politikës shqiptare përpos segmentit të pjesëmarrjes sa më masive të qytetarëve në krijimin dhe zbatimin e politikave do të duhet të përfshijnë edhe segmentin e racionalizimit të autoritetit (zëvendësimit të autoritetit politik tradicional), si dhe segmentin e dallimit të funksioneve të reja politike në ambientin global dhe zhvillimin e strukturave të profilizuara që i kryejnë këto funksione. Modernizimi politik i procesit të politikës shqiptare në shekullin e ri kërkon cikël pa ndërprerje të ndryshimeve për të arritur (dhe më vonë për të mbajtur në jetë) politikat

publike inovative. Ndryshimi politik është vetëm procesi i krijimit dhe i fortifikimit vital të sistemit politik nga një tip i ri cilësor. Procesi politik mund të ndryshojë në kahun e vet atëherë kur ndryshon sistemi politik duke fituar funksione dhe performanca të reja varësisht nga situatat konkrete shoqërore dhe ndërkombëtare. Gjatë ecurisë së mëtejshme të procesit të shekullit të ri të politikës shqiptare, ballafaqimi kryesor do të jetë ai i tejkalimit të sfidave nëpër të cilat kalojnë shumë sisteme demokratike të botës së civilizuar gjatë procesit të modernizimit politik e që varen nga çështje të lidhura me akomodimin ndërkombëtar, integrimin e brendshëm, pjesëmarrjen qytetare, shpërndarjen shoqërore, etj. Ndryshimet thelbësore të proceseve politike, sikurse ndryshimet e sistemeve politike nuk janë dhe nuk do të jenë edhe në të ardhmen gjithnjë vetëm si pasojë e revolucioneve të dhunshme. Në fakt, jo çdo përdorim i dhunës për të ndryshuar sistemin politik do të mund të konsiderohet revolucion. Po aq sa janë të rëndësishme ndryshimet e brendshme politike për t'u shqyrtuar, gjithashtu nuk duhet të anashkalohen ndikimet e shoqërive të jashtme që ndikojnë në politikën e brendshme. Për shembull, ndikimi i zhvillimeve në shtetet e tjera me rritjen e ndikimit të globalizimit dhe mundësive të komunikimit do të jetë në rritje në shekullin e ri të politikës shqiptare, sikurse edhe konceptet e reja të fuqisë së politikës dhe ndikimet e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare të shkaktuara nga koncepti i ri i cyber-politikës.

Në frymën e politikave të reja shqiptare duhet të kuptojmë, para së gjithash, se më nuk ka vend për fraza boshe e justifikime qesharake në vend të ideve e argumenteve politike. Frazat boshe nuk përkrijnë as me traditën e as me kulturën politike shqiptare. Shekulli i ri i politikës shqiptare herët a vonë do të shënojë një epokë të politikave inovative të procesit politik shqiptar që do të nënkuptojë epokën e veprave konform një kulture të lartë politike dhe epokën e projekteve konkrete. Dhe këtu nuk do të ketë më

vend për demagogji e kamuflazhe apo improvizime. Konkurrenca e vlerave edhe në procesin e politikave publike do të intensifikohet në shkallë të lartë, meqë shqiptarët po shkollohen e specializohen anekënd botës për profesione të ndryshme.

Në shekullin e ri të politikës, shqiptarët kudo që janë kanë një obligim kombëtar e qytetar - që të kuvendojnë dhe punojnë në vazhdimësi për ndërmarrjen e hapave të tillë që modernizimit të shoqërisë t'i përshtaten me një demokraci reale e funksionale; që të krijojnë dhe lënë të lira të zhvillohen politikat inovative të mbështetura vazhdimisht në ide të reja. Po fillon koha e fundit kur shqiptarët do të duhet të ulen që të krijojnë në vazhdimësi strategjitë për zhvillimin e kombit dhe shoqërisë bazuar në parimet dhe vlerat origjinale të procesit të politikës shqiptare dhe përshtatjes së akomodimit ndërkombëtar e rrugës së partneritetit strategjik. Është e vërtetë se ne kemi një folklor të begatshë, mirëpo nuk duhet të harrojmë se procesi politik modern i asnjë kombi demokratik, progresiv e paqësor nuk udhëhiqet nga parimet dhe frazat e folklorit në epokën e revolucionit teknologjik dhe të informacionit. Prandaj, në agun e shekullit të ri, le të fillojë procesi i modernizimit të politikave të shqiptarëve në frymën e politikave të reja inovative, si dhe duke i mbajtur gjithnjë gjallë dhe të reflektuara vlerat e tolerancës e gatishmërisë për partneritet nëpërmjet dimensionit universal e humanist të politikës shqiptare.

4.2. Klasa e re politike në Shqipëri

Demokracia shqiptare është në evolucion. Përsa i përket cilësisë ajo mendohet se është e brishtë. Ka një optimizëm nga të gjithë për konsolidimin e saj në të ardhmen. Demokracia nga vetë natyra e brendshme e saj është proces, dhe si e tillë ajo përmban si mundësinë e përsosjes, ecjes përpara, konsolidimit, ashtu dhe stanjacionit, krizës, deformimit, kthimit prapa. Në thelb, si çdo proces tjetër, edhe demokracia shoqërore ka

kontradiktat përkatëse, vështirësi e probleme të natyrës objektive, por dhe të asaj subjektive. Mendoj se është bërë e mprehtë nevoja e një studimi kompleks të këtij procesi, që të ndihmojë në dy drejtime: në sigurimin e cilësisë, të qëndrueshmërisë dhe konsolidimit të saj, ashtu edhe në kapërcimin sa më të shpejtë të dukurive negative që e shoqërojnë atë. Këto dukuri negative mund ta kenë burimin tek mënyra se si filloi procesi i instalimit të institucioneve demokratike në Shqipëri. Një vështrim i shpejtë të lë hapësirë të kuptosh se spontaniteti dhe karakteri “artizanal” kanë shoqëruar instalimin dhe evolucionin e demokracisë shqiptare në këto 20 e kusur vite. Kjo analizë është e nevojshme të bëhet duke u mbështetur në standarde shkencore, sepse dukuritë negative po e rrezikojnë seriozisht qëndrueshmërinë dhe të ardhmen e procesit demokratik në Shqipëri. Është fakt se këto dukuri negative kanë peshë të madhe dhe hapësirë të gjerë shtrirjeje që vërtet mund ta rrezikojnë të ardhmen e saj. Sa më tepër të lejohet apo të vonohet çlirimi prej këtyre “sëmundjeve” shoqëruese dhe njëkohësisht sa më shpejt të vihen në themel dhe në përmbajtje të demokracisë sonë, të procesit të saj, vlerat e vërteta, konceptet teorike dhe kultura demokratike, aq më shpejt mund të mënjanojnë dukuritë negative dhe demokracia të përparojë.

Klasa jonë e re shfaq sot në një masë të madhe, madje tronditëse, mangësi të mëdha në njohjen edhe të principeve bazë të përmbajtjes dhe të funksionimit të demokracisë e të shtetit ligjor. Ajo shfaq në qëndrimet dhe punën e saj një kulturë të cekët demokratike, ku mungojnë qëndrimet dhe zgjidhjet e sigurta, efektive, funksionale; kur në vizionin e tyre vihet re një amalgamë idesh dhe përvojash praktike që përziejnë ndjeshëm ide të kundërta, mospajtuese për shtetin dhe qeverisjen, që nga primitivet, mentalitetet bajraktariste, autoritariste, prepotente, kompromentuese e deri tek ato komuniste. Ndoshta mund ta teproj pak, por këto mentalitete e përvoja kanë një peshë e ndikim shumë të madh në

qëndrimet, mendimet dhe veprimet e klasës së re politike. Mund të justifikohet kjo mungesë e kulturës demokratike në fillim të procesit, por nuk mund të justifikohet fakti që në këto 20 vjet nuk është bërë asnjë përpjekje serioze apo e organizuar për të mbushur boshllëkun demokratik me kulturën dhe shkencën e demokracisë. Mirë bëjnë qeveritarët tanë që kërkojnë dhe vendosin të trajnojnë mësuesit, mjekët etj., që të rrisin cilësinë e punës, por asnjë masë nuk është menduar deri tani, për trajnimin apo kulturimin demokratik të klasës së re politike, aftësimin teorik demokratik të saj. Më parë duhet të kuptohet kjo nevojë e mprehtë, në mënyrë që të mundësohet dhe një zgjidhje efektive. Mendoj, se sa më parë të realizohet ndërgjegjësimi për këtë nevojë, aq më shpejt do të çlirohem nga dukuritë e mprehta negative dhe aq më shpejt do të bëhet kalimi i shumëpritur i demokracisë shqiptare, nga e brishtë në të konsoliduar e funksionale. Natyrisht, që kjo kërkon një konceptim të gjerë për kulturimin demokratik të njerëzve, sepse vërtet ka rëndësi instalimi i institucioneve demokratike dhe rregullimi ligjor i tyre, por demokracia funksionon kur edhe njerëzit i njohin ato si institucione demokratike dhe sillen ndaj tyre në mënyrë demokratike. Mendja e qeverisësve dhe të qeverisurve njëkohësisht ndriçohet nga dituria, ndërsa qytetërimi vjen nga të nxënit. Së dyti, ushtrimi i demokracisë e reagimi demokratik kërkon dituri, dije, nxënie. Kjo mundëson një vizion të plotë e të qëndrueshëm, që i hap rrugë zhvillimit të demokracisë dhe efektivitetit të qeverisjes dhe qeverisjes së mirë. Në këtë rrugë kryhet zgjimi demokratik dhe qytetërimi i shoqërisë sonë.

Demokracia është komunikim, bashkëpunim e dialog. Në këtë marrëdhënie rol të veçantë padyshim zë komunikimi politik. Por, politika në vendin tonë mendohet si “zanati” më i lehtë për t’u ushtruar. Madje ajo mendohet fusha më e sigurtë për pasurim të shpejtë e të paligjshëm. Mjafton të vish rastësisht dhe shpesh në mënyrë të pamerituar,

apo në mungesë të plotë të standardeve në një post politik apo të zësh një vend në parlament dhe të vetëshpallësh politikan. Ky tip politikani në Shqipëri haset rëndom dhe është më shumë respekt e nderim qytetar ndërmjet qeverisësve e të qeverisurve.

Përballja me realitetin shqiptar të lehtëson të kuptosh se sa vend ka pjesa negative në këtë raport. Deri sot, komunikimi politik në vendin tonë ka krijuar një situatë tronditëse që ka zbehur dallimin primar mes të vërtetës dhe të pavërtetës, ligjit dhe antiligjit, të moralshmes dhe të pamoralshmes. Është krijuar një përshtjellim e çoroditje e plotë e opinionit, saqë ka dobësuar ndjeshmërinë ndaj dukurive negative. Ky relativizëm ekstrem ndaj të vërtetës dhe hapësira e gjerë e shpifjeve dhe e të pavërtetave apo gjysmë të vërtetave i ka lodhur qytetarët e këtij vendi, i ka mpirë në veprimin e tyre, u ka vrarë shpresën për një të ardhme demokratike.

Shumë gjëra esenciale i mungojnë komunikimit politik në Shqipëri. Së pari kërkohet ndërgjegjësim për këtë situatë, studim shkencor i këtij realiteti dhe reagim serioz kompleks.

4.3. Politika dhe vlerat politike shqiptare në qasje me komunikimin politik

Gjatë shekullit të parë të krijimit të shtetit bashkëkohor shqiptar, politika shqiptare si brenda kufijve të Shqipërisë e sidomos jashtë saj nuk ka qenë ndaj ndryshimeve shoqërore, politike, sociale, kulturore dhe ekonomike që ka pësuar Gadishulli Ballkanik. Këto ndryshime, përpos që kanë reflektuar, po aq më tepër edhe kanë kushtëzuar zhvillimin dhe rrjedhën e përgjithshme të politikave shqiptare. Porse ato asnjëherë nuk kanë arritur që në tërësi të lëvizin parimet dhe vlerat universale dhe humane të politikës shqiptare nga koncepti i saj përmbajtësor edhe përkaj turbulencave fragmentare, apo dridhjeve të ndryshme të lidhura me periudha të politikave individuale të disa personaliteteve që nuk zënë vend në historinë apo axhendat shqiptare. Ruajtja dhe

përcjellja e këtyre vlerave brez pas brezi ka kërkuar një sakrificë të jashtëzakonshme gjatë këtyre njëqind viteve, siç e ka karakterizuar edhe Faik Konica: "Udha që shpie në nder, në liri e në shpëtim, nuk është e shtruar me lule, por me ferra; ai që arrin në kulm, arrin i grisur, i përgjakur, i djersitur e i lodhur" (Konica, 2007). Përderisa vlerat dhe parimet e politikës shqiptare e kanë burimin dhe ndikimin e tyre fillestar nga mendimi politik i Rilindjes Kombëtare (e cila pati përgjithësisht tipare demokratike e antifeudale, sepse ishte e destinuar kundër ideologjisë despotike e mesjetare të sundimtarëve) është e logjikshme që ideali demokratik të jetë i përhapur gjerësisht në mesin e vlerave dhe parimeve të manifestuara të politikës shqiptare. Nuk duhet harruar asnjëherë se vetë programi politik i Rilindjes, në esencë, burimin e vet filozofik e kishte në parimet demokratike të revolucioneve të Europës Perëndimore, me të cilat nuk mungonte edhe lidhshmëria e drejtpërdrejtë e disa prej mendimtarëve rilindas shqiptarë. Në mesin e tyre, një nga idetë qendrore ishte koncepti i lirisë. Kështu, nuk është e rastit që historikisht edhe në mesin e shqiptarëve, sikurse edhe disa kombeve europiane, vlerat dhe parimet dominuese politike sillen rreth konceptit të lirisë, qoftë pjesërisht për shkak të këtij ndikimi, qoftë për shkak të përputhjes së rrethanave të luftës së vazhdueshme për liri të shqiptarëve me rrethana të përafërta me revolucionet perëndimore për demokraci dhe liri. Porse ndryshe nga dinamika e përshpejtuar e kombeve perëndimore, shqiptarët nuk e patën mundësinë të vazhdojnë me ritmin e njëjtë në realizimin dhe përmbylljen e luftës për liri dhe demokraci edhe për një kohë të gjatë, duke mbetur mbrapa ritmit të nisur së bashku nga rilindasit shqiptarë me rilindasit dhe revolucionet europiane. Duke u gjendur në mjediset ballkanike të kundërtënive të theksuara historike; të goditur vazhdimisht nga padrejtësitë e bëra nga konferencat e ndryshme në favor të kombeve të tjera ballkanike dhe në dëme territoriale ndaj shqiptarëve; të lënë pas dore dhe jashtë

prioriteteve gjeostrategjike për një kohë të gjatë për shkak të perceptimit të përgjithshëm të Europës, duke i parë fatkeqësisht edhe shqiptarët si një pjesë e Ballkanit turbulent dhe jo ndryshe nga kombet e tjera ballkanike (edhe përkaj lidhshmërisë e kauzës së përbashkët për liri me shumë kombe të tjera europiane dhe shqiptarëve); të penguar e të lodhur vazhdimisht nga përçarjet ndërshqiptare; të goditur vazhdimisht nga okupimet e regjimet diktatoriale e autokratike, shqiptarët nuk arritën që të ndjekin një dinamikë të njëjtë të vlerës dhe parimit të lirisë sikurse shumë kombe të tjera europiane që kishin kaluar në një fazë më të avancuar në raport me konceptin e lirisë. Ndryshe nga kjo dinamikë, shqiptarët konceptin e lirisë vazhduan për një kohë të gjatë ta adresojnë jo të plotë në kuptim të lirisë nga të tjerët, duke e kthyer kështu në prioritet të preokupimit të tyre me çështjen e lirisë shoqërore, por u preokupuan me çështjen e lirisë shtetërore. Çështja e lirisë shtetërore, qoftë në dimensionin e përpjekjeve për çlirim, qoftë për barazi me kombet e tjera vazhdon për një kohë shumë më të gjatë të jetë pjesë shqetësimi dhe vlerë që orienton parimet e politikës shqiptare. Edhe në fillim të shekullit të dytë të politikës shqiptare, vlera e lirisë në mesin e një pjese të kombit është e thurur në synimin për çlirim, duke mos lejuar që në prioritet të jetë shndërrimi i saj në barazi shoqërore. Duke karakterizuar luftën shqiptare për liri në prag të mijëvjeçarit të tretë, Ismail Kadare konstaton se ndryshe nga disa kombe europiane që problemin me lirinë e kanë në kontekstin e lirisë shoqërore, si dhe lirisë për zgjerimin, pasurimin dhe përsosjen e saj, nga ana tjetër "populli shqiptar është i vetmi që ende...problemin e lirisë e kishte në trajtën e tij më tragjike. Ishte fjala për lirinë në kuptimin e mirëfilltë, parak të fjalës, në atë kuptim siç flitej në antikitet, në mesjetë, në kohërat më të zeza të masakrimit të popujve (Kadare, 2001: 18). Në këtë drejtim, nëse gjatë shekujve të kaluar të politikës shqiptare një nga preokupimet kryesore ishte çështja e arritjes së lirisë për shqiptarët çka i përcolli deri në

fund të shekullit, në shekullin e ri të politikës shqiptare duhet të shohim giërat përtej kësaj qasjeje të deritanishme: që të kuptojmë dhe praktikojmë idenë se liria është një mundësi, për të zhvilluar dhe ushtruar kapacitetet e njerëzve dhe, në mënyrë aktive, t'i angazhojë qytetarët në demokraci, që është edhe kusht edhe shprehje e një lirie të tillë. Kjo nuk do të thotë që koncepti e kauza e lirisë duhet të marginalizohen në procesin e politikës shqiptare në të ardhmen. Në të kundërt, kauza e lirisë mbetet të jetë vitale, por edhe brengosëse në shumë shoqëri ku jetojnë shqiptarët. Sami Frashëri shënon se si njëri prej kombeve më të vjetra të Europës, shqiptarët kanë të drejtë të jetojnë në liri dhe të zënë vendin që u takon midis popujve të qytetëruar të Evropës (Frashëri, 2009: 57). Edhe në fillim të shekullit të dytë të politikës shqiptare, liria mbetet të jetë gjithnjë në fokus si një vlerë e posaçme e procesit të politikës shqiptare. Liria po ashtu do të duhet të zhvillohet edhe si vlerë e kulturës politike shqiptare brenda për brenda vetë shqiptare, pra edhe në mjediset mes shqiptarëve, që të arrihet një demokraci sa më funksionale, respektivisht deri sa të arrihet në atë stadin e vizionit të projektuar të Faik Konicës për lirinë e shqiptarëve: "Liria është të mundet njeriu të besojë ç'i do zemra, të thotë ç'i do zemra, të shkruajë ç'i do zemra, të bëjë ç'i do zemra, veç jo ato që janë kundër lirisë së tjetrit njeri" (Konica, Albania 1897). Ismail Kadare do të shënonte se zgjedhja proevropiane që ka bërë populli shqiptar është zgjedhja e lirisë së tij në kushtet moderne. "Liria shqiptare nuk e ka emrin as Shqipëri e Madhe, as ekspansion shqiptar, siç mendojnë disa. Liria shqiptare është zhvillimi normal, natyral i popullit shqiptar në harmoni dhe Europës së bashkuar. Gjetja e rrugëve për ta lejuar këtë zhvillim, për fat të keq të ndërprerë, është në fakt edhe zgjidhja e problemit madhor të shqiptarëve në gadishull" (Konica, 2007; Kadare, 2001: 19-20). Mbase mes shumë parimeve dhe vlerave të procesit politik të shqiptarëve, koncepti i lirisë qoftë shtetërore, qoftë shoqërore, manifestuar nëpërmjet luftës së

vazhdueshme për çlirim dhe barazi, ka bërë që dy koncepte dhe pikënisje të identifikohen si më tipike për vlerat dhe kulturën e përgjithshme politike shqiptare gjatë këtij qindvjeçari: toleranca dhe rezistenca. Ato janë fanarët e vlerave, logjikës dhe filozofisë së veprimtarisë politike shqiptare. Në thelb, reflektimi i tolerancës është botëkuptimi shqiptar për shoqërinë dhe politikën. Toleranca shqiptare është një nga virtytet më të shenjta që ka mbajtur gjallë tërësinë e kombit edhe përkaj përçarjeve intensive politike dhe shumëllojshmërisë mjaft komplekse dhe unike konfesionale. Në rrethana të tilla, vlera e tolerancës shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm përgjatë procesit politik shqiptar, sidomos nëpërmjet dimensioneve të saj të njohjes së dallimeve dhe akomodimit të barabartë të shumëllojshmërive brenda kombëtare dhe në raport me kombet fqinje. Kjo qasje pastaj ka ndihmuar në lehtësimin e zgjidhjes së konflikteve me të tjerët, por edhe atyre brenda shqiptarëve, si dhe ka ndikuar në orientimin paqësor të shqiptarëve në tërësi. Objektivi i paqes dhe prirja për tolerancë asnjëherë nuk kanë qëndruar në ndonjë proporcion të zhdrejtë në vlerat e mirëfillta dhe origjinale të politikës shqiptare. Çdo praktikë tjetër mund të jetë vetëm e rastit apo si rezultat i ndonjë mveshjeje anësore. Modeli i tolerancës politike shqiptare për bazë e ka praktikën e komunikimit ndërkulturor të shqiptarëve me kombet e tjera, parimin e gatishmërisë për bashkëpunim dhe aleanca me vlerat demokratike, si dhe harmoninë e shkëlqyer tradicionale të tolerancës ndërfaqetare. Në fillim të shekullit, vlera e tolerancës shqiptare ka nevojë të manifestohet më shumë se kurdoherë brenda shoqërive ku jetojnë shqiptarët dhe jo vetëm në raport me kombet e tjera, pra, para së gjithash, në relacionet ndëreshqiptare, si në kuptim të modernizimit të përgjithshëm shoqëror shqiptar, po ashtu edhe në kuptim të veçantë të modernizimit politik shqiptar. Në këtë fazë të modernizimit politik, shqiptarët më shumë se kurdoherë në mjediset e veta dhe përgjatë procesit politik kanë nevojë që të promovojnë intensivisht

vlerën e tolerancës përballë synimeve kundërtëse të përçarjeve dhe zënkave të polarizuara politike. Ky shekull nuk do të duhej që të njohë tolerancën nën petkun e indiferencës e as relativizmit, por para së gjithash të njohë realitetin se njerëzit kanë mendime të ndryshme nga njëri-tjetri, ndryshe nga mendimet tona. Kjo, megjithatë, nuk do të nënkuptonte që toleranca mund të shkojë deri në pakufi. Shekulli i ri i politikës shqiptare duke ruajtur e promovuar fuqishëm vlerën e vet emblematike të tolerancës, ka nevojë që të vazhdojë në njohjen e dallimeve politike, kulturore e fetare dhe kultivimit të shumëllojshmërisë edhe më tepër në kontekste të ndikimeve globale me qëllim të ruajtjes dhe përforcimit të kompaktësisë së kombit. Para së gjithash, ka nevojë që përgjatë modernizimit të politikave publike e mjediseve shoqërore të avancojë shkallën e tolerimit të mendimeve të ndryshme. Shqiptarët i kanë rezistuar historikisht me sukses çdo njëmendësie e okupatori dhe, kjo prirje e parim i veprimtarisë politike, është e mbjellë në vetë përmasat e kulturës politike shqiptare, edhe kur flasim për idetë dhe idealet politike; edhe në dijen për politikën; edhe për traditat politike, normat dhe format; por edhe për anët emocionale të pozicioneve politike. Rilindja Kombëtare Shqiptare, e cila sot e kësaj dite qëndron fuqishëm në themelet e mendimit politik, veprimit dhe kulturës politike shqiptare, përpos që paraqiste një program politik, ajo në thelb ishte një lëvizje e gjerë rezistente me rrënië të thella historike të mjediseve shqiptare, që gjithnjë kanë frymuar në puls të kryengritjeve popullore përgjatë gjithë kohës së robërisë qoftë osmane e, më vonë, edhe të sundësve të tjerë të huaj. Gjatë këtyre lëvizjeve të rezistencës në mesin e shqiptarëve vlera e rezistencës ndaj njëmendësisë dhe sundimtarëve ishte instaluar në parimet dhe botëkuptimet e politikës shqiptare. Por, ajo njëkohësisht ka edhe një rol tejet të madh duke formuar ndjenjën e atdhedashurisë dhe, nëpërmjet këtyre vlerave rezistuese kishte ardhur deri te përforcimi i identitetit si dhe individualitetit unik të shqiptarëve

përballë okupatorëve dhe sundimtarëve (qoftë të brendshëm apo të huaj). Rezistenca e shqiptarëve edhe para shpalljes së pavarësisë, por edhe përgjatë tërë shekullit të parë të politikës shqiptare është zhvilluar edhe nëpërmjet kryengritjeve të rezistencës së armatosur, edhe nëpërmjet lëvizjeve ideore rezistente. Mbase, edhe vetë rilindasit e parë kishin pas vlerësuar që të dy këto forma si mjete të domosdoshme, për të siguruar të drejtat kombëtare dhe për çlirimin e vendit, logjikë e cila do të ndiqet vazhdimisht edhe nga qarqet e ardhshme të rezistencës në procesin politik shqiptar, por edhe do të diktohet nga koha dhe fati i njëjti e i nevojshëm për përdorimin e këtyre formave të rezistencës. Trashëgimia e parimit të rezistencës në politikën shqiptare e trasuar nga rilindasit shqiptarë asnjëherë nuk ishte thirrje për dhunë, por manifestim i rezistencës ndaj pushtuesit, rezistencë kjo me attribute të ruajtjes së tolerancës dhe thirrje për durim deri sa është e mundshme. Rezistenca shqiptare, qoftë në formë të lëvizjeve ideore, qoftë në formë të kryengritjeve të armatosura, asnjëherë nuk ishte e orientuar për dobësimin e ndonjë kombi apo copëzimin e ndonjë shteti, por ishte e orientuar në ruajtjen dhe përforcimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarët, për të vazhduar me shekuj të tërë në të ardhmen që të frymojnë me vetëdijen e përbashkët për përkatësinë në të njëjtën etni, në të njëjtin komb, komb i cili ka një prejardhje, gjuhë, zakone, formim shpirtëror, kulturë e histori të njëjtë dhe që dallon nga të tjerët (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002: 19).

Një nga mburrjet shekullore të politikave shqiptare është pozicionimi i mirëfilltë gjeostrategjik i shqiptarëve dhe orientimi i qëndrueshëm kah aleancat strategjike dhe miqësore kah Perëndimi. Nuk ka arsye që kjo çështje të ndryshojë as në të ardhmen, por përkundrazi sikurse çdo dekadë të shkuar edhe në dekadat e ardhshme të shekullit të ri shqiptar, gatishmëria për partneritet politik pritet që të shënojë rritje në vazhdimësi pa

luhatje dhe që kjo vlerë e orientimit politik të shqiptarëve të vazhdojë të jetë një nga përmasat kyç të kulturës politike shqiptare të shekullit të ri. Politikat inovative të së ardhmes pritet që të stimulojnë bashkëpunimin si ndërkombëtar, ashtu edhe brendakombëtar të politikave shqiptare me projekte konkrete e jo vetëm se me fjalë e formulime verbale e deklarative. Politikat e reja shqiptare nuk do të durojnë politikëbërjet në bazë të lokalizmave e krahinizmave - ato le t'i lëmë mbrapa sikurse edhe fenomenin e politikëbërjes dhe organizimit politik sipas parimeve të principatave - ato le t'i atribuohen epokës së lavdishme të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Kohërat kanë ndryshuar dhe mbase kjo duhet të reflektojë me realitetet e reja politike. Sepse duhet të kemi parasysh që institucionet që drejtojnë shqiptarët nëpër kohë janë ato që shpjegojnë format e drejtimeve të rezultateve politike e jo aq shumë ideologjitë apo historitë e asaj politike.

4.3.1. Vlerat e komunikimit politik shqiptar

Revolucionet e shekujve të 17-të dhe të 18-të e rihapën gradualisht rrugën drejt këtij modeli shoqëror, i humbur prej kohësh, pavarësisht se të shoqëruara me të gjitha ato zigzage që njeh historia. Modeli i shtetit të së drejtës kaloi nga librat dhe traktatet politike teorike, nga pamfletet, drejt lëvizjeve shoqërore dhe krijimit të institucioneve politike të bazuara në këto vlera. Liritë qytetare nënkuptuan edhe të drejtën për lirinë e shprehjes së besimeve dhe opinioneve fetare, kulturore dhe politike. Në këtë mënyrë u hap edhe rruga për atë hap e hop të madh në historinë politike pararendëse të vendeve që hynë në rrugën e demokratizimit dhe që e ndau shtetin nga feja. Parimisht, ligji, në radhë të parë, pastaj edhe simbolika institucionale, rregullat administrative, marrëdhëniet e varësisë dhe të hierarkive burokratike, ndërtimi i modelit të shtetit, të drejtat dhe liritë qytetare, tanimë nuk ishin më as nën kontrollin e fesë dhe të institucioneve fetare, por edhe as nuk gjenin legjitimitetin e tyre më në etikën fetare,

ose sikurse e quan Habermas në librin e tij Teoria e veprimit komunikativ, në etikën magjike, çka është edhe një koncept më i gjerë dhe më i shtrirë historikisht.

Lindja e rrymave politike laike dhe e mediave laike, në një farë mënyre laicizimi i shoqërisë, për të mos harruar thelbësisht krijimin e modeleve shtetërore laike, solli atë që një pjesë e konsiderueshme, ndoshta ajo mbizotëruese, e komunikimit politik të marrë një distancë relativisht të qëndrueshme dhe të dallueshme nga morali fetar. Gjithsesi, morali fetar, me shumë ndikime historike mbi moralin e familjes, atë të jetës së përditshme, quajtur shpesh si moral universal, e ka të vështirë të shërbejë si tërësi normash etike për komunikimin politik në kushtet e shoqërive të medias dhe komunikimit. Bota e përvijuar nga feja, e cila ka luajtur një rol pothuajse ekskluziv në edukimin moral të njeriut, është ajo e qiejve, kurse bota profane e Tokës kërkon përjasje specifike. Kur Jezusi nxori fjalët e tij duke thënë se jepini Zotit atë që i takon Zotit dhe Cezarit atë që i takon Cezarit, ai e rinjohu këtë ndarje midis botës së shpirtit dhe botës materiale, të ekonomisë dhe politikës. Ka një pamundësi pothuajse të pakalueshme për të bërë që në mënyrë mekanike të shkohet nga disa parime të përgjithshme etike drejt disa detyrimeve konkrete që rrjedhin forcërisht prej tyre. Morali i përgjithshëm magjik, në format e veta universale, shprehet ose në formën e detyrave bazike (“Ti nuk do të vrasësh më!”), ose në formën e frymëzimeve abstrakte (“Duaje si veten të afërmin tënd!”). Një nga autorët më të njohur të filozofisë të së drejtës, Lon F. Fuller në librin e tij *The Morality of Law* (1964) shkruan: “Moraliteti i frymëzimit shpjegohet në mënyrën më të plotë në filozofinë greke. Ai është mentaliteti i Jetës së Mirë, i së përkryerës, i realizimit të plotë të pushteteve njerëzore. Ndërsa moraliteti i frymëzimit nisët nga maja e realizimeve njerëzore, morali i detyrës nisët nga fundi. Ai mbështetet te rregullat bazë pa të cilat një shoqëri e rregullt nuk

mund të ekzistojë apo pa të cilat një shoqëri e orientuar drejt disa qëllimeve mund të dështojë. Ky është moraliteti i Testamentit të Vjetër dhe i Dhjetë Urdhëresave”.

Jozef Raz, studiues shumë i njohur i marrëdhënieve mes politikës dhe moralit e shpreh kështu këtë vështirësi: “Arsyet për të vepruar e transferojnë forcën e tyre te mjetet me anë të të cilave kryhet realizimi i tyre. Nëse unë kam një arsye për t’ju sjellë juve një gotë me ujë, atëherë kam arsye për të shkuar në kuzhinë për të marrë një gotë dhe për ta mbushur me ujë. Por, megjithëse kam detyrimin për të qenë në Londër në mesditë, këtej nuk del se jam i detyruar të marr trenin e orës dhjetë të paradites, ndonëse ai mund të më çojë në Londër në mesditë”. (Raz, 2010).

Fuller thotë se, bie fjala, të quash mbijetesën, pra ruajtjen e jetës së vetes, si vlerë parësore, duket si një normë morale e padyshimtë. Por, në librin e tij të sipërpërmendur, ai hedh dyshime edhe mbi këtë gjë. Të mbijetosh edhe atëherë kur jeta është bërë e padurueshme? Edhe në kushtet e një mjerimi të tejskajshëm? Edhe në kushtet kur revolta që mund të rrezikojë jetën, duket si e pashmangshme? A është pra ruajtja e jetës së vetes një vlerë morale e padiskutueshme dhe që mund të komunikohet në çdo rast dhe rrethanë si e tillë?, - pyet Fuller me autoritetin e tij. Përgjigjja që jep është shumë larg për t’u quajtur pa diskutim pohuese.

Aq më e vështirë bëhet për të gjykuar për etikën e përmbajtjes së komunikimit politik në kushtet e shoqërive me një diversitet kulturor, fetar, krahinor, etnik etj. të theksuar. E njëjta gjë ndodh në kushtet e shoqërive që kanë dalë nga një histori relativisht e gjatë ndarjesh civile. Sot në Shqipëri, sido që ta komunikosh politikisht shprehjen: “Dita e çlirimit është 28 nëntori”, ose shprehjen tjetër: “Dita e çlirimit është 29 nëntori!”, gjykohesh rëndë. Nga pikëpamja e qëllimeve, pra frymëzimeve, ajo mund të konsiderohet në të dyja rastet si etike, e virtytshme, sepse përkujton një ditë

historike për kombin. Por, gjithsesi, si “mjet”, mbetet e papranueshme nga këndvështrime konfliktuale historike, politike dhe etike. Mjafton të shohim mediat shqiptare të sotme për të konstatuar se ata që e quajnë 28 nëntorin si festë çlirimi nga pushtuesit nazistë anatemojnë nga kundërshtarët e tyre si bartës të devijancave morale, për të parë gjithashtu se si ata që si datë të tillë konsiderojnë 29 nëntorin, gjykohen rreptësisht në planin etik sikurse edhe në atë politik.

Një nga specialistët më të mirë të komunikimit politik, Jacques Ellul, shkruan në librin e tij *L’Illusion Politique*: “Ne e dimë mirë se programi i një partie politike nuk e lidh atë me asnjë detyrim. Mund të bëhen premtime, mund të jepet fjala për diçka, mund të nënshkruhen afishe sa të duash: nesër gjithçka harrohet, nesër vetëm disa njerëz me karakter të ashpër do të ishin aq të pakëndshëm sa t’i përmendnin këto formula. Në fakt, këtu nuk bëhet fjalë veçse për spërdredhje. Ndaj atyre që rrezikojnë ta qortojnë atë që ndodh, njihet përgjigja që u jepet, është e gjetur bukur. “Si? Po mendimin e harruat ju? Po lëvizjen? Ju e ndaloni dikë që të ndryshojë? Po koha? Si? Dëshironi të mbeten rob i atyre që keni thënë dje?”

4.3.2. Etika e brendshme dhe e jashtme

Mbi këtë bazë pikërisht janë përpunuar dy kategori thelbësore sikurse janë ato të “etikës së brendshme” dhe “etikës së jashtme”. Duket qysh në fillim se etika e brendshme është një koncept që pa i shkërmoqur parimet universale të etikës, synon që t’u gjejë atyre, zbatim konkret sipas fushave specifike të veprimtarisë njerëzore, ta zëmë, ndryshe në fushën e jurisprudencës, ndryshe në atë të politikës dhe ndryshe në atë të komunikimit. Etika kështu merr kuptim vetëm brenda kufijve të një fushe të veçantë praktikash institucionale apo të aktorëve veprues. Brenda kësaj logjike, etika e përgjithshme zëvendësohet në mënyrë funksionale me atë që shpesh quhet si

deontologji e fushës. Pa iu larguar kuptimit të etikës si reflektim mbi vlerat e mira njerëzore në dallim nga veset, që ndan të mirën nga e keqja në sjelljen dhe jetën e njeriut, nëpërmjet kodesh e normash, e gjitha kjo shihet në lidhje të ngushtë me specifikat e shprehjes së saj në fusha të veçanta.

Edhe kur Jozeph Raz kërkon të gjejë etikën e politikës, pra, në fakt, atë që përbën përmbajtjen e komunikimit politik, kur dëshiron të gjejë kriteret ndarëse dhe vlerësuese në planin etik për të dalluar një politikë të mirë nga një politikë e keqe, edhe ai ka gjetur zgjidhje jo të një etikë magjike universale apo popullore, të njëjtë për të gjitha llojet e veprimtarive njerëzore. Më shumë është prirë që zgjidhjen ta gjejë të një etikë e brendshme të politikës si veprimtari i lirë njerëzor për të administruar pushtetin dhe shtetin. Më shumë shkon përkrah zgjidhja që e zëvendëson konceptin e etikës universale me anë të një deontologjie të brendshme për politikën. Politika e vërtetë është një mekanizëm lirie, përndryshe nuk është më një politikë, por bëhet sundim autoritarist. Prandaj, thelbi i çdo politike, cilado qoftë ajo, duhet të respektojë vlerat e lirisë njerëzore. Për Raz: “Tre tipare të rëndësishme e karakterizojnë doktrinën e lirisë të bazuar te autonomia. Së pari, kryesorja, është mbështetja dhe mbrojtja e lirisë pozitive, e cila kuptohet si një aftësi për autonomi, çka qëndron në mundësinë për një radhë zgjidhjesh të përshtatshme dhe aftësish mendore të domosdoshme për një jetë autonome. Së dyti, shteti ka detyrimin jo vetëm ta shmangë mohimin e lirisë, por edhe ta mbështesë atë duke krijuar kushtet për autonomi. Së treti, nuk duhet të kërkojnë të realizohen qëllime nëpërmjet mjeteve të cilat godasin autonominë e qytetarëve me përjashtim të rasteve kur këto veprime janë të justifikuara nga nevoja për të mbrojtur dhe mbështetur autonominë e këtyre qytetarëve apo të të tjerëve”.

Mund të ndodhë që duke ruajtur një etikë debati dhe komunikimi publik, të kërkohej që të ndalohej ose lejohet aborti. Pra, këtu kalohet nga fusha e brendshme e komunikimit, në atë të moralit në fushën e shëndetit, familjes, respektimit të qenies njerëzore etj. Në këtë aspekt të jashtëm, komunikimi politik që së brendshmi konsiderohet si etik, pra si në përputhje me normat e fushës, së jashtmi, ai mund të konsiderohet i joetik ose i etik në vartësi të faktit nëse gjykohej nga një qëndrim i shoqatave fetare apo i atyre feministe.

4.4. Diskursi i politikanëve shqiptarë

Në opinionin e sotëm publik është krijuar një botëkuptim se shqiptarët nuk kanë pasur traditë të lirisë në politikë, respektivisht traditë të bazuar te një rend politik ku ka frymuar liria politike, ekonomike, kulturore e kështu me radhë. Ky argument ka shërbyer edhe si premisë për të ngritur argumente dhe konceptime të reja, madje edhe teori (siç është ajo e të “pafilozofuarës” e dr. Hysamedin Ferajt), të cilat aludojnë në ndryshime revolucionare në rregullimin e jetës politike dhe kulturore shqiptare.(Feraj, 2011).

Argumenti i mungesës synon që në pah të nxjerrë “faktin” e mungesës së traditës dhe kulturës së mendimit të lirisë në civilizimin shqiptar gjatë historisë së tij. Pra, ky argument dhe përkrahësit e tij aludojnë në faktin se shumica e zhvillimeve në traditën dhe kulturën shqiptare janë zmadhime të fakteve reale, duke e paketuar varfërinë dhe resurset e pakëta si traditë. Argumentet përforcohen duke theksuar se shqiptarët duke qenë popull i Kanunit dhe i një “tkurrjeje malore” kanë mbetur prapa zhvillimeve të caktuara dhe në fakt janë ngrysur në cektësinë e tyre kulturore. Eksperienca kulturore e tyre është e varfër, andaj duhet bërë çmos që ajo të rritet. Dhe zakonisht me “çmos” nënkuptohet një lloj revolucion.

Argumenti i repudiacionit është një argument i cili zakonisht artikullohet si mlllef i dalë nga dhimbja e kësaj mungese në fushën e mendimit dhe veprimit shqiptar. Këtu thuhet se shqiptarët janë popull i papërvojë në aferat politike. Gjithçka që ata kanë zhvilluar ka qenë e fragmentuar dhe individualiste. Në të njëjtën anë, po ashtu, theksohet se kjo është traditë që duhet mohuar ngase nuk ka pasur harmoni. Ky argument zhvillohet duke marrë shembuj sporadikë për të bërë vlerësime të përgjithshme mbi “kulturën” shqiptare. Argumentet e tilla nënkuptojnë se e vetmja udhë e zhvillimit shqiptar është modelimi dhe shartimi rrënjësor me ndonjë formë të shpejtë progresiviste. Sipas këtij argumenti, gjithçka që del nga kozmologjia tradicionale është e destinuar për dështim.

Argumenti i harmonisë ndërlidh argumentet e para, duke dashur ta projektojë të ardhmen si harmoni të re të ndërtuar si përgjigje ndaj mungesës dhe repudiacionit. Pra, pasi që paska mungesë dhe pasi që tradita shqiptare paska vetëm impulse të këqija, atëherë gjithçka duhet të fillojë nga e para. Argumenti kërkon që të revolucionarizohet shtegu i mendimit dhe veprimit për të krijuar një vetëdije të pastër dhe të pastruar, të bazuar në projeksionin harmonik-utopik, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë gjërat të nisin qysh i kërkon ajo utopi.

Këto tri argumente janë bërë premisa të mendimit të ri ideologjik në politikën shqiptare. Ky mendim ideologjik ofron zgjidhje gjithnjë duke kundërshtuar atë që është bërë paraprakisht, e cilësdo natyrë, frymë a udhë të ketë qenë ajo, si një legaci e regjimit të vjetër, si një “naivitet” politik i një populli “jofilozofik”, si një traditë e varfër e mendimit dhe veprimit politik apo si një politikë “ideologjike”.

Këto argumente janë të njohura për opinionin shqiptar si argumente të cilat përkojnë me argumentet bazike të ideologjisë marksiste. Marksistët kishin projektuar mungesën, kishin urryer traditën e bazuar në kulturë tradicionale dhe imagjinim të vazhdueshëm,

sado e vogël dhe nistore të ketë qenë ajo, dhe kishin projektuar një utopi harmonike të re. Natyrisht se marksizmi shfrytëzon shkencën, politikën, luftën dhe gjithë avenu-të e shtegut të mendimit e veprimit njerëzor për të farkuar “shkencën” e ligjeve të pandryshueshme të jetës egalitariane të bazuar në utopi. Kjo filozofi marksiste u provua edhe në historinë shqiptare për një gjysmë shekulli. Siç thotë Kenneth Minogue, ka qenë fati i shqiptarëve në kohët e fundit që jo vetëm të joshen nga besimet ideologjike, por (edhe më keq) të jetojnë nën sundim ideologjik. Ata nuk befasohen nga kontradikta themelore mes teorisë dhe praktikës sepse shtypjet kinse të zbuluara nga marksistët në shoqëritë e lira, nuk janë asgjë në krahasim me shtypjen e njerëzve nën një shtet ideologjik, siç ishte Shqipëria enveriste.

Por, pas sa vitesh nga rënia e komunizmit dhe pas luftës në Kosovë, shqiptarët ende po joshen nga besimet ideologjike dhe nga utopitë e sprovuara vetëm në fantazinë spekulative të ideologëve të rinj. Dhe një taktikë e zakonshme e ideologjisë së re majtiste-liberaliste është pikërisht kritika dhe kundërshtimi i komunizmit. Duke qenë se shqiptarët e kanë përjetuar atë ideologji, shpeshherë kundërshtimin e tillë ndaj komunizmit e shohin si frymë të re politike. Kështu, shpeshherë në emër të ndryshimit kultivohet edhe joshja e re.

Në shikim të parë argumenti për ndryshime transformative e bën këtë joshje të duket mjaft impesive. Sidoqoftë pyetja shtrohet se çfarë efektesh anësore vijnë me transformimet revolucionare? Legata e mendimit ideologjik na tregon se zakonisht ato janë premisa për transformim të tërë sistemit, përbashkësisht edhe të shoqërisë. Dhe në lexim të parë ky diskurs transformativ imponohet si fryt i mendimit politik. Sidoqoftë, ky është kryekëput një diskurs ideologjik. Natyrën dhe frymën e diskursit ideologjik dhe atij politik e ka shtjelluar thukët filozofi britanez Michael Oakeshott.

Oakeshott nis argumentin e tij me një shembull antik. Ai cek se si një ndër kuvendimet dhe propozimet më të spikatura politike njihet fjalimi i Perikliut (sipas Tuqididit), më 432 p.e.r, para Kuvendit të Athinës. Perikliu kishte dhënë arsyt e planifikimit të rezistencës athinase ndaj Spartës, duke e paraqitur propozimin e tij mbi situatën e krijuar politike. Në parim, propozimi i Perikliut paraqiste gjendjen e situatës, rekomandonte veprime gjithnjë duke dhënë konsekuencat e mundshme, krahasonte thukët propozimin me propozimet e tjera dhe jepte një vështrim holistik të gjendjes së përgjithshme. Ky fjalim merret shembull i kuvendimit politik dhe i propozimeve politike, të cilat kanë vendosur parimet themelore të politikës në demokracitë perëndimore. Pra, kjo është premisa e diskursit politik.

Sidoqoftë, ekziston një dallim i qartë mes propozimit politik dhe diskursit të tij , në një anë, dhe projektit ideologjik dhe diskursit të tij, në anën tjetër. I pari është propozim që bazohet mbi maksima dhe nis nga hetimet, supozimet, krahasimet dhe përgjithësimet kontekstuale që praktikisht përrethojnë propozimin politik. Pa mëdyshje se ky propozim i parashtrohet një prove reale: ftesës kuvendare për kuvendim të propozimeve në kontekst të argumenteve të bazuara në natyrën e gjërave, gjithnjë drejt përmirësimit. Ndërsa, i dyti bazohet mbi utopi imagjinare, mbi vërtetësinë e provuar vetëm në utopinë abstrakte, të sajuar nga propozimet të cilat nuk parashtrohen si propozime për t'u kuvenduar , por si propozime të ndërtuara mbi ide, të vërtetuara vetëm nga “vërtetësia” e “shkencës së ideve”, të sprovuara vetëm në shtegun utopik të ideologjisë, e të mbrojtura me kryeneqësinë e formësuar nga mendimi ideologjik. Pika fundore e argumentit të Oakeshott-it, në fakt, del te mendimi i tij mbi diskursin e projektit ideologjik të Karl Marx-it. Oakeshott e bën këtë duke argumentuar se projekti ideologjik i Karl Marx-it ishte i bazuar mbi diskursin demonstrativ të bazuar mbi “korrektësinë” e vërtetueshme të

propozimit të tij, i cili bazohet mbi hulumtimin e “ligjeve” që rregullojnë jetën dhe shoqërinë, gjegjësisht mbi “ndryshimet shoqërore”, duke mos lënë hapësirë për zgjedhje të propozimeve të bëra mbi baza të deliberimit politik të bazuar në propozime praktike.

Edhe në raste zbehjeje, demokracitë perëndimore gjithmonë kanë reflektuar në traditën e tyre të lirisë dhe kanë kthyer timon në drejtimet e mbara. Në rastin e Britanisë, kthimin më të fortë drejt lirisë pas Luftës së Dytë Botërore e kishte bërë Margaret Thatcher, e cila kishte përmirësuar petkun e mbyllur, të ftohtë, të ndrojtur dhe të vetëkënaqur të konservativizmit tradicional të viteve 70 drejt një hapjeje energjike, të sinqertë dhe të vendosur të politikës së frymës konservativiste. Ajo shuafti strategjitë socialiste që po gulfatnin ekonominë britaneze dhe u hapi udhë impulseve të reja kapitaliste për të rivitalizuar jetën në Britani. Duke u kthyer te parimet e lirisë, pronës, pavarësisë dhe zhvillimit, ajo rimëkëmbi traditën e politikës dhe demokracisë perëndimore. Kjo traditë ka inspiruar edhe shtete e kombe të mëdha si SHBA e Reganit, por edhe shtetet e vogla të dala nga ankthet e projekteve ideologjike marksiste si Estonia.

Karakteristikat e ligjërimit politik vazhdimisht formojnë kulturën politike të një populli – trajtat e ndërgjegjes politike, mënyrën se si elektorati e kupton politikën dhe qeverisjen, pritshmëritë e tij nga klasa politike, parashikimet e sjelljes dhe të strategjive politike, e të tjera. Opinionistë të ndryshëm publikë kanë denoncuar shpesh mbizotërimin, apo ndotjen gati, të ligjërimit politik në Shqipëri nga ligjërata spekulative, akuza deklarative për korrupsion, nga mosbesimi, zhvlerësimi, shpërfillja, personalizimi apo kapërcimi e sfidimi i institucioneve dhe Kushtetutës. Këto karakteristika të perceptuara të ligjërimit politik në Shqipëri janë denoncuar në mjaft raste si të papranueshme dhe si simptoma kronike të një papjekurie politike. Mirëpo pavarësisht intuitës së mprehtë, vëmendjes dhe kujtesës politike që shumë analistë sot në Shqipëri kanë dhe e ofrojnë për

publikun, fakti qëndron që asnjëherë nuk kemi patur të dhëna konkrete, të nxjerra nga ndonjë studim shkencor mbi ligjërimin politik në Shqipëri. Mungesa e sistematicitetit dhe e përdorimit të metodave hulumtuese shkencore është faktor i rëndësishëm në besueshmërinë e analizave, dhe ndoshta, për rrjedhojë, edhe në ndikimin e tyre (Adela Halo, 2013).

Një studim i kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) jep për herë të parë një pasqyrë të përafërt, por të bazuar në metoda shkencore të mënyrës sesi liderët kryesorë të politikës si dhe gazetatat me lexueshmërinë më të lartë në vend formulojnë diskursin e tyre në raport me disa çështje të rëndësishme për të cilat prej shumë kohësh zhvillohet në Shqipëri një debat i ashpër. Raporti analizon ligjërimin e dy figurave kryesore politike, liderit Sali Berisha (Partia Demokratike) dhe liderit Edi Rama (Partia Socialiste), si edhe të 5 nga gazetave kryesore (Panorama, Shekulli, Shqip, Mapo dhe Gazeta Shqiptare) në vend gjatë dy periudhave – 3 muaj përpara dhe 3 muaj pas zgjedhjeve të 2009-ës, dhe atyre të 2011-ës. Studimi është kryer nëpërmjet programeve kompjuterike bashkëkohore për analizën e përmbajtjes (KWIC dhe Yoshikoder 7.4) dhe një grupi pune prej 7 vetash që kombinon disa profile të rëndësishme për analizë të ligjërimin, si shkencat politike (Silvana Toska, Adela Halo, Sonila Danaj, Dorina Ndoj), gazetaria (Sokol Shameti), filozofia (Ani Rusi), dhe gjuhësia (Prof. Emil Lafe) (Adela Halo, 2013).

Synimi i grupit të punës ishte të analizonte: Si e përshkruajnë Sali Berisha dhe Edi Rama njëri-tjetrin dhe mbi çfarë bazash bëhen këto përshkrime (karakter personal, arritje, ideologji)? Sa përputhet ligjërimi i aktorëve në secilin krah politik me ideologjitë përkatëse politike (e majta dhe e djathta)? Si trajtohen gratë, feja dhe minoritetet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar? Si trajtohet integrimi në BE në

ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të përditshëm? Si trajtohen institucionet në ligjërimin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar? (Adela Halo, 2013)

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes se si e përshkruajnë liderët politikë njëri-tjetrin, studimi ka marrë në shqyrtim të gjitha deklaratat e tyre të dërguara nga zyrat përkatëse të shtypit gjatë periudhës së studiuar. Në bazë të fjalëve të gjetura në tekstet e fjalimeve u krijua një fjalor me tri kategori: Karakteri, Performanca dhe Përkatësia. Secila nga këto tri kategori përmban fjalë përshkruese, që dy liderët politikë përdorin për njëri-tjetrin dhe gjetja e parë ishte që ata nuk kanë përdorur as edhe një fjalë përshkruese pozitive për njëri-tjetrin gjatë periudhës së studiuar. Ligjërimi negativ i liderit të së majtës kundrejt kryeministrit aktual (njëkohësisht edhe lider i së djathtës) ka ardhur në rritje nga viti 2009 në vitin 2011; kritikën mbi performancën – mbi përmbushjen e funksioneve publike të tyre – përbëjnë vetëm rreth 50% të kritikave ndaj kundërshtarit, ndërsa pjesa tjetër janë kritika personale të karakterit, apo krahasime të përgjithshme me rezonanca negative; ligjërimi negativ ka ardhur në rritje në periudhën menjëherë para dhe pas zgjedhjeve (Adela Halo, 2013).

Për të analizuar përputhjen partiake me ideologjitë përkatëse (e djathta dhe e majta) në Shqipëri, pikënisja e studimit ishte një fjalor ekzistues i përdorur nga dy studiuesit Laver dhe Garry (2000), të cilët e ndërtojnë leksikun e djathtë dhe të majtë në kategori të tilla si: institucionet; ligji dhe rendi; mjedisi; çështjet social-ekonomike, dhe vlerat. Si konkluzion i studimit del se me përjashtim të çështjes së Mjedisit dhe disi asaj të institucioneve, ligjërimi i djathtë është më i pranishëm se ai i majtë. Kjo nuk çon automatikisht në përfundimin se një ligjërues apo dokument është i djathtë: mund të themi vetëm se ky dokument përmban një pjesë të madhe të leksikut të djathtë që mund të jetë për dy arsye të mundshme: ose ky dokument është vertet i djathtë, ose ky dokument

përmban kritika ndaj ligjërimit të djathtë. Sidoqoftë, ligjërimi i majtë është mjaft i pakët edhe në liderin e majtë edhe nëpër gazeta. Në rastin e Ramës, në bazë të numrit relativisht të vogël të ligjërimit të majtë në krahasim me atë të djathtë tregon një ligjërim që anon më tepër në kritika se sa në ofrimin e një alternative të majtë të matshme krahasimisht në ligjërim.

Studimi nxjerr përfundime të rëndësishme në lidhje me ligjërimin e aktorëve politikë mbi gratë, grupet fetare dhe minoritetet. Kësisoj, ligjërimi për dhunën ndaj grave ka ardhur në rritje dhe nuk ka ligjërim fyes ndaj minoriteteve etnike. Çështjet e grave përmenden më shpesh nga lideri i Partisë Socialiste, sidomos në lidhje me mbështetjen e përfaqësimit politik dhe të raportimit të dhunës ndaj grave. Ndërsa për fenë dhe minoritetet prononcohet më shpesh lideri i Partisë Demokratike. Por ndryshe nga figurat politike kryesore, pothuajse asnjë nga gazetatat nuk e diskuton temën e mbështetjes së përfaqësimit politik të grave me të njëjtën shpeshtësi sesa barazinë, (Adela Halo, 2013).

Për sa i përket ligjërimit mbi Bashkimin Europian dhe Evropën në përgjithësi, të dy figurat politike si dhe gazetatat e përditshme duket se e kanë prioritet kryesor. Por ndërsa ligjërimi për BE-në në terma të përgjithshëm është i lartë, ligjërimi për reforma të caktuara në qendër të integritetit është i ulët, me përjashtim reformës zgjedhore dhe asaj në drejtësi.

Studimi i OSFA² merr në analizë edhe ligjërimin mbi institucionet në vend. Çdo gazetë si edhe deklaratat e Ramës kanë ardhur duke theksuar kritikën mbi integritetin e institucioneve dhe sfidimin e kërcënimit ndaj tyre, ndërkohë që Berisha ka rritur vetëm ligjërimin mbi sfidimin dhe kërcënimin e institucioneve. Kjo është interesante pasi anë të kundërta në politikën në vend – Rama dhe Berisha – të dy ose i sfidojnë e kërcënojnë institucionet, ose i quajnë ato të sulmuara nga pala kundërshtare.

² Open Society Foundation for Albania

Përsa i përket nën-kategorive të ashtuquajtura “pozitive”, ku renditen fjalë që potencialisht shprehin vlerësim për institucionet, ky studim është më pak i sigurt, pasi fjalët brenda këtyre nënkategorive mund të jenë ose një shprehje dëshire për integritet dhe funksionim, ose kritikë ndaj mungesës së integritetit dhe jo-funksionimit, ose premtime. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se të paktën disa nga këto fjalë janë faktikisht kritika ndaj institucioneve, kjo e thellon akoma më tepër konkluzionin se në Shqipëri ligjërimi ndaj institucioneve është kryesisht, dhe në një pjesë dërmuese, negativ dhe sidomos për sa i përket integritetit të tyre (Adela Halo, 2013).

4.5. "Politika simbolike" shqiptare e liderit politik vendor

Në demokracitë e konkurrencës, qeverisja demokratike (...) kufizohet në aspektin kohor përmes zgjedhjeve të përsëritura në mënyrë periodike (Jens Tenscher, 1998). Meqenëse politika demokratike në fakt është e detyruar të argumentojë e të pranohet, politika, vendim-marrësit politikë dhe veprimi i tyre, në mënyrë permanente duhet të përliqjen para opinionit publik, ta informojnë atë mbi planet dhe vendimet politike dhe të tërheqin vëmendjen e tij. Në këtë proces, fushatat elektorale janë për aktorët politikë koha më e përshtatshme për kërkimin e "legjitimitit nëpërmjet komunikimit". Në këtë kontekst nuk duhet harruar se komunikimi politik duhet zhvilluar pandërprerë dhe përherë, jo vetëm për ngaqë edhe vetë veprimi politik është veprim komunikativ (Toska E. 2012).

Themelore për kuptimin e komunikimit politik është koncepti i Murray Edelmanit i “politikës simbolike”. Edelman flet për dyzimin e realitetit politik. Të gjitha veprimet dhe rezultatet politike, sipas tij, karakterizohen nga ndarja në një dimension instrumental ose vlerë nominale (efektet e vërteta të veprimeve politike) dhe në një dimension ekspresiv

ose vlerë simbolike dramaturgjike (paraqitja e veprimeve për opinionin publik). Edelman mendon se inskenimi sipas mendimit të aktorëve politikë i kushtëzuar nga rolet dhe i pavetëdijshëm i një bote joekzistuese për qytetarët me anë të simboleve politike si dhe ritualizimi i tyre i mistifikuar për masmediat dhe përmes masmediave, e mbulojnë gjithnjë e më tepër vlerën nominale të veprimeve politike (Tenscher J. 1998).

Duke u nisur nga kjo, edhe Ulrich Sarcineli bën dallimin mes dimensioneve të prodhimit (krijimit) dhe të paraqitjes (prezentimit) të politikës, mes vlerës politike nominale dhe simbolike. Politika materiale (prodhuese), sipas Sarcinelit, në kohën e mediave, sidomos në atë të televizionit, po e humb gjithnjë e më tepër karakterin e saj të vendosjes. »Medializimi« i politikës, d.m.th. shfaqja mediatike dhe sidomos prezantimi i përshtatshëm për televizionin dhe »paketimi« i politikës, po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për ruajtjen dhe simulimin e aftësisë drejtuese politike. Simbolet gjuhësore (fjalë si »Euro«, »Reformë taksash« etj.) dhe simbolet jo gjuhësore (himnet, flamujt, shtrëngimet e duarve gjatë vizitave zyrtare etj.) tërheqin vëmendjen. Përveç kësaj, ato reduktojnë edhe kompleksitetin e problemeve politike, prezantojnë një pikëpamje të caktuar dhe rrisin emocionet e publikut (Jens Tenscher, 1998).

Por simbolet politike nuk shërbejnë vetëm për prezantimin ose më mirë paraqitjen e realitetit politik. Në konkurrencën e partive dhe politikanëve për tërheqjen e vëmendjes së mediave, simbolet politike mund dhe instrumentalizohen edhe për paraqitjen e një realiteti joekzistues politik. Këtij përdorimi konkret të simboleve në procesin e ndërmjetësimit politik i përshtatet nocioni i »politikës simbolike«. Përdorimi jopreciz dhe shpesh përbuzës i këtij nocioni sqaron kritikën e përhapur mbi ndjeshmërinë e politikës ndaj simboleve. Por ajo harron se nuk mund të ketë një politikë »të pastër«, pra një realitet politik të »vlerës nominale«, pa dramaturgji dhe plotësim simbolik. Politika simbolike

është pjesë përbërëse e pashmangshme e realitetit politik që nga fillimi i veprimit politik. Ajo është forumi, në të cili vendim-marrësit politikë mund të prezantohen, të tregojnë kompetencat e tyre në zgjidhjen e problemeve dhe të përfaqësojnë orientimet, vlerat dhe normat politike. Por meqenëse për pjesën më të madhe të popullsisë, politika me kompleksitetin e saj nuk është drejtpërdrejtë e kapshme, prezantimi mediatik i politikës, kryesisht pa u vënë re nga opinioni, zhvillohet në formë ritualesh, stereotipesh, simbolesh dhe skemash mendimi në pikëpamje kryesisht të pranuar të »realitetit politik«: ndërsa inskenimi i politikës bëhet realitet politik për publikun, veprimi politik mbetet në terr »prapa skenës së mediave« (Jens Tenschler, 1998).

4.6. Partitë e majta dhe të djathta në Shqipëri

Në Shqipëri nuk ka pasur ndonjë traditë të hershme për pluralizëm politik dhe aq më pak, për parti të majta dhe të djathta. Partitë e para politike u krijuan pas Kongresit të Lushnjës, nga fundi i 1920, në kuadrin e zgjedhjeve të para parlamentare të prillit 1921.

Në tetor 1920 një grup deputetësh të drejtuar nga Fan Noli (ku fillimisht bënte pjesë edhe A. Zogu) shpallën programin e Partisë Popullore me reforma demokratike antifeydale, që mund të konsiderohen të majta. Kjo parti përfaqësonte opozitën në Parlament. Rreth një muaj më vonë, një grup deputetësh të tjerë, shpallën krijimin e Partisë Përparimtare të kryesuar nga Hoxhë Kadriu. Kjo parti përfaqësonte krahun konservator dhe mbështeste A. Zogun kur ky u bë kryeministër më 1923.

Por pluralizmi politik, edhe pse në formë fillestare, nuk vazhdoi gjatë. Me të ardhur në pushtet (1925) dhe deri sa u largua (1939), A. Zogu e ndaloi veprimtarinë e partive politike.

Në vitet 1940-1945, që përkon me periudhën e Luftës, u formuan PK (1941), Partia e Ballit Kombëtar (1942), Partia e Legalitetit (1943), përkatësisht parti të ekstremit të majtë dhe të djathtë.

Në vitet 1945–1990 Shqipëria ka qenë republikë, me sistem një partiak, i tipit komunist. Pluralizmi politik daton me ligjërimin e PD si parti e parë opozitare, më 12 dhjetor 1990. Zgjedhjet e para pluraliste parlamentare të 31 marsit 1991 shënuan krijimin e sistemit politik shumëpartiak, i konsoliduar në vijim me zgjedhjet e zhvilluara deri më 23 qershor 2013.

Në këto zgjedhje morën pjesë dy grupime kryesore: Koalicioni “Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integritet” (i djathtë) me 25 parti, i kryesuar nga PD, dhe Koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane” (i majtë) me 37 parti, i kryesuar nga PS.

Jashtë këtyre dy koalicioneve konkurruan katër parti të tjera: Aleanca Kuq e Zi, Fryma e Re Demokratike, Lidhja për Drejtësi e Progres dhe Partia Popullore Kristian Demokrate. Nga 66 parti që morën pjesë në zgjedhje, vetëm 7 arritën të fitojnë vende në Kuvend.

Koalicioni i majtë fitoi 84 deputetë, nga të cilat PS 66, LSI 16, PBDNJ 1 dhe PPKD

Koalicioni i djathtë fitoi 56 deputetë, nga të cilat PD 49, PDIU 4, PR 3.

4.7. Fjalori copëtues i së majtës

Përdorimi i gjuhës për zmadhimin ose zvogëlimin e efektit është një nga mjetet me të cilat operohet në politikë. Një ilustrim i kësaj është rasti i Barak Obamës i cili ishte i zi për të bardhët dhe jo aq sa duhet i zi për afrikano-amerikanët. Për t’u zhvendosur në Shqipëri, rruga Durrës-Prishtinë do t’i shëmbëllente rastit amerikan të ngjyrës së Obamës në atë se si ky segment komunikacioni fragmentarizohet. Kështu, tek ata që shohin tek vepra në fjalë rrugën që realisht e rrëzon murin shqiptar për t’u bërë një fill lidhës

mbarëkombëtar, pagëzohet Durrës-Prishtinë. Të tjerë fusin në punë emërtimin Durrës-Kukës duke shenjuar kështu një hapje të Veriut shqiptar, për kaq kohë të marginalizuar. Një palë e tretë, zgjedh emërtimin Rrëshen-Kalimash, duke e zvogëluar në maksimum impaktin kombëtar ose duke e kthyer, me dashje, në një me demek rrugë që, më shumë se e tillë, është një shteg dhish me anë të të cilit takohen, rrallë e përmallë, mirditorët, pukjanët e kuksianët. Perifrazimi 'Rrëshen-Kalimash' dhe perifrazimi që rrjedh prej tij janë shërbesa të politikës dhe medias së majtë. Në kronika lajmesh, shkrime gazetash, analiza, fjalime mitingjesh apo tribunë Kuvendi, gazetarët dhe politikanët e së majtës vazhdimisht i referohen Durrës-Kukës-Prishtinës si Rrëshen-Kalimashi. Ky copëtim i lejon publikut të gjerë përballjen me imazhin e largët, të ftohtë dhe verior që të përcjellin emrat Rrëshen dhe Kalimash. E kundërta, njëfarë ngrohtësie ku bashkohen qytetërimi dhe deti me të panjohurën dhe kombëtaren, do të shërbente binomi Durrës-Prishtinë. Por kjo nuk përdoret sa kohë rruga në fjalë është një vepër përfundimi i së cilës do t'i jepte pikë së djathtës në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Mass media e majtë, me cinizëm, e anashkalon motivin kombëtar të kësaj rruge, duke e veshur vetëm me varakun e lirë politik i cili në këtë rast ka ngjyrë gri.

Meqë e majta na e ka dhënë këtë lloj fjalori politik i cili rrugën kombëtare e bën shteg lokal dhish, por edhe rastin për paralelizma, po e provojmë. A ju kujtohet hekurudha Milot-Rrëshen-Klos? Ka qenë grahma e fundit e aksioneve vullnetare të Partisë së Punës dhe njëkohësisht një projekt i dështuar, skeleti i të cilit shpëlahet nga rrëketë që zbresin teposhtë nga Klosi në Rrëshen nëpër një hekurudhë, treni i së cilës nuk të çon kurrë nga Rrësheni në Klos. Rrësheni pra na shërben si simbol ku treni i së majtës nuk e futi kurrë brenda atdheut trupin e Veriut shqiptar. Ironikisht, e majta nuk pushon së përdoruri toponimin e mësipërm për simbolikë politike. Por, kësaj radhe, Rrësheni nuk është fundi,

por fillimi i rrugës. Nëpër kryqëzimet e këtyre arterieve ku lokalja takon kombëtaren, e djeshmja të sotmen, e majta të djathtë, Veriu Jugun, kalon edhe aksioni politik i dy krahëve. Kryeministri Berisha e ka pagëzuar turin e tij “Shqipëria po ndryshon”, ndërsa shefi i opozitës, Rama, “Dialog me Shqipërinë”. Afërmendsh, si Ndryshimi edhe Dialogu janë jo vetëm momente, por edhe simbole politike. Mendja nuk mund ta përjashtojë mundësinë që dialogu ndodh në të njëjtën kohë kur ndodh edhe ndryshimi. Sepse, ata nuk mund ta përjashtojnë njëri-tjetrin. Kështu, nëse hekurudha hipotetike Milot-Rrëshen-Klos përfaqëson dialogun kaheër të ndërprerë të së majtës me Shqipërinë e Epërme, rruga Durrës-Prishtinë simbolizon ndryshimin, i cili e tejkalon lokalen, duke përmirësuar arealin kombëtar. Gjuha, pra, ka dhe mund të shpikë mjete të mjaftueshme për të emërtuar vende, ngjarje apo dukuri. Rruga Durrës-Prishtinë është një vepër rëndësia e së cilës duhet ta tejkalojë dhunën copëtuese të fjalorit politik.

Një analizë e këtij procesi kërkon së pari një prerje tërthore dhe vëzhgim të hollësishëm të tipareve më të rëndësishme të tij. Artan Fuga i referohet medias si mjeti më i mirë i propagandës së partive politike për të komunikuar në atë që ai e quan politikë të elektoratit, pra lexuasit të gazetave duke i atribuar gazetave rolin e mbujtësve të votuesve të ardhshëm. Nisur nga hapat e parë të mbujtjes së procesit të komunikimit vlen të përmendet një prej tipareve të tij më të rëndësishme në fillim të viteve `90: lidhja mes ekzistencës së një organi të medias (në atë kohë bëhej fjalë vetëm për shtypin e shkruar) dhe mbijetesës së partive politike. Pra përcjellja e ideve politike tek elektorati bëhej vetëm dhe ekskluzivisht nëpërmjet organit të shtypit duke marrë parasysh edhe kushtet e mjerushme infrastrukturore të Shqipërisë së viteve `90. Në fakt sa më e thjeshtë dhe eksplicite të qe gjuha, aq më e përceptueshme dhe e kuptueshme bëhet ideja për qytetarin duke konsideruar këtu faktin që partitë e sapokrijuara kishin nevojë të

shtriheshin në hapësirë dhe të mbulonin edhe territorin më të thellë rural, një ambient potencial për t'u përkthyer në vota dhe elektorat në zgjedhjet politike (Irida Vorpsi, 2009).

Një tipar tjetër i rëndësishëm i procesit të komunikimit që sapo kishte filluar të bulëzonte edhe pse në formë shumë të thjeshtë dhe primitive ishte edhe shtrirja e përhapjes së mesazhit politik në kohë dhe hapësirë nëpërmjet gazetave më të rëndësishme në vend. Fuga e argumenton këtë tezë duke marrë për shembull zgjedhjet e para të lira të zhvilluara në Shqipëri në 31 mars 1991 dhe rezultatin që doli prej tyre. Sipas analizës së tij, komunistët fituan sepse ata kishin në dispozicion gjithë shtypin qendror plus edhe rreth 20 gazeta lokale të komiteteve të partisë në rrethe, situatë kjo që u përmbys në zgjedhjet e 22 marsit 1992. I atribuohet pikërisht shtimit të numrit të gazetave opozitare, shpërndarjes së tyre në të gjithë territorin e vendit dhe tkurrjes së fuqisë propaganduese të Partisë së Punës së shndërruar në Parti Socialiste përmbysja e rezultatit dhe fitorja plebishitare e forcave opozitare duke shënuar kështu qeverinë e parë jo komuniste që prej vitit 1944 në Shqipëri (Irida Vorpsi, 2009).

Vlen për t'u përmendur në këtë rast edhe shembulli i zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2005 kur shumica e opinionit publik përfshirë këtu edhe mendiat kryesore të shkruara dhe elektronike parashikonin një fitore të Partisë Demokratike prej 8 vitesh në opozite dhe fitore qe: konvergimi i opinionit mbizotërues në masmedia në këtë rast me atë të elektoratit për një ndryshim në qeverisje nuk mund të konsiderohet rastësi. Ndikimi është i ndërsjelltë: media ndikon politikën dhe ndikohet prej saj duke formësuar një proces komunikimi kompleks dhe shumëplanësh.

Gjuha natyrisht luan një rol të rëndësishëm në procesin e komunikimit, por jo vetëm në të. Ajo ka një peshë jo të vogël në formësimin e identitetit duke u identifikuar me një element thelbësor në bërjen dhe përfaqësimin e tij.

Gjuha mund të shihet edhe si një ndërmjetës, një mjet që politika përdor për të kontrolluar dhe influencuar elektoratin duke shfrytëzuar fuqinë që ajo ka mbi mendimin. Gjuha e politikës në fakt mbështetet në elementë të rëndësishëm që do të dalin në pah më poshtë duke i ilustruar me shembuj. Gjuha nuk është vetëm arti i të shprehurit, përkundrazi ajo mund të shprehi më shumë duke mos u prononcuar në mënyrë eksplicite, por duke nënkuptuar si në frazën e mëposhtme të artikuluar nga ish Presidenti i Republikës, Bamir Topi:

Sistemi i drejtësisë merret me konfliktet e çfarëdolloj natyre dhe këtu është e qartë që konfliktet eventuale të mundura të subjekteve politike në funksion të rezultatit të zgjedhjeve mund të angazhojnë në mënyrë të qartë edhe Kolegjin Zgjedhor, i cili është i mandatar dhe padyshim sot edhe një herë dëshiroj të shprehem në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pritshmërinë e lartë që ne kemi për këtë Kolegj: për të realizuar detyrën mjaft të rëndësishme, mjaft delikate, sepse sikurse dihet vota e sistemit të drejtësisë është pikërisht në ndërgjegjen e çdo gjyqtar. (Fjala e Presidentit Topi në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, <http://www.president.al/shqip/info.asp?id=5102>).

Në mënyrë implicite President i Republikës i jep zë shqetësimeve që kanë karakterizuar situatën post zgjedhore për një anësi të organeve kushtetuese siç është Kolegji Zgjedhor pa i përmendur ato në mënyrë eksplicite, por duke theksuar pritshmërinë e secilit prej nesh që ky organ të jetë në lartësinë e duhur duke iu kujtuar atyre dy elementët ndaj të cilëve janë të detyruar të binden: kushtetuta dhe ligji. Mes rrjeshtave lexoj se Presidenti shmang çdo lloj elementi tjetër të natyrës partiake apo personale në gjendje të ndikojë vendimet e këtij organi.

Një element tjetër që përdor gjuha në procesin e komunikimit është edhe persuazioni ose përdorimi i retorikës në funksion të argumentimit duke shfrytëzuar një sërë figurash letrare si metafora dhe eufemizmi, por jo vetëm. Elementët e sipërpërmendur mund të përforcohen nga përdorimi i dialektit, lëvizje taktike kjo që përdor politika për t'u shfaqur më pranë komunitetit duke shfrytëzuar ndikimin psikologjik tek audiencia.

“A jeni dakord ju që në krye të listës së LSI-së përfaqësimit në kuvendin e ri të Shqipërisë të jetë kampioni i Vllaznisë, kampioni i Shqipërisë, kampioni i qytetarisë dhe qytetarisë shkodrane Seit Fishta. Ka dhe shumë të tjerë por këto diskutojini dhe zgjidhni vetë. Unë jam i bindur se me këta dy Sokola të qytetarisë Shkodrane të traditave më të mira shkodrane, të faljeve më të mira shkodrane (Irida Vorpsi, 2000) (Fjala e Ilir Metës mbajtur në Shkodër 03.03.2009)”.

Jo më kot një nga pyetjet e përzgjedhura për t’u drejtuar të intervistuarve ka të bëjë pikërisht me përdorimin ose jo të dialektit gjatë procesit të komunikimit dhe analizimi i saj në kapitullin në vijim do të plotësojë kornizën e rolit të gjuhës në ndërtimin e procesit të komunikimit. Ajo çka bie në sy në analizën e gjuhës, një nga elementët me të cilën materializohet procesi i komunikimit në Shqipëri, është prania e dhunës verbale si element jetësor të klasës politike. Kjo dhunë nuk ka hiç respekt as për familjen tradicionalisht të konsideruar një vlerë shumë të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, të paprekshme gati gati tabu duke përfshirë në fyerje gjininë femërore me qëllimin diabolik për të prekur sedrën mashkullore dhe për të provokuar tek tjetri një reagim të shpërfyturuar. Një rast i tillë fatkeq është shënuar pikërisht në tempullin e demokracisë, në një seancë parlamentare duke dokumentuar një pikë kulminante të provokimit dhe denigrimit të kundërshtarit politik me çdo mënyrë. Përpos skuqjes dhe ndjenjës së turp-it që ngjall kjo video tek cdo njeri me një ndjenjë mesatare qytetarie, ajo tregon më së miri sesi tri përfaqësues të organeve kushtetuese Kryeministri, Kryetarja e Parlamentit dhe një deputet i grupit parlamentar socialist të Republikës së Shqipërisë shprehen me një gjuhë të padenjë duke qenë në detyrë. Skena bëri xhiron e menjëhershme në një shoqëri, e cila përdor edhe elementët më të shpejtë të komunikimit. Mund të përjetohet edhe pasi kanë kaluar vite sikur të ndodhte në kohë reale. Megjithatë nuk dua të ndalem në rolin e medias dhe mënyrën sesi ajo prodhon politikë në këtë rast, por në fuqinë demonizuese dhe stigmatizuese të gjuhës.

Impakti tek publiku që tronditës. U dëgjuan zëra që i dënuan, por fasha e

simpatizantëve të njërit apo tjetrit krah nuk u dyzua shumë, përkundrazi nuk vonoi të radhitej në krahun përkatës e të sulmonte kundërshtarin me të njëjtin mllef si provokator apo dashakeq.

Ky rast vërteton teorinë e Fugës që tërheq vëmendjen për një patologji nga e cila vuan edhe publiku shqiptar: mpirjen dhe anestezimin e tij duke u imunizuar në një ambient ku të gjithë flasin dhe asnjë nuk dëgjon. Në kuadrin e një ambienti kakofon, gati gati kalohet në desemantizim të fjalëve të përdorura. Gjuha në këtë rast luan këtë funksion mpirës në kuadrin e një kakofonie kolektive, në të cilën zor se mund të ketë vend për një ndjekje logjike të ngjarjeve dhe gjykim të paanshëm (Irida Vorpsi, 2009).

Pra duhet të jemi të kujdesshëm në përkufizimin e gjuhës si element bashkues që është thelbësor në ndërtimin e një komuniteti. Po aq i mprehtë është edhe roli i saj ndarës si në shembujt e përmendur më sipër që analizohen gjithmonë brenda kontekstit të përdorur (Irida Vorpsi, 2009).

4.8. Fjalori politik i fushatës

Atmosfera e ndezur elektorale duket se i ka përcaktuar tashmë prioritetet politike (lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet në qendër të vëmendjes), listat e rreshtuara të kandidatëve të partive dhe koalicioneve, llogaritjet matematikore, kryesisht bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare, si dhe dinamikat dhe ndryshimet që u vunë re në ato lokale, etj. Por pak rëndësi duket se po i kushtohet transmetimit të imazhit përmes retorikës.

Shpesh, nëpër fjalimet politike të radhës, mungojnë kryefjalë të tilla si: shpresë, ëndërr, vizion, mundësi, guxim, përpjekje, motiv, ideal, patriotizëm e me radhë.

Mungon jo vetëm artikulimi i shprehjeve që gjenerojnë optimizëm, pse jo dhe pasione elektorale, të cilat vetvetiu janë rreshkur disi me formulën e re elektorale, ku mungon impakti i kandidatit të drejtpërdrejtë, por edhe transmetimi i qartë jo vetëm i termave në mënyrë kohezive, por edhe i thelbit të asaj që transmetohet.

Objektivat, pak a shumë, dihen: shkurtimi i largësisë që na ndan nga anëtarësimi i plotë në BE, liberalizimi sa më i shpejtë i regjimit të vizave (në politikën e jashtme), apo luftimi i korrupsionit, krimit, papunësisë, rimëkëmbja e ekonomisë dhe bërja ballë e krizës, lufta ndaj varfërisë dhe pabarazive sociale (në planin e brendshëm).

Ajo që është më pak e transmetueshme është sesi do arrihen konkretisht këto objektiva, cilat masa dhe planveprimi konkret ekzistojnë për 100-ditëshin e parë të qeverisjes në rast fitoreje, cilat janë prioritetet kryesore, dytësore dhe kështu me radhë, në mënyrë që të kalohet gradualisht nga populizmi tipik elektoral, që ka qenë fenomen tipik shoqëruar i fushatave në këto dy dekada, drejt një çmitizimi të përfaqësimit politik dhe sjelljes së tij më afër shtresave që identifikohen me iks apo ypsilon politikë.

Një gjë tjetër që lë për të dëshiruar është që, vërtet pozicionimet majtas, djathtas, në aspektin ideologjik, prej kohësh duket se kanë dalë nga moda e artikulimit publik, por, gjithsesi, përfaqësimi politik i orientuar drejt platformave të caktuara politike që adresojnë problematika të caktuara dhe prioritete bazë, nuk është aspak klishe, madje është kusht i domosdoshëm për orientimin e qytetarëve, fermerëve, intelektualëve, tregtarëve, grave, të rinjve apo çdolloj identiteti kolektiv që pranohet nga anëtarët e grupit të caktuar për t'i bërë më të ndërgjegjshëm dhe më llogarikërkues në një situatë paszgjedhore.

Pra, mos të abuzohet si deri tani, ku mazhoranca e djathtë në pushtet shton taksat , rrit presionin fiskal apo vendos paga reference, të cilat si në literaturë, si në praktikat ndërkombëtare, qartazi manifestojnë politika të majta.

Apo qeverisja socialiste e viteve 1997-2005, e cila sipas mendimit të shumë studiuesve, kishte qartazi një orientim në thelb të djathtë dhe që në inicimin dhe implementimin e shumë politikave ndiqte një qasje shumë më liberale ndaj tregut se qeverisja aktuale (përfashtuar këtu taksën e sheshtë).

Të bërit e më pak premtimeve, por më të realizueshme në terren, artikulimi i objektivave të qarta, radhitja e prioriteteve dhe një gjuhë më pak e teknokratizuar dhe më afër kuptueshmërisë së shtresave të gjera shoqërore që, për një arsye apo tjetër janë lënë jashtë përfaqësimit politik (p. sh.).

Sonila Danaj përmendte gratë rurale në një shkrim të para disa ditësh, në një të përditshme), janë hapat e parë drejt kuptueshmërisë së ndërsjellë dhe rritjes së kulturës dhe informimit publik.

E shoqëruar me anët pozitive që sjell kodi i ri elektoral dhe që janë kryesisht zbutja e klimës së ndezur parazgjedhore nëpërmjet formulës proporcionale dhe rritja e përfaqësimit të grave, patjetër do jepnin një rezultat të përgjithshëm pozitiv, nga i cili nuk do kishte të humbës, veç fitues.

Qershia mbi tortë do ishte sikur të dëgjonim edhe fjalë dhe togfjalësha që transmetonin optimizëm, dëshirë të vërtetë për ndryshim dhe kapërcim të tranzicionit të pafund që na ka lënë në bisht të Europës deri tani, që të zgjonin shpresën apo pikërisht atë guxim për të shpresuar, që ishte dhe kryefjala e Presidentit aktual amerikan, që është marrë gjerësisht si model nga klasa aktuale politike shqiptare.

E pra, siç u vu re në Amerikë dhe më vonë në fushata paralele në Europë dhe më tej, impakti i fjalorit të zgjedhur, retorika elektorale, vizioni dhe artikulimi personal, nuk janë thjesht kozmetikë, por garantojnë si suksesin individual, ashtu edhe zgjojnë ëndrra dhe transmetojnë mesazhe, dy gjëra aq të nevojshme për demokracinë ende të papjekur shqiptare.

4.9. Sharja në politikë

Tashmë edhe ne shqiptarët u mësua me sharjet në politikë. I dëgjojmë shpesh kundërshtarët të shahen në parlament, në televizion, në shtyp, në tubime. Hapësira politike shndërrohet shpesh në mejhane të vjetra ku fluturojnë gjithëfarë sharjesh, që ndonjëherë duket sikur kanë dalë nga muret e nevojtove publike, ku lihen ndyrësira verbale çfarëdo. Para se të kuptojmë se ç'janë sharjet në politikë, duhet të pranojmë se nuk janë veçori e shqiptarëve. Në të gjitha vendet, ku më shumë e ku më pak, janë të pranishme sharjet, si në rrugë ashtu edhe në politikë, gjithnjë duke respektuar parametrat kulturorë, meqë jo të gjithë popujt shajnë njëloj. Megjithatë, vihet re se në Shqipëri sharjet janë strukturuar tashmë në ligjërimin publik, në mos nga ana formale, të paktën nga pikëpamja e regjistrimit të komunikimit. Me fjalë të tjera, sharja në skenën publike shqiptare është pjesë përbërëse e “komunikimit politik”.

Në të vërtetë sharja është infarkti i komunikimit, sepse momenti që ndodh përkon me dëmtimin e rëndë të shkëmbimit të informacioneve, ose të dialogut politik. Sharja i jep fund ecurisë normale të komunikimit, me rrezikun e moskthimit mbrapa, përderisa shpeshherë sharja shikohet si fjala e fundit, ose gjithsesi si ajo mënyrë komunikimi që lë shenja të pashlyeshme.

Sharja shënon edhe bllokimin e mendimit. Sikurse në trafikun e rënduar aksidenti i rëndë nuk e lejon më qarkullimin, ashtu edhe procesin e dialogut sharja e mbyll procesin e mendimit. Në fakt, në komunizmin e përditshëm as atij që shan, as atij që shahet, nuk i kërkohet ndonjë mendim i veçantë. Përkundrazi, dinamika e sharjes e përjashton arsyen, si rrjedhim e shmang mendimin i cili, le ta kujtojmë, është thelbi i politikës.

E megjithatë, e tregojnë edhe shembujt e shumtë në politikën shqiptare, ekziston rreziku që sharjet të konsiderohen si mënyrë normale komunikimi, ndërkohë që kemi të bëjmë me surrogato të tij, e në disa raste me ato forma të jetës që vazhdojnë për inerci edhe pas vdekjes. Rreziku qëndron pikërisht në ndjesinë se po bëhet politikë, se dialogu vijon, ndërkohë që sharjet nuk kanë të bëjnë asfare me përplasjet ideore në politikë.

Që sharjet në politikë përkojnë me pezullimin e kësaj të fundit e tregon qartë edhe forma skenike ku merr jetë komunikimi mes palëve në lojë. Pavarësisht se publiku ka ndjesinë se po bëhet politikë, sharjet e përjashtojnë krejtësisht atë nga pjesëmarrja, që siç dihet ndodh edhe gjatë shfaqjeve teatrale, ku spektatorët marrin pjesë emotivisht në atë çka ndodh në skenë. Mirëpo sharjet, duke e rënduar deri në skaj fjalën me konotacione negative, e sterilizojnë dialogun, duke e lënë jashtë publikun, i cili ka iluzionin fillestar se po përfshihet në zgjedhjet e vendit, porse në të vërtetë është thjesht spektator i një komunikimi të dështuar. Deri në një farë mase ‘communis opinio’ e toleron sharjen, sepse e konsideron atë pjesë të pasionit politik, ku fjalët i shpëtojnë ndonjëherë doganës verbale të trurit. Mirëpo kufiri midis sharjes si përjashtim dhe sharjes si modus komunikimi është shumë i lehtë për t’u kapërcyer, madje pa e ndjerë fare. Problemi është se edhe ne shqiptarët jemi mësuar gradualisht me sharjet, sikurse ndodh me dozat e helmit ose të drogës; në fillim të bën përshtypje edhe një fjalë e pamenduar mirë, pastaj shkopi i kërcimit së larti të akrobacive verbale ngrihet më tej, deri sa kalohet pa e kuptuar mirë në

caqe të papranueshme, me sharje të rënda edhe për garipat vetë. Trupi shoqëror mësohet ngadalë me përshkallëzime të tilla, derisa të verifikohet kolapsi komunikativ, çka do të thotë fundi i politikës, që nuk njoftohet për fat të keq me tinguj trombësh, por vihet re në realitetin e vendit.

Në qoftë se parlamenti është sheshi, rrugica, oda e djeshme, atëherë është vendi i ligjëritimit, ku ushtrohet fjala, diskutimi, e ndonjëherë polemika, por pa arritur kurrë në konflikte verbale siç është sharja, e cila me konvencion nuk e ka vendin aty, sepse nuk është funksionale ndaj dialogut. Në kuptimin figurativ, sikurse lihen jashtë armët para se të hyhet në kuvend, ashtu duhen lënë jashtë edhe armët verbale vdekjeprurëse, si sharjet, që e vrasin fjalën nuk e vitalizojnë atë.

Sipas filozofit Roberto Esposito, sharja mund të ketë efekte politike, siç mund të jetë për shembull devijimi i vëmendjes së publikut në diçka tjetër; megjithatë, nuk i përket gjuhës së politikës, sepse është “shka dhe efekt i shpolitizimit, në kuptimin që e shpie praktikën politike në një fazë belbëzuese, në mos drejt afazisë”. Këtu, ne shqiptarët, si qytetarë duhet ta pyesim gjithnjë veten kur niveli i sharjeve i kalon nivelet fiziologjike, për të kuptuar nëse kanë funksionin e shashkave, pra zhvendosjen e vëmendjes diku tjetër. Përshtypja është se kjo manovër bëhet shpesh në politikën shqiptare, qoftë edhe për të maskuar mosekzistencën e politikës me P të madhe.

Nuk ka dyshim se komunikimi politik, që ka nevojë për “pullë e kuqe” kur i jepet publikut, ka lidhje me edukimin e qytetarëve. Nuk mund të pretendohet që sharjet të mos kenë efekt mbi publikun dhe që brezat e vjetër e të rinj të mos ndikohen nga sharjet në parlament ose në arenën politike. Politika është produkt i kulturës së një vendi, por njëkohësisht edhe aktor i saj, në kuptimin që merr pjesë në formimin e kulturës politike. Nuk ka dyshim gjithashtu se sharjet shkojnë e ndërveprojnë me procese relativisht të reja

në kulturën moderne, siç është spektakolarizimi i politikës, mediatizimi, liderizmi, e kështu me radhë. Politika e mediatizuar, ose e personalizuar, që ndiqet obsesivisht nga telekamerat, krijojnë kushte ideale për forma të skajshme të shprehjes, siç janë sharjet, të cilat në analizë të fundit na japin shansin të reflektojmë për shoqërinë dhe politikën e sotme (Jens Tenscher, 1998).

Në fjalimet zotit Berisha në parlament vihet re sulmi me tone të ashpra ndaj liderit të partisë socialiste, zotit Rama. Sulm ky që nuk lidhet me funksiononin apo statusin e tij politik, por me individin, personin i tij dhe rrethin i tij familjar. Një diskurs ky formalisht jokorrekt, por dhe nga ana semantike bosh. Të shohësh zotin Berisha teksa luan një shfaqje të shëmtuar është si të pësosh një inkuizicion viziv dhe auditiv (Arbër Shtëmbari, 2009). Shikojmë se si tensioni personal i liderit përçohet dhe rrezikon të shndërrohet në tensionin e shoqërisë. Transmetimi nga mediat i këtij diskursi pa artikuluar një analizë të thellë mbi të, do të thotë jo vetëm ta mbartësh, por edhe të mbarsesh me të, pra të bëhesh palë e dhunës verbale, do të thotë të nxitësh jo debatin, por pasimin e dhunës tek interlokutori tjetër dhe, ç'është më e keqja, duke ia përplasur spektatorit në formë abstrakte, thjesht imazh dhe tingull, e dhunon në hapësirën e tij personale. Këto lloj diskursesh të dhunshme nuk sjellin asgjë të mirë, përveçse ushqejnë frakturën sociale. Është e vërtetë që mes shkëmbimeve gjuhësore krijohen raporte force simbolike midis palëve, gjë pozitive kjo, por ajo që pritet nga këto përplasje politike është çlirimi i vlerave dhe jo i antivlerave. Mungesa e një kulture komunikimi, nuk po dëmton cilësinë e jetës, por po dëmton gjallërinë e saj, burimin energjetik të saj, vetë shqiptarët. Nga ana tjetër, vëmë re që po po shpronësohet nga aktiviteti i të menduarit, forma më elementare e të arsyetuarit, dyshimi! Dyshimi është forcë, ose kusht që hap perspektiva drejt njohjes së të vërtetës. Fakulteti i të menduarit është cenuar rëndë (Arbër Shtëmbari, 2009).

Diskursi i Liderit universalizohet automatikisht sapo ai del në tregun simbolik të gjuhës së përdorur. Fjala nuk është vetëm lëvizje fizike e frymës, që krijon tingull. Fjala është kuptim. Por ky kuptim i korrespondon një klase të caktuar në konfigurimin e klasave sociale. Fjalët të kombinuara zbulojnë një mendësi, një stil jetese dhe mbi të gjitha, shije. Ç’duhet të kuptojë një shqiptar kur zoti Berisha objektivon gabimisht identitetin e të qenit shqiptar me rolin e të qenit “Burrë”. Sipas Berishës të jesh shqiptar, duhet të jesh Burrë! Ç’ndjen një grua shqiptare teksa dëgjon këto artikulime? Ç’kuptim do të kishte sikur për shembull një zonje të hijshme si zonja Topalli t’i kërkoje të tregohej “Burrë”?! Po formohet një komunitet gjuhësor i strukturuar mbi banalitetin që prodhon Dominimi i Njëshit e, që të integroresh në këtë komunitet, duhet të riprodhosh të njëjtën gjuhë totalitare, pra të duhet të strukturohesh sipas normës së vendosur. Pra, ajo që pritet është që në ditët që vijojnë, në fjalimet e bashkëpunëtorëve të Berishës të hasim në po të njëjtën gjuhë që ka përdorur dhe lideri i tyre.

KAPITULLI V

LIDERI POLITIK, DY RASTE STUDIMI

5.1. Retorika e vjetër në gjuhën e re

Ajo që vëren më së shumti në retorikën e përditshme është mosndryshimi i saj edhe pse brezat ndryshojnë. Tendenca për të ruajtur të njëjtën strukturë të ndërtimit të fjalive, të përçudnimit të tjetrit, të linçimit me apo pa argumente tregojnë një farsoj edhe mos pjekjen e shoqërisë sonë. Politika është mediumi përmes së cilës njerëzit kanë mundësinë të shprehin mendimet dhe opinionet e tyre mbi çështje që prekin shoqërinë tonë. Këtu tek ne politika ka një konotacion tjetër, madje unë do propozoja që edhe në fjalor të bëhej një shtesë ku të shtohej që “është mjeti përmes së cilit ti pasurohesh apo mbron pasurinë tënde pa qenë nevoja të bësh politikë”. Perceptimet e filozofëve dhe shkencëtarëve të politikës nuk janë shumë të rëndësishme për politikanët tonë që duket se kanë mbetur në gjuhën e drunjtë, kështu që pak herë kemi parë edhe gjeste të vërteta të politikanëve madje për të qenë të sinqertë as që i kemi parë këto gjeste e nëse kemi parë ndonjë grimcë të vockël jemi lumturuar aq shumë sa që e kemi hiperbolizuar gjestin. Fjala vjen, kështu bëmë para shumë vitesh për një takim kokë më kokë mes Nanos dhe Berishës duke e quajtur historik edhe pse ishim po ne që qarkullonim barsoletat se të dy këta ulen e pijnë për qejf e bëjnë teatër. Po aq larg është parlamenti nga koncepti klasik i parlamentit, si një vend ku oratoria dhe argumenti zënë vend dhe jo linçimet, dosjet familjare (kujdes jo dosjet e komunizmit) dhe anatemitet kanë vendin kryesor. Mund të ketë qenë dhe vendi i përleshjeve ose fjala vjen vendi i kërcënimeve por shumë pak herë kemi dëgjuar një retorikë të hajrit në atë që presupozohet të jetë hambari i njerëzve më të ditur dhe më të mirë të këtij vendi. Mirëpo, nëse në vitet e hershme ishte e kuptueshme kjo gjuhë urrejtjeje

(sikur të qe për çështje ideologjike, antikomunistët godisnin komunistët e djeshëm), e mbushur jo vetëm me dhunë verbale por edhe me dhunë fizike sot e kësaj dite kur dhe brezat kanë ndryshuar, gjuha e gangsterit në parlament mbetet e njëjtë. Të shikosh komisionet parlamentare arrin të kuptosh që ka aq pak ekspertë të një fushe dhe shumë gangsterë të cilët kanë ardhur aty si kaubojsa për të ruajtur nderin e liderit. Liderët e rinj por edhe prurjet e reja janë gjithnjë e më të lidhur me mitet dhe paradigmat e liderit të shkuar. Ramistët mund të thonë që kjo nuk është e vërtetë për Ramën i cili e bëri hasha të parin e tij, dakord por varet se cili është i pari për Ramën, Nano apo Meta? Ndërkohë që reflektojmë mbi përgjigjen e kësaj pyetjeje nuk mund të rrimë pa vëzhguar dhe shënuar se ish-organizatorët e shoqërisë civile (e jo vetëm) janë imituesit par excellence të gjuhës, gjesteve dhe madje qëndrimit të liderit. Imitimi i retorikës deri në pikën e imitimit të gjestikulacionit është një farë lloj idhujtarie dhe nënshtrimi që nuk vjen nga respekti por nga depersonalizimi i individit karshi njëshit. Ajo që e ndryshon retorikën e socialistëve, në krahasim me atë të demokratëve, është se ato e mbulojnë retorikën sulmuese me forma fjalie, paragrafesh të stiluara duke u përpjekur të shuajnë akuzat dhe sulmet vulgare gjithashtu duke u përpjekur të minimizojnë daljet në skenë edhe të ushtarëve të vijës së parë. Ana tjetër e skenës tonë politike, pra opozita, duket se nuk ka ndryshuar aspak. Ajo vazhdon të jetë një imitim i retorikës së vjetër, gjithnjë e më shumë degraduese, bajate, e lodhshme. Askush në atë parti nuk duket se ka ndërmend të ndryshojë, as edhe të bëjë një ndryshim vizual pra të sjellë një ngjyrë pak më të çelur se sa bluja e fortë. Asgjë! Retorika mbetet po e njëjta, madje tani tenton të krijojë një gjuhë të fortë për të krijuar një autoritet të ri në popull. Endet përmes retorikës në një situatë që nuk kuptohet, hera herës thotë që zgjedhjet i humbëm për fajin tonë dhe herë të tjera niset në sulmin se votat tona u blenë nga kundërshtarët. Një retorikë sulmuese nga kjo opozitë

që më shumë të bën të qeshësh se sa të trembesh, jo pak herë edhe mazhoranca për të shmangur diskutimet me peshë dhe me rëndësi “thërret” në interpelancë Berishën duke i dhënë mundësinë që të shpalosë talentin e tij në retorikë. Pikërisht një nga arsyet se përse kjo parti u mund kaq thellë ishte dhe retorika agresive, boshe, hera herës jashtë realitetit që fillonte nga mitingjet e shpeshta deri tek aulat parlamentare. Por edhe pse Berisha u largua nga drejtimi i partisë retorika e vjetër jo pak herë është ridëgjuar këto muaj nga ana e kryetarit të ri por edhe është mbështetur fuqimisht nga opinionistë që vazhdojnë të kritikojnë në të njëjtën gjuhë vetëm se me muzikalitet të ndryshëm. Kështu shihet një ndryshim fare i vogël, për të mos thënë i pallogaritshëm nga ana e partisë opozitare, për veshin e qytetarit i cili jo më pak se sa 8 muaj më parë i bëri të ditur që besimi i tij për këtë qeveri ka përfunduar. Arsyet e mbetjes në vendnumëro e retorikës nga ana e politikanëve tonë lidhet si me mjedisin socio-kulturor që këto persona janë rritur dhe krijuar ashtu edhe në psikologjinë nënshtruese që shihet partia. Së pari mjedisi socio-kulturor ka krijuar adhurimin nda njëshit, i ka dhënë jetë frymës dhe kulturës të mos kritikës jo vetëm kur forca politike është e fituar por edhe kur ajo del e humbur nga një betejë politike. Së dyti, jo pak herë qasja ndaj një problemi nga ana e retorikës së partive politike është e ngurtë dhe vetëm e njëanshme. Thënë më shkoqur, politikanët kanë tendencë të njohin vetëm një të vërtetë atë të klanit të tyre (në mund të flasim kështu), për to të vërtetat e tjera janë larg realitetit dhe nuk përmbushin fare kushtet e vërtetësisë madje akoma më keq nuk ekzistojnë. Ky lloj perceptimi e kthen gjuhën e folur nga ana e tyre gjithnjë e më të drunjtë, askush nuk hap rrugë, askush nuk pranon kritikën e tjetrit dhe në fund kemi një kakofoni e cila jo pak herë degjeneron në sherr banal. Këto dy sëmundje nuk i shohim të shëruara nga shumica dërrmuese e politikanëve të rinj të cilët ose

vazhdojnë në heshtje diskursin politik të liderëve që i kanë rritur me duart e tyre, ose nga ana tjetër mundohen të bëjnë një ndryshim që është thjesht në formë dhe jo në përmbajtje.

Kjo mungesë e ndryshimit në retorikë, kjo mungesë e ndryshimit në politikë dhe pengu që i mban lidhur me të shkuarën e vonë apo atë të hershme ka krijuar një klimë mosbesimi së pari tek shteti dhe fuqia e tij së dyti tek alternativa opozitare që sapo bie nga pushteti kërkon revolta për të ri hipur në të. Ka krijuar mungesën e mendimit të lirë, mendimit kritik dhe nënshtrimit total ndaj miteve, historive që dëgjojmë nga lideri pa mundur të analizojmë e më pas të pranojmë apo refuzojmë atë. Mungesa e një retorike të re apo qoftë edhe përpjekjes për një retorikë të re edhe nga brezi i ri në politikën tonë të krijon një situatë trishtimi për të ardhmen. Një situatë që kupton se nuk ka më të rinj në këtë politikë, por ka vetëm njerëz që lindin para dhe ato që lindin pas.

5.2. Cilësitë personale të liderit

Është e zakonshme tashmë, që “tifozeria politike” të ketë si objekt të saj in jo partitë politike, por liderët e tyre. Madje dhe lufta politike duket se po reduktohet vetëm në “luftë” mes lidereve. Kjo tendencë duket se po shoqëron gjithë botën demokratike në kohët e sotme. Duke ndjekur nga jashtë këtë tendencë nuk mund të mos vesh re se cilësitë personale të liderit marrin një rëndësi të konsiderueshme. Në këtë kuptim lideri është sa personal aq edhe jo i tillë. Çdo të thotë kjo? (Zamira Çavo, 2009)

Çdo lider, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, si i tillë, shfaq domosdoshmërisht tiparet e veta personale. Ai ka mënyrën e vet të punës, të komunikimit, të vizionit për botën. Dhe kur bëhet fjalë për liderin politik, atëherë këto tipare vijnë e bëhen edhe më të rëndësishme, pasi kanë të bëjnë me stilin e punës së liderit, i cili kur është në pushtet, formaton aktivitetin e “skuadrës së tij” pra të qeverisë, drejt modelit të tij.

Dhe po në këtë mënyrë, është e kuptueshme sa sa ndikohet më tej, shoqëria në një ripordhim të këtij modeli.

Në se do t'i bënim një studim jo të thelluar në shoqërinë shqiptare në vitet e tranzicionit, vihet re dukshëm se si ka ndikuar në formatimin e shoqërisë lideri me tiparet e tij personale. Qënia e z. Alia në krye të vendit, në momentet e para të demokracisë, mënyra e tij tolerante dhe e prirur drejt intelektualizmit, që do të thotë e pavendosmërisë për të marrë vendime të menjëhershme, krijuan dhe atë format të tolerancës dhe demokracisë. Një ndër arsytet pse kalimi nga një sistem totalitar drejt atij demokratik, u krye në një mënyrë që tashme jemi mesuar ta quajmë paqësore, ka të bëjë dhe me tiparet e liderit të kohës. Por, po këto tipare bënë që, z. Alia të mos mund të merrte vendime të rëndësishme në momente decisive, prandaj dhe pushteti kaloi shpejt në duart e opozitës së kohës, opozitë që drejtohej rastësisht nga z. Berisha. Cilësitë personale të z. Berisha formatuan më tej shoqërinë e viteve 90. Mënyra e tij e komunikimit me njerëzit, dëshira e tij për të komunikuar me turma për të treguar shpirtin e tij karizmatik, treguan njëkohësisht dy nga tiparet e tij personale, mbivlerësimi i dukjes dhe shpirti kontradiktor. Pra nga njëra anë shfaqet dëshira e tij për të mbivlerësuar dukjen dhe për ta paraqitur atë sa më të pëlqeshme. Dhe nga ana tjetër, fryma e tij kontradiktore, mostoleruese. Për z. Berisha rëndësi ka të fitohet një imazh, i cili të garantojë rolin e liderit. Është ky një ndër faktorët që e paraqesin Berishën punëtor sepse rri në zyrë 24 orë. Por puntimi drejt dukjes, drejt imazhit rrezikon të sjellë një formatim demagogjik të shoqërisë, të mbështetur në falsitet, gënjeshtëri dhe mashtrim. Shoqëria e kësaj periudhe në fund të fundit u ngrit mbi iluzionin, iluzionin për fjalën e lirë, iluzionin për demokracinë. Kjo shoqëri u ngrit mbi mashtrimin, mashtrimin me cekun e bardhë, mashtrimin me liritë politike e deri

tek mashtrimi me piramidat. Nga ana tjetër, karakteri kontradiktor dhe mungesa e tolerancës, të shprehura në “luftën ndaj komunizmit” krijuan dhe një agresivitet social. Shoqëria e kësaj periudhe nuk mund të mos shfaqte edhe ajo tipare te dhunës, të mungesës së tolerancës. A mund të quhet modeli Berisha model i punës? Mendoj se po t’a karakterizojmë kështu do të thotë të mos kemi njohur z. Berisha si individ. Mjafton të ndjekësh me vëmendje një intervistë të tij për të kuptuar se për z. Berisha, rëndësi ka çfarë do ai, çfarë pëlqen ai, çfarë përfytyron ai. Të tjerat nuk ekzistojnë. Modeli i tij i ngjan asaj zonjës së shtëpisë, e cila nuk pastron kurrë shtëpinë e saj dhe kur i vijnë miqtë, rregullon vetëm mesin e dhomës duke i fshehur plehrat pas kolltuqeve të shtrenjtë. Prandaj ky model nuk mund të siguronte zhvillimin real të vendit (Zamira Çavo, 2009).

Cilësitë personale të z. Nano si, toleranca, shpirti i tij bohem dhe njëkohësisht natyra e tij intelektuale, që shfaq pavendosmëri në raste deçizive, formatuan një shoqëri ku toleranca shkoi deri në papërgjegjshmëri, dhe shpërdorimet e imazhit publik dhe fondeve publike shkuan deri në kulmitet. Nëse do të vazhdonim me analizën e liderve të tjerë do të vinim re sigurisht se si kanë ndikuar cilësitë e tyre personale në formatimin e modeleve qeverisëse. I kërkoj ndjesë lexuesit që nuk po zgjatem me modelet e “reja “ qeverisëse, por jam e bindur se secili prej tyre do të arrijë ta bëjë vetë një analizë të tillë (Zamira Çavo, 2009). Të pranosh rolin e cilësive personale të liderit nuk do të thotë t’a personalizosh gjithçka me të. Nuk do të thotë as që lideri të shndërrohet në një despot a monark. Lideri shfaq potencialin e tij si lider kur vepron me skudra, kur krijon lidershipe, kur reflekton aktivitet pozitiv. Që këtë mund të themi se një kryeministër, një president a dikush tjetër që konsiderohet lider politik, mund të quhet i tillë sa kohë ushtron institucionalisht detyrën, por në thelbin

e vet, ai shndërrohet në lider nëse ka ditur të punojë si i tillë (Çavo, 2009). Nuk mund të mos vihet re personalizmi i sotëm i luftës politike e cila deri diku justifikohet pikërisht me cilësitë personale të liderave. Sot “tifozeria” berishiste e ka orientuar sulmin e vet kundër z. Rama, personalisht. Kjo është deri diku e justifikueshme me aq sa thamë më sipër. Por z. Rama dhe nëse nuk fiton zgjedhjet, sërish mbetet “në këmbë” si lider politik aktiv. Ndërkohë që tifozeria shpenzon kohë të çmuar vetëm duke u marrë më të. Pyetja që ngrihet vetiu është: Po partia Socialiste a është objekt i këtyre sulmeve dhe tifozerive? Nëse përgjigja do të ishte “pak a shumë”, atëherë do të arrinim në një konkluzion tjetër: roli i liderit në Shqipëri është personalizuar deri në kufirin ekstrem të tij dhe kjo është mjaft serioze për fatin e demokracisë. Dhe nëse nuk është kështu, atëherë sulmet kundër z. Rama janë sulme kundër partisë socialiste. As më pak e as më shumë. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për tifozerinë e kuqe e cila ka si objekt sulmi z. Berisha, duke arritur deri aty sa të pretendojë se mjafton të largohet ai, pa le ta ketë pushtetin e djathta. Ky refleksion sipërfaqësor më shtyn të besoj se modelet personale duhen parë me shumë kujdes dhe sidomos nga opinionistët, të cilët kanë një rol të madh në ngritjen e liderit politik. Ata duhet të kenë në konsideratë të dyja anët e medaljes, por mbi të gjitha limitet e koncepteve (Zamira Çavo, 2009).

5.3. Liderët shqiptarë dhe tendenca e tyre për të centralizuar pushtetin

Po a është deri diku kjo e domosdoshme ende në kushtet e tranzicionit, mungesës së traditës demokratike, një tendence të shqiptarëve për anarki, vetgjyqësi, mosnjohje autoriteti shtetëror a bravura personale? A do të mund të mbijetonte Berisha dhe cilido tjetër në vend të tij, në këta 27 vjet, po të ishte ndryshe? Vështirë. Po një lider tjetër, jo

Berisha, a do të mishëronte po këto tipare nëse do të donte të mbijetonte, të ishte jetë gjatë?

Rama është shembulli më tipik i mbijetesës së këtij modeli. Madje Rama nga ana e vet mbetet më shumë i frikshëm për pasuesit e afërt, dominant, central dhe i largët (distant për militantët, duke e dëshiruar edhe vetë këtë dhe duke e amplifikuar edhe me prezencën e tij fizike).

Në rastin e tij karizma eliminohet pothuaj krejt përderisa edhe për të hyrë tek ai, njerëzit më të afërt presin me frikë tek pragu dhe pyesin si e ka humorin sot. Në të gjitha aspektet, pjesa më e madhe e drejtuesve tanë partiakë e shtetërorë, mbeten në personalitetin e tyre, një përzierje e tipareve të liderit në demokraci, tipare të imponuar këto edhe nga sistemi i ri në formim demokratik, përzier me elemente reminishentë të personalitetit të lidereve të kaluarës totalitare, përsëri për aq sa ua lejon koha e sistemi i ri formal demokratik.

Në mes shqiptarëve vazhdojnë të diskutohen liderët e së kaluarës Ahmet Zogu dhe Enver Hoxha por meqë shqiptarët e kanë më të freskët komunizmin e diskutojnë edhe Titon sepse rreth 3 milionë shqiptarë kanë jetuar në ish- Jugosllavi. Kjo është plotësisht e kuptueshme sepse këto figura janë të studiuar edhe nga historianë të huaj por ajo çfarë është e rëndësishme si duket pak vlerësohet? - Shkollimi i tyre. Si duket tanimë është e qartë se fjalori bosh politik në demokraci nuk pinë ujë. Shtrohet pyetja si arritën këta liderë të sundojnë vendet e tyre kur nuk qenë edhe aq të shkolluar. Ne në jetën e përditshme dëgjojmë nga çdo njeri apo prind i cili kujdeset për shkollimin e fëmijës së vet atëherë shtrohet pyetja si mund të votohet një lider jo mjaft i shkolluar. Ahmet Zogu ka qenë me shkollë të mesme turke, Enver Hoxha me shkollë të mesme dhe dështon tërësisht në studime, Titoja nuk ka arritur që të kryejë edhe dy vjet gjimnaz, pra që të tre

me arsimim jo të mjaftueshëm, unë mendoj se pikërisht këtu qëndron problemi sepse një popull i ngritur nuk voton një lider analfabet. Këtë gjë perëndimorët nuk e bëjnë, ata votojnë liderë të aftë dhe prandaj kanë arritur më shumë sukses, liderë në radhë të parë të aftë në punën që bëjnë dhe siç dihet ata i kushtojnë rëndësi të madhe debatit televiziv, ku vlerësojnë përgjigjet dhe qëndrimet e tyre për çështjet që atyre u interesojnë. Siç dihet në komunizëm nuk ka debat, por ka vetëm fjalime pompoze të përgatitura që më parë dhe siç u dëshmuua ndër vite "fjalime për këndellje të masave" dhe për t'i mbajtur me shpresa. Realiteti ishte dhe është dicka tjetër. Prandaj, mendoj se shqiptarët duhet të votojnë ashtu siç votojnë perëndimorët, për ata liderë të cilëve u përputhen fjalët me veprat dhe jo për ata të cilët mendojnë se mund të vijnë apo ta mbajnë pushtetin vetëm me fjalime të zjarra. Sa vlejnë fjalimet e tilla nëse nuk ka vepra. Pra perëndimorëve u përputhen fjalët me veprat ndoshta jo 100% por atje llogaritë bëhen ndryshe, sepse nuk mund t'a marrësh votën me mashtrime. Kur njerezit e interesuar të votojnë për ata liderë të cilët janë të shkolluar dhe të cilët dinë të vlerësojnë se çfarë mund të bëjnë dhe çfarë jo dhe atë që e thonë dhe e bëjnë, mund të arrihet sukses, përndryshe retorika politike do të vazhdojë pa sjellë asgjë të re.

Karakteristikat e ligjërimit politik vazhdimisht formojnë kulturën politike të një populli – trajtat e ndërgjegjes politike, mënyrën se si elektorati e kupton politikën dhe qeverisjen, pritshmëritë e tij nga klasa politike, parashikimet e sjelljes dhe të strategjive politike, e të tjera. Opinionistë të ndryshëm publikë kanë denoncuar shpesh mbizotërimin, apo ndotjen gati, të ligjërimit politik në Shqipëri nga ligjërata spekulative, akuza deklarative për korrupsion, nga mosbesimi, zhvlerësim, shpërfillja, personalizimi apo kapërcimi e sfidimi i institucioneve dhe Kushtetutës. Këto karakteristika të perceptuara të ligjërimit politik në Shqipëri janë denoncuar në mjaft raste si të papranueshme dhe si

simptoma kronike të një papjekurie politike. Mirëpo pavarësisht se intuitës së mprehtë, vëmendjes dhe kujtesës politike që shumë analistë sot në Shqipëri kanë dhe e ofrojnë për publikun, fakti qëndron që asnjëherë nuk kemi patur të dhëna konkrete, të nxjerra nga ndonjë studim shkencor mbi ligjërimin politik në Shqipëri. Mungesa e sistematicitetit dhe e përdorimit të metodave hulumtuese shkencore është faktor i rëndësishëm në besueshmërinë e analizave, dhe ndoshta, për rrjedhojë, edhe në ndikimin e tyre.

Për të analizuar përputhjen partiake me ideologjitë përkatëse (e djathta dhe e majta) në Shqipëri, pikënisja e studimit ishte një fjalor ekzistues i përdorur nga dy studiuesit Laver dhe Garry (2000), të cilët e ndërtojnë leksikun e djathtë dhe të majtë në kategori të tilla si: institucionet, ligji dhe rendi, mjedisi, çështjet social-ekonomike, dhe vlerat.

Përsa i përket ligjërimin mbi Bashkimin European dhe Evropën në përgjithësi, të dy figurat politike si dhe gazetatat e përditshme duket se e kanë prioritet kryesor. Por ndërsa ligjërimi për BE-në në terma të përgjithshëm është i lartë, ligjërimi për reforma të caktuara në qendër të integritetit është i ulët, me përjashtim reformës zgjedhore dhe asaj në drejtësi.

Studimi i OSFA-së merr në analizë edhe ligjërimin mbi institucionet në vend. Çdo gazetë si edhe deklaratat e Ramës kanë ardhur duke theksuar kritikën mbi integritetin e institucioneve dhe sfidimin e kërcënimit ndaj tyre, ndërkohë që Berisha ka rritur vetëm ligjërimin mbi sfidimin dhe kërcënimin e institucioneve. Kjo është interesante pasi anë të kundërta në politikën në vend – Rama dhe Berisha – të dy ose i sfidojnë e kërcënojnë institucionet, ose i quajnë ato të sulmuara nga pala kundërshtarë.

Përsa i përket nën-kategorive të ashtuquajtura “pozitive”, ku renditen fjalë që potencialisht shprehin vlerësim për institucionet, ky studim është më pak i sigurt, pasi fjalët brenda këtyre nënkategorive mund të jenë ose një shprehje dëshire për integritet dhe funksionim, ose kritikë ndaj mungesës së integritetit dhe jo-funksionimit, ose premtime.

Sidoqoftë, duke marrë parasysh se të paktën disa nga këto fjalë janë faktikisht kritika ndaj institucioneve, kjo e thellon akoma më tepër konkluzionin se në Shqipëri ligjërimi ndaj institucioneve është kryesisht, dhe në një pjesë dërmuese, negativ dhe sidomos për sa i përket integritetit të tyre.

5.3.1 *Kultura e komunikimit politik berishian*

Identifikimi me liderin që përmbysi njërin nga format më të ashpra të komunizmit në Evropën Lindore, prouesternizmi dhe rringjallja e vlerave kombëtare, ishin tre karakteristika që do t'ia japin Sali Berishës pasaportën për të dalë nga Shqipëria e mbyllur dhe gjithashtu për të hyrë dhe për t'u pranuar në Kosovë dhe gjithandej ku jetojnë shqiptarët jashtë shtetit shqiptar. Kjo nuk do të jetë e lehtë e pa keqkuptime, as për kryeministrin aktual shqiptarë, as për të tjerët që jo gjithmonë do ta kuptojnë drejtë antikomunizmin e tij. Do të kaloj shumë kohë qysh atëherë, por e gjitha do të jetë kohë shumë e mundimshme dhe me shumë probleme për të gjithë në Shqipëri dhe do të jetë gjithsesi e tillë edhe për njërin nga protagonistët kryesor të ngjarjeve kryesore, Sali Berishën. Por edhe përkundër shumë baticave e zbaticave, atij do ti shkoj për dore që simpatin e tij në Kosovë e gjetiu ta zgjeroj dhe ta shtrijë atje ku sot asnjë politikan tjetër nga Shqipëria nuk e ka arritur. Gjithësesi se për këtë ka kontribuar edhe përpjekje e tij dhe natyrisht jo vetëm e tij, për ta anëtarësuar Shqipërinë në NATO dhe për ta ndërtuar rrugën që lidh Shqipërinë me Kosovën. Por ka edhe diçka tjetër që nuk është kështu konkrete dhe nuk është kështu e dukshme sikundër janë këto dy rezultatet të fundit, por ka kohë që në një ose mënyrë tjetër përceptohen nga qytetarët e Kosovës dhe i dedikohet apo identifikohen me Sali Berishës e kjo është mënyra e komunikimit të tij politik, mënyra e qasjes dhe zgjedhjes së problemeve nga më të ndryshmet.

Është e njohur se në këtë drejtim pra në drejtim të kulturës së komunikimit politik dhe jo vetëm politik, ka dallime jo të vogla ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo vërehet shumëkund, edhe në mediat, vërehet edhe tek intelektualët, edhe në të përditshmen e vërehet më së miri në politikë, thjeshtë tek politikanët dhe pushtetarët. Gjithsesi se këto dallime janë të determinuara nga rrethanat e ndryshme në të cilat kemi qenë për jo pak kohë e posa çërisht, nga vitet e komunizmit në Shqipëri e ato të pushtimit serb në Kosovë. Në Shqipëri kjo kulturë komunikimi posaçërisht në politikë, në formën e saj pozitive di të jetë më e drejtëpërdrejt, më konkret, dhe më efikase, ndërkaq në aspektin negativ ai mund të jetë iritues, i padenjë dhe ka ditur të qoj deri në përleshje tragjike jo vetëm të grupeve rivale politike. Në Kosovë ky komunikim në formën e saj pozitive është i matur, jo i ngutshëm dhe bindës, në aspektin negativ ai nuk është konkret, por pështjellues, nuk është i drejtëpërdrejt as i sinqertë, por hezitues dhe për rjedhojë krejt i pasukseshëm.

Berisha nga të gjithë njihet si politikan i drejtëpërdrejt, jo hezitues, që nuk ka nguruar t'i akuzojë ata që ka menduar se e meritojnë këtë duke ua bërë me gisht dhe duke i emruar konkretisht dhe zëshëm ata që ai ka menduar se e meritojnë një gjë të tillë. Të gjithë e dimë se kjo në Shqipëri nuk ka qenë aspak e lehtë, përkundrazi.

Një "case study" që ka frymuar librin e shkruar nga Alfred Lela. Libri trajton ligjërimin politik të së djathtës dhe të ish-kryeministrit Sali Berishës, si njeriu që e ndërtoi Partinë Demokratike duke u bërë kryeministër në vitet 90-92. Libri i cili e ka huazuar titullin nga latinishtja, në shqip do të quhej "*Siç thoshim*" është vepra me të cilën autori ka mbrojtur edhe gradën doktor shkencash.

Sipas autorit, Berisha e përdor shumë gjuhën si mjet njohës, dhe kryesisht në një formë inverse duke i mveshur të tjerëve një identitet të cilin në fakt e ka ndërmend për veten. (Lela, 2017).

Diskursi i Berishës ‘interesohej’ për gjuhën që ndërton krahasime apo përthyerje të forta; ai me anë të gjuhës krijon hendeqe politike, morale a botëkuptimore të cilat mund të grupoheshin edhe në kategoritë etike ‘e mira/e keqja’ (Lela, 2017).

5.3.2 *Kultura e komunikimit politik ramist*

Përpara se Edi Rama të hynte në politikë, komunikimi politik në Shqipëri, nuk kishte filluar akoma. Deri në vitin 1997-1998, e majta shqiptare ishte në inercinë e propagandës puniste, kurse Partia Demokratike e Sali Berishës ishte në të njëjtat skema me kokë poshtë të propagandës politike, pra thjesht dhe ata ishin në një stil komunikimi politik propagandistik. Më shumë se 10 vjet më vonë, kur duket se të gjithë mund të bëjnë gjithçka, ka megjithatë një meritë për t’u vënë në vendin e vet: Edi Rama mund të konsiderohet pa asnjë dyshim si themeluesi i komunikimit politik në Shqipëri. Madje më shumë se kaq: përdoruesi më efektiv i këtij instrumenti, pa të cilin nuk mund të kuptohet politika e sotme.

Jo më kot, është ky “case study”, pra analiza e stilit të komunikimit politik të Edi Ramës, që i ka tërhequr vëmendjen gazetares dhe pedagoges Belina Budini.. Ky libër inkurajon kapërcimin e meta-gjykimeve apo propagandës pro apo kundër Edi Ramës, si rast shumë i diskutueshëm i komunikimit politik në Shqipëri dhe kalimi në gjykime me natyrë shkencore mbi komunikimin politik në këtë vend. Por edhe si një inkurajim që pedagogët, studiuesit apo gazetarët me përvojë tashmë, sikurse është Budini, të mund të

“dokumentojnë” punën dhe gjykimin e tyre mbi aktualitetin në vend duke hedhur në agorën e debatit publik, hiç më pak se “ide të reja” apo “qasje të reja”.

Autores i tërheq vëmendjen Edi Rama, i cili në një marshim të pandalshëm politik nga faqet e shtypit të lirë shqiptar të gjysmës së parë të viteve ‘90, arriti të kapte kreun e njërit prej dy krahëve të spektrit politik shqiptar, atë të PS-së. Kjo, pasi kishte arritur të qeveriste kryeqytetin e vendit për dy mandate dhe një të tretë në vazhdim. Si shpjegohet që dikush që vinte nga jashtë partisë, madje që kishte tallur dikur ish-Partinë e Punës, të mund të kapte kreun e kësaj partie, një prej dy partive kryesore në vend? Ka vetëm një të tillë shpjegim: media.

Rama ishte një intelektual i viteve ‘80, ekstravagant në të gjitha drejtimet dhe mëtoi pafund për të gjetur një vend me rëndësi në skenën politike pa asnjë avantazh kushedi se çfarë nga të tjerët. Por, pasi kishte kuptuar para të tjerëve në këtë mëtim të palodhur vetëm një gjë: sot gjithçka është “komunikim”, ose pothuajse. Të gjitha të tjerat në funksion të kësaj: idetë, investimi intelektual e emocional, trafiku i interesave: gjithçka tjetër këtu te media.

Edi Rama e ka thënë vetë jo pa qëllim “unë jam pop–star mes politikanëve dhe politikan mes pop-starëve”. Kjo fjali simbolike që përbën dhe vertebrën dhe titullin e studimit të Belina Budinit, është tejet problematike nga pikëpamja e përkufizimit, ndaj të ndërmarrësh një analizë mbi komunikimin politik të Edi Ramës është tejet e komplikuar. Duke përdorur një aparat shkencor bashkëkohor të shkencave të komunikimit, autorja analizon deri në detaje, mënyrën e operimit të Edi Ramës dhe rrugën e tij për të krijuar këtë imazh politik që ka sot. Edhe pse në 30 vjetët e fundit bota perëndimore ka njohur “case study” të tjerë të kësaj natyre, për Shqipërinë rasti Rama shënon me të vërtetë një premierë.

Kjo premierë, bashkë me meritën e sjelljes së një modeli të ri, ka pozuar një problematikë po aq të madhe sa vetë modelit: cilat janë limitet dhe rreziqet e modelit Rama të komunikimit. Këto limite Edi Rama i ndjeu vetë mbi kurriz gjatë zgjedhjeve të 28 qershorit, kur bashkë me suksesin e modelit të vet të komunikimit ai vuajti dhe pasojat e kufizimeve të këtij modeli, apo ky model iu kundërvu. Duke qenë shpesh thjesht imazh pa shumë përmbajtje dhe duke kujtuar se kjo mjafton, Edi Rama në zgjedhjet e fundit nuk qe në gjendje të përballonte asnjë debat për së mbari me gazetarë, analistë apo specialistë të fushave të ndryshme lidhur me platformën e tij të 28 qershorit. Duke u mbështetur tek iluzioni se komunikimi ka mundësi të pafundme për të prodhuar politikë, ai neglizhoi një program të vërtetë politik, ra në iluzion lidhur me fuqinë e tij të vërtetë politike, duke kaluar deri në tone apo nuanca mesianike në prezantimin elektorale në këto zgjedhje. Një problem tjetër tejet i madh i modelit Rama në komunikimin politik është infrastruktura e gjerë dhe shpesh e errët që kërkon pas kuintave një prani dhe një lojë mediatike pa limit, sikurse ai ka patur këto 10 vjet. “Revolucioni ha bijtë e vet”, thotë një shprehje e vjetër. Pikërisht sot, kur është një pozitë politike tejet të vështirë nga humbja në zgjedhjet e fundit politike, Rama më shumë se të gjithë të tjerët po i prek me dorë limitet e modelit të tij, limitet e ekzagjerimit të modelit të tij. Nga një pop–star mes politikanësh, Rama themeloi një racë të re politikanësh populistë: është një tip tjetër populizmi, që për marrëveshje fjale mund të quhej: “PR – POPULIST”, që do të thotë “populizmi i mbështetur mbi marrëdhëniet publike, mbi komunikimin politik”. Vetëm se Rama gjatë këtyre viteve i pati të dyja, hem të qenit “star”, hem të qenit “populist”. Me një fjalë, një populist–star.

Me t’u zgjedhur kryetar i Partisë Socialiste në tetor të vitit 2005, Edi Rama e ndryshoi diskursin e tij nga një sulm kundër politikës në përgjithësi, në një sulm kundër politikës së vjetër në emër të një politike të re. ‘Politika e vjetër u ka shkaktuar shumë dëme

Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ka helmuar gjakun e shoqërisë shqiptare, ka penguar atë dhe zhvillimin e saj' (Edi Rama, 26 maj 2007). Nga ana tjetër, njësia kuptimore e zbrazët e Politikës së Re përmban sipas tij, gjithçka që politika e vjetër nuk mund të jetë: zhvillim ekonomik, transparencë, integrim europian dhe kështu me radhë. Kjo politikë e tij e re nuk i adresohet ndonjë grupi social në veçanti, por të gjithë qytetarëve në tërësi. 'Politika e re e sjell politikën në duart e qytetarëve, duke vënë në qendër qenien njerëzore dhe nevojën për më shumë liri, të drejta dhe mundësi' (po aty). Ky diskurs ka pra për qëllim ta mobilizojë shoqërinë shqiptare rreth një projekti politik që nuk është as i majtë dhe as i djathtë, por thjesht kundër një armiku që është politika e vjetër. Kjo është arsyeja pse Rama ka deklaruar hapur se përtej të Majtës dhe të Djathtës është Shqipëria. Për të 'njerëzit e këtij vendi janë shqiptarë përpara se të jenë socialistë apo demokratë' ('Panorama', 12 korrik 2008). Kësisoj, projekti politik i Ramës nuk mbështetet në të qenit e një elektorati të caktuar, por në nocione të vakëta si 'dimensioni njerëzor' që është i pajtueshëm me çdo kategori sociale. Pjesa e dytë e studimit përqendrohet në analizën teorike, e cila merr në shqyrtim disa nga perspektivat kryesore në konstelacionin teorik të media-politikës duke nënvizuar rolin e mediave në proceset politike, veçanërisht për sa u përket vendeve me demokraci në zhvillim. Seksioni që i bashkëngjitet perspektivës teorike përvijon kornizën metodologjike, ku mbështetet kërkimi empirik dhe analitik rreth objektit tonë të studimit. Kjo metodë i jep përparësi analizës së diskursit, mbështetur tek Ernesto Laclau. Brenda spektrit të komenteve dhe analizës, një pjesë e interpretojnë diskursin e Politikës së Re të Edi Ramës si version populist. Edhe pse nënteksti i saj mund të jetë përcjellja e një mesazhi të politikës moderne dhe vendosja e lidhjeve të drejtpërdrejta me popullin, kritikë të tij shprehen se Edi Rama mbetet në stadin e një politikani populist, të cilit i mungon më e rëndësishmja, platforma politike (Lubonja:

2008). Sipas tij, nuk mund të jetë e mundur për Ramën që të zhveshë kostumin e politikanit dhe të evitojë qarqet politike dhe ekonomike të cilat e kanë sjellë në pushtet, sepse ‘Rama nuk mund të dalë kundër interesave të Partisë Socialiste, kur në mënyrë që t’u shërbejë interesave të qytetarëve të cilëve u drejtohet, ai na bën të besojmë se do ta bëjë këtë...’(po aty). Ka edhe nga ata që e lexojnë diskursin gjithëpërfshirës të Ramës në një kënd simpatizues duke sugjeruar që, nëpërmjet deklaratës së të qenit qytetar në radhë të parë, Rama po kërkon një bashkim përtej politikës së majtë dhe të djathtë në frymën e Barak Obamës dhe të Reganit (Zaloshnja, 2008). Të tjerë vijojnë në mënyrë kritike ta cilësojnë liderin e Partisë Socialiste si hapurazi demagog, pasi në të vërtetë ‘ai po kontribuon në zgjerimin e hendekut mes pushtetit dhe qytetarit’. Sipas tyre, pretendimet e Edi Ramës bien, pasi ai nuk mund ta quajë veten qytetar duke evituar politikën për sa kohë që edhe vetë qytetari është një kategori politike (po aty). Analiza dhe komente të tilla nuk e vënë megjithatë rastin e diskursit të Ramës në kontekst, kur pikërisht me rastin e veçantë të një vendi në tranzicion duhen lidhur shqetësimet për versionin populist të politikës së Ramës. “Siç sugjerojmë në kornizën teorike të këtij studimi, problemi më i madh që vjen nga diskursi ‘anti’ ka të bëjë me vështirësitë që ai nxjerr për ndërtimin e institucioneve të besueshme dhe serioze si dhe konsolidimin afatgjatë të tyre. Dhe vërtet, në përputhje me këto pritshmëri si përbërëse të drejtpërdrejta të një projekti ‘anti’, lideri i Partisë Socialiste i ka transformuar praktikisht në mënyrë radikale strukturat e kësaj partie , duke dobësuar fuqinë e forumeve drejtuese dhe përfaqësuese brenda saj, të cilat më parë kishin rol mjaft të rëndësishëm për debatin dhe orientimet e politikave në parti”, - shprehet në librin e saj Belina Budini. Edhe mediet marrin rol në këtë proces dobësimi të demokracisë së brendshme institucionale. Ndonëse jo me vetëdije të plotë, ato i shërbejnë liderit të PS si mjete për të evituar kanalet institucionale, ngase Rama gjithnjë

u ka dhënë përparësi medieve kur zgjedh të transmetojë një mesazh, qoftë edhe në rastet kur publiku të cilit ai i drejtohet janë anëtarët e trupës së Partisë Socialiste me të cilët, komunikimi brenda strukturave të partisë do të ishte zgjedhja më e drejtpërdrejtë. “Pas kësaj ekspozije të shkurtër kontekstuale, kapitulli pasardhës do të fokusohet substancialisht në procesin e fabrikimit të imazhit të Edi Ramës nëpërmjet mediave , që përbën edhe linjën kryesore të kërkimit empirik rreth modelit të tij” (Budini, 2009).

Gjatë tranzicionit drejt askundit dhe si askund tjetër, shoqëria shqiptare nuk ka se çfarë të tregojë si arritje e kultivim të së mirës e të virtytit. Ekonomia kombëtare është e shkatërruar dhe pasuria kombëtare është shpërdoruar. Një milion e gjysëm njerëz janë detyruar të emigrojnë. Këta ishin gjysma e popullsisë shqiptare. Tani po kthehen si njerëz me duart e arta, profesionistë, por që janë shpirtna të humbur, pa të ardhme, pa të shkuar e pa shpresë sepse mërgimi i ka thyer dhe në shtetin shqiptar nuk gjejnë më asgjë. Shoqëria është e fragmentarizuar dhe nuk ka as elementët bazë të një morali të shëndoshë që ta mbajnë bashkë. Kriminalizimi është në rritje. Të gjithë janë të përfshirë në rrjetën e sjelljes jot ë ndershme, sepse nuk funksionohet ndryshe. Materializmi është bërë ekstrem. Paria sunduese janë monstra të nivelit më të ulët që mund të gjinden. Kur e sheh nga jashtë shoqëria shqiptare duket si një kamp përqëndrimi ku njerezve iu është dhënë vetëm një mundësi që të hanë njëri tjetrin dhe të shpresojnë se atë vetë do ta hanë të fundit. As Dreqi nuk do të kishte punuar me kaq kujdes për të ndërtuar këtë system që ka ndërtuar paria e Tiranës. Ligësia është bërë normale, ligësia është parimi mbi të cilin funksionohet, Shteti dhe strukturat janë në shërbim të Ligësisë. Më e shumta që mund të bëjë njeriu i ndershëm, i moralshëm dhe i drejtë, ai që e don të mirën për vetë dhe për të tjerët është që të ruajë veten e familjen e vet. Ata që besojnë drejtohen tek feja. Ata që nuk besojnë

jetojnë në heshtje. Ata që nuk durojnë gjejnë një rrugë e sikterisen në mërgim. Dhe nga sipër e nga larg, duket sikur Ligësia ka triumfuar në shtetin shqiptar.

5.4. Pse ligjërimi politik i Tiranës është përgjithësisht i djathtë

“Të matësh” ligjërimin publik në një vend nuk është një punë e lehtë. Për më tepër, në të gjitha rastet do të rezultojë, për arsye të kuptueshme, një “matje” e pasaktë. Por autorët e këtij studimi ishin përpjekur të adoptonin një metodologji, që garantonte një saktësi optimale, s’ka gjë se saktësia optimale mbetet prapëseprapë larg, shumë larg, saktësisë ideale. Ata ishin përqendruar te ligjërimi i atyre që e sundojnë hapësirën publike (hapësirën publike të kuptuar më së shumti në versionin habermasian, si public sphere, d.m.th. si arena ku hidhen, përplasen e negociohen idetë e individëve, të grupeve të ndryshme, të shoqërisë civile, të politikës, të kulturës etj.), ishin përqendruar pra te stili i ligjërimit të Kryeministrit, të liderit të opozitës, te gjuha e përdorur nga pesë gazetatat kryesore (“Panorama”, “Shqip”, “Mapo”, “Shekulli” e “Gazeta Shqiptare”), dhe te lënda e ligjërimeve të këtyre aktorëve, që në terma më konkretë nënkupton qëndrimet ndaj çështjeve të caktuara me interes publik.

Dhe ish arritur në një numër përfundimesh interesante, si fjala vjen, “të dyja figurat kryesore politike në Shqipëri e përshkruajnë njëri-tjetrin me një gjuhë plotësisht negative; ligjërimi negativ ka ardhur në rritje në periudhën menjëherë para dhe pas zgjedhjeve; ligjërimi për dhunën ndaj grave ka ardhur në rritje; nuk ka ligjërim fyes ndaj minoriteteve etnike; ligjërimi për fenë ka ardhur në rënie në të gjitha gazetatat, përveç “Gazetës Shqiptare”; Rama flet më pak se Berisha mbi fenë dhe minoritetet; Gazeta “Shqip” diskuton më shpesh çështjet e etnisë dhe feve të ndryshme në krahasim me gazetatat e tjera”. Ish arritur dhe në një përfundim tjetër, në të cilin do të doja të ndalesha: “Ligjërimi

i djathtë është më i pranishëm se ai i majtë; Rama e ka ligjërimin të majtë më pak se sa Berisha e ka të djathtë; me fjalë të tjera, Berisha flet më shumë për gjëra të djathta se sa Rama për gjëra të majta.”

Kjo e fundit ka ngjarë të jetë e vërtetë edhe pa u bërë ky studim (dua të them se ka një perceptim popullor, që shkon në favor të së njëjtës tezë). Sigurisht, gjithçka varet nga periudhat, që marrim nën shqyrtim. Nëse ky studim do të ndalej në javët, në të cilat PS-ja nxori një dokument programor, në të cilin flitej shumë e qartë mbi disa qëndrime të majta (tatimi progresiv, inkurajimi i prodhimit bujqësor, rritja e shpenzimeve publike dhe e pranisë së shtetit në shoqëri), me siguri do të kishim një rezultat tjetër. Por marrë në tërësi, përfundimi ku është arritur prej studimit në fjalë nuk duket i pasaktë.

Në këtë pikë duhet bërë një saktësim; nuk është se është kjo gjë që e ka bërë PS-në më pak ndjellëse për elektoratin, e që e ka lënë në opozitë; do ish naive të thuhej kjo gjë; rezultati i zgjedhjeve këtejpari varet nga një numër faktorësh jashtëprogramorë, mes të cilëve trukimi i rezultatit; në këtë kuptim, nënvizimi i bërë thjesht tregon se PS-ja, dhe lideri i saj Rama, janë më pa lëndë në pikëpamje ideologjike.

Pse ndodh kjo? Ka disa arsye. Në radhë të parë, Edi Rama vetë është nga natyra e formimi një qenie më pak ideologjike. Nuk është se Berisha është një qenie qartësisht më ideologjike (që të dy janë pragmatikë e eklektikë), por Berisha ka një identitet më të theksuar të origjinës biologjike (ka lindur e është rritur në një mjedis familjar, klanor e social, ku shenjtëroheshin e shenjtërohen vlera tipikisht konservatore, si kombi, ndoshta feja, familja tradicionale, prona private, individualizmi) dhe një identitet më të artikuluar të origjinës politike (ai shoqëroi dhe udhëhoqi, lindjen e opozitës antikomuniste në Shqipëri).

Në radhë të dytë, Berisha i kthehet herë pas here kauzës së antikomunizmit (në mënyrë folklorike e demagogjike, kuptohet, por për autorët e studimit kjo nuk merr, e nuk ka pse të marrë rëndësi; për ta ka pasur rëndësi se sa herë e kanë gjetur fjalën “bllokmen” dhe sa më shumë ta kenë gjetur, aq më shumë u ka anuar kandari nga identiteti i djathtë i Berishës); por kjo kauzë ka qenë dhe e Ramës si prej kompleksit që Rama ka si kreu i një partie ish-komuniste, ashtu edhe prej faktit që ai ndihet thellë-thellë më antikomunist se Berisha; e kështu i tërë ligjërimi qëllon të marrë një ngjyrim të djathtë.

Në radhë të tretë, opozita ka harxhuar shumë kohë me denoncime e me kanosjen dhëmbë për dhëmbë me mazhorancën, të cilat nga natyra nuk janë as të majta e as të majta, madje, nga natyra nuk janë as politike.

Në radhë të katërt, ka rëndësi të dihet se mbi ç’kritere janë vlerësuar ligjërimet. Ca kritere që vlejné në Irlandë, apo Kanada, si zor të vlejné edhe në Shqipëri, ku dialektika politike ia ka lënë shpesh vendin luftës kundër një regjimi.

Dhe në fund kemi arsyen e pestë, më të rëndësishmen, që shpjegon natyrën “e djathtë” të ligjërimin publik të këtyre dy aktorëve të rëndësishëm të politikës, por edhe të gazetave të Tiranës: bazuar në qëndrimin ndaj vlerave, shoqëria shqiptare në tërësi, e elektorati në veçanti, rezultojnë të jenë konservatorë. Komunikimi më i madh gjatë dekadës së fundit mes shqiptarëve të këtushëm e shqiptarëve të Kosovës e të Maqedonisë e ka rritur ca më shumë identitetin konservator të shqiptarëve të këtushëm, pasi ka sjellë më shumë fanatizëm në qëndrimin ndaj familjes, ndaj fesë, ndaj kombit, ndaj grave, më saktë kundër grave, e pastaj kundër minoriteteve, kundër gay-ve, kundër “shthurjes së rinisë”, kundër “veseve të Perëndimit”, në favor të dorës së fortë në qeverisje, në favor të gjuhës së fortë kundër krimit, në favor të sigurisë etj., etj. Këto që rreshtova janë çështje, te të cilat ndahen (gjetkë) të majtët nga të djathtët; dhe ndahen egërsisht. Këtu te ne nuk

ndahen. Përkundrazi, të majtë e të djathtë janë tok. Unë nuk e di se sa i majtë është praktikisht Rama, por edhe sikur të ish 100% i majtë, ai nuk do të guxonte të dilte me qëndrime e teza që mund ta ftohnin me zgjedhësit shqiptarë (fjala vjen, të denonconte nga pozita të majta flamën nacionaliste që i ka përfshirë të gjithë). Kuptohet, për sa kohë në mendje, shpirt e zemër, ashtu si Berisha e të tjerët, ka pushtetin, e jo pasionin për idetë.

KAPITULLI VI

DISKURSI I LIDERIT NË SHQIPËRI - PYETËSORI DHE ANALIZIMI I TIJ

6.1. Mostra dhe modeli i anketimit

Në kontekst të temës, kam përdorur metodën historike, metodën analitike, atë krahasuese dhe metodën statistikore.

Që ky hulumtim të jetë profesional dhe objektiv duhen përdorur këto metoda:

- Anketuese
- Krahasuese

Shpërndarja proporcionale nuk e përfshin variacionin dhe koston e bërjes së kërkimeve për njësi. Kur i përfshijmë që të tre faktorët, madhësinë e grupit, variacionin në secilin grup dhe koston për çdo njësi të kërkimeve, përftojmë një mostër me shpërndarje optimale. Nëse popullimi është i madh na nevojitet proporcionalisht mostër e madhe, p.sh. madhësia e mostrës është proporcionale me shtresën. Ngjashëm me veçorinë e madhësisë, popullimi me variacion të madh kërkon mostër më të madhe se sa ato me variacion të vogël. Ne marrim mostër të vogël ku kostoja për njësi të kërkimeve është e lartë dhe të kundërtën mostra e madhe në popullsi, ku kosto për një njësi është e ulët.

Pra gjatë punimit është përdorur metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave, gjegjësisht është përdorur pyetëtori për mbledhjen e të dhënave. Kjo më ka ndihmuar që më lehtë të bëj krahasimin e variablave të përdorur për të testuar hipotezat e parashtruara.

Metodë tjetër e përdorur në këtë punim është metoda përshkruese, përmes së cilës kam përshkruar materialet editorale, punimet shkencore, materialet enciklopedike, raportet zyrtare dhe literatura primare me materien nga autorë të ndryshëm, të përmendur në pjesën e rishikimit të literaturës.

Pas aplikimit të pyetësorëve, dhe përshkrimit të popullatës sipas pikëpamjes statistikore, të dhënat përpunohen në programin SPSS për të nxjerrë korrelacionet, devijimin standard dhe mesataren për secilin pyetësor. Më pas, të dhënat përshkruese të pyetjeve mblidhen dhe shohim se si korrelojnë me njëra-tjetrën. Më tej këto të dhëna shërbejnë për të ndërtuar grafikët dhe tabelat e nevojshme për vizualizimin e rezultateve, se si korrelojnë të dhënat e pyetjeve me njëra - tjetrën.

Duke njohur natyrën vendore, anketat zhvillohen me mundësi anonimiteti, kjo për arsye edhe të supozimit të marrjes së më shumë përgjigjeve të sakta.

Hapi i parë: Shpërndarja e mostrës sipas popullatës.

Mostra organizohet në mbledhjen e të dhënave sipas shtrirjes së plotë, duke tentuar grumbullimin e mendimeve dhe konsideratave me të gjera, përmes përfshirjes së qyteteve kryesore të Shqipërisë në të gjithë gjeografinë e saj: Tirana, Elbasan, Durrës, Shkodra, Korça, Gjirokastra, Vlora.

Hapi i dytë: Përzgjedhja e të anketuarve.

Në pjesën e parë do të provohen të merren deri në 165 anketime për të matur pyetësin.

Prej intervistave të bëra, 29.1 % (165 të anketuar) verifikohet pyetësi në terren, dhe u shikua për nevojat e ndërhyrjes dhe strategjisë së shpërndarjes së pyetësit.

Përzgjedhja e të anketuarve për fazën e dytë është bërë prej bazës së të dhënave respektive të paracaktuara nga faza e parë. Duke plotësuar numrin e targetit të synuar; 650 të anketuar.

Pyetësi me personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë: 271 persona që janë përgjigjur.

Pyetësor me qytetarë/ekspertë/analistë politikë: 378 persona që janë përgjigjur.

Modeli

Sipas Field (2015) ekzistojnë shumë rregulla për sa i përket vëllimit të zgjedhjes së kampionit, por si rregull i përgjithshëm duhen 10 - 15 përgjigje për variabël. Duke tentuar shtrirjen dhe gjithëpërfshirjen, të anketuarit në këtë pyetësor janë zgjedhur sipas një kampioni ku është kërkuar që të jetë sa më gjithëpërfshirës në mënyrë që rezultatet të jenë gjithëpërfshirëse.

Për të vlerësuar diskursin politik të liderit shqiptar hulumtuesit janë mbështetur përgjithësisht në modele që kanë të bëjnë me produktivitetin për të vendosur karakteristikat dhe pastaj për të shtuar këto modele me treguesit e politikave.

Ky studim përdor një qasje që është përdorur nga Huselid dhe Becker (1997) dhe Bresnahan dhe Hitt (2000) dhe e ndjek më pas përkufizimi i Edgeworth. Prej modelit bazik nëse e modifikojmë sipas kushteve dhe kërkesave të temës sonë do të përfitonim ekuacionin si në vijim:

$$PR = \alpha + SMP + \beta_1 JT_1 + \beta_2 PA_2 + \beta_3 CP_3 + \beta_4 RW_4 + \beta_5 JE_5 + \beta_6 JP_6 + \beta_7 R_7 + \beta_8 JS_8 + \varepsilon$$

Ku:

PR = Produktiviteti

JP = Planifikimi i punës

SMP = Sistemi politik

R = Redaktimi politik

JT = Teoritë politike

JS = Sharjet dhe ofendimet

PA = Vlerësimi i diskursit

\beta_1 - \beta_8 = koeficientet e diskursit ofendues

CP = Planifikimi i Karrierës politike

RE = Shpërblim dhe favoret politike

\alpha = Interceptimi i diskursit

JE = Vlerësimi i punës

\varepsilon = Gabimi.

(Gujarati and Porter, 2009; Wooldridge, 2006; Asterious and Hall, 2007)

Përmes pyetësorit janë analizuar rezultatet e përgjithshme përsa i takon materies në fjalë dhe për qëllime analizimi të gjithë personat e anketuar ndërthuren në disa nga pyetjet bazike.


Pjesmarrës në pyetësor 378 qytetarë të cilët ishin të gjinisë mashkullore 45.7% dhe 54.3% femra, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga shtatë qendrat kryesore të Shqipërisë ku Tirana prin me 35% të të anketuarve e pasuar nga Elbasani, Durrësi me nga 13.7% dhe 14.2%, pastaj nga Vlora pjesmarrës ishin 7%, si dhe nga Kukësi kishte 6%, po kaq ishin edhe nga Mirdita dhe Berati me 12.1%.

Drejtuar qytetarëve ishin edhe 6 pyetje tematike të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me përshtypjet e tyre për diskursin politik të liderëve shqiptarë.

6.2. Pyetësori me qytetarë/ ekspertë/ analistë politikë

Grafiku nr. 1

- A jeni të kënaqur me mënyrën se si komunikojnë liderët politikë të Shqipërisë?



Burimi: Pyetësori me qytetarë/ekspertë/analistë politikë

Tabela 1

- **A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?**
- **Sa rëndësi ka për ju si qytetar përdorimi i një ligjërimi të qetë nga liderët e institucioneve qeveritare në vend?**
- **Ligjërimi i liderëve politikë sa është konform standardeve europiane dhe sa kontribuon në krijimin e një klime relaksuese politike?**

<i>Ligjërimi i liderëve politikë sa është konform standardeve europiane dhe sa kontribuon në krijimin e një klime relaksuese politike?</i>			<i>Sa rëndësi ka për ju si qytetar përdorimi i një ligjërimi të qetë nga liderët e institucioneve qeveritare në vend?</i>			Total
			është gjëja më e rëndësishme	është gjë shumë e rëndësishme	është gjë e rëndësishme	
midis 16%-30%	A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?	Po	42	205		247
	Total		42	205		247
midis 31%-50%	A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?	Po		3	68	71
	Total			3	68	71
më shumë se 50%	A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?	Po	69			69
	Total		69			69
	A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?	Jo	111	208	68	387
	Total		111	208	68	387

Burimi: Pyetësi me qytetarë/ekspertë/analistë politikë

	Vlera		Numri
Ligjërimi i liderëve politikë sa është konform standardeve europiane dhe sa kontribuon në krijimin e një klime relaksuese politike?	2,00	midis 16%-30%	247
	3,00	midis 31%-50%	71
	4,00	më shumë se 50%	69
A dalloni një lidhje mes veprimtarive politike të liderëve dhe komunikimit të tyre politik?	1,00	Po	378

Burimi: Pyetësi me qytetarë/ekspertë/analistë politikë

Tabela 2

- **Sa ndikon në zhvillimet politike ligjërimi politik konstruktiv i liderëve?**
- **Nëse ka akoma hapësirë për përmirësim të diskursit politik, si duhet bërë?**

		Sa ndikon në zhvillimet politike ligjërimi politik konstruktiv i liderëve?			Total
		midis 1%-15%	midis 16%-30%	midis 31%-50%	
Nëse ka akoma hapësirë për përmirësim të diskursit politik, si duhet bërë?	duke përdorur standardet europiane	90	125	163	378
	nuk ka nevojë për përmirësim	153	63	162	378
	duke përdorur penalizimet ligjore të diskursit negativ	100	74	204	378
	duke kombinuar njëkohësisht dy ose më shumë forma nga më lart	35	116	227	378
Total		378	378	378	

Burimi: Pyetësi me qytetarë/ekspertë/analistë politikë

Tabela 3.

- **Sa shpesh nga lista e mëposhtme, duke i vënë notën nga 1 në 10, keni pikasur të jenë përdorur nga liderët shqiptarë?**

Shënoni nga 1 (përdorim/aplikim shumë i madh) deri në 10 (përdorim/aplikim negativ të papërfillshëm):										
	1		2		3		4		5	
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%
a: Ofendimet direkte	64	30%	47	22%	15	7%	19	9%	19	9%
b: Sharjet personale	66	31%	47	22%	19	9%	24	11%	29	13%

c: Përdorimi i fjalëve ofenduese	19	9%	17	8%	35	16%	39	18%	12	6%
d: Fyerja i familjes	9	4%	7	3%	6	3%	19	9%	35	16%
e: Fjalor bashkëpunues dhe pozitiv	8	4%	3	1%	49	23%	68	32%	3	1%
f: Diskurs hipotetik	6	3%	4	2%	5	2%	19	9%	67	31%
g: Përdorimi i fjalorit qytetar	35	16%	39	18%	27	13%	13	6%	9	4%
h: Përdorimi i fjalimeve të stërzgjatura dhe të pakuptimta	39	18%	28	13%	42	20%	21	10%	19	9%
i: Mosaplikim i argumenteve në diskutime	6	6%	4	4%	9	9%	11	11%	16	17%
j: Shtjellim sipërfaqësor i çështjeve	9	8%	11	9%	11	9%	9	8%	10	8%
k: Diskurs retorik	69	32%	42	20%	37	17%	18	8%	16	7%
l: Degradim moral	45	21%	24	11%	14	7%	24	11%	21	10%
m: Ndikimi dhe aplikim i fjalëve të huaja të pakuptueshme në përgjithësi	69	32%	27	13%	19	9%	6	3%	24	11%

Pjesa II e tabelës së mësipërme

	6		7		8		9		10		Total
	n	%	n	%	n	%	n	%	n	%	
a: Ofendimet direkte	19	9%	15	7%	9	4%	4	2%	4	2%	378
b: Sharjet personale	10	5%	9	4%	7	3%	4	2%	0	0%	378
c: Përdorimi i fjalëve ofenduese	35	16%	27	13%	15	7%	9	4%	7	3%	378
d: Fyerja i familjes	39	18%	27	13%	41	19%	21	10%	11	5%	378
e: Fjalor bashkëpunues dhe pozitiv	3	1%	2	1%	11	5%	14	7%	54	25%	378
f: Diskurs hipotetik	41	19%	27	13%	35	16%	8	4%	3	1%	378
g: Përdorimi i fjalorit qytetar	8	4%	13	6%	24	11%	29	13%	18	8%	378
h: Përdorimi i fjalimeve të stërzgjatura dhe të pakuptimta	16	7%	24	11%	13	6%	6	3%	7	3%	378
i: Mosaplikim i argumenteve në diskutime	14	15%	21	22%	8	8%	7	7%	0	0%	378
j: Shtjellimi sipërfaqësor i çështjeve	18	15%	17	14%	14	12%	11	9%	9	8%	378
k: Diskursi retorik	7	3%	9	4%	11	5%	6	3%		0%	378
l: Degradimi moral	19	9%	13	6%	18	8%	17	8%	20	9%	378
m: Ndikimi dhe aplikimi i fjalëve të huaja të pakuptueshme në përgjithësi	8	4%	6	3%	19	9%	32	15%	5	2%	378

Burimi: Pyetësi me qytetarë/ekspertë/analistë politikë

6.3. Pyetësor për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë.

Tabela 4. Çfarë niveli-pozite përfaqësoni?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja total
Zyrtar i lartë	100	24,4	36,9
Zyrtar i qeverisjes i nivelit të parë	66	3,7	61,3
Mbikqyrës i nivelit të mesëm	89	8,0	30,7
Niveli i lartë politik	9	100,0	100,0
Total	271	100,0	

Burimi: Pyetësori për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 5. A flisni ndonjë gjuhë të huaj?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
Flas dhe komunikoj në përgjithësi në Anlisht	45	17%	17%	17%
Flas më shumë se dy gjuhë të huaja	141	52%	52%	52%
Nuk flas gjuhë të huaj	85	31%	31%	100 , 0
Total	271	100 , 0	100 , 0	

Burimi: Pyetësori për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 6. Përvoja juaj në politikë?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
Deri ne 3 vite	82	30%	30%	30%
3-5 vite	75	28%	28%	28%
Mbi 5 vite	114	42%	42%	100 , 0
Total	271	100 , 0	100 , 0	

Burimi: Pyetësori për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 7. Kur keni filluar punë?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
1990-2000	98	36 , 9	36 , 9	36 , 9
2001-2007	68	24 , 4	24 , 4	61 , 3

2008-2012	189	30 , 7	30 , 7	100 , 0
Total	271	100 , 0	100 , 0	

Burimi: Pyetësi për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 8. A keni kryer ndonjë trajnim jashtë Shqipërisë?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
Kam vijuar trajnime jashtë	84	31%	31%	31%
Nuk kam vijuar	108	40%	40%	40%
Kam vijuar trajnime brenda Shqipërisë	79	29%	29%	100 , 0
Total	271	100 , 0	100 , 0	

Burimi: Pyetësi për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 9. A keni marrë pjesë në konferenca, seminare apo workshop-e të përbashkëta me funksionarë shtetërorë të BE, OECD mbi ecurinë e diskursit të përgjithshëm politik, lidhur me standardet europiane dhe bashkëkohore?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
Kam marre pjesë dhe ka ndikuar në ngritjen e performances dhe efikasitetit	93	37%	37%	37%
Relativisht kanë ndikuar në detyrat e përditshme	75	30%	30%	30%
Nuk kam pasur rastin të marrë pjesë në takime të tilla	86	34%	34%	100 , 0
Total	254	100 , 0	100 , 0	

Burimi: Pyetësi për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 10. Si e vlerësoni diskursin politik të liderëve shqiptarë?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
Pozitiv	145	54%	54%	54%
Relativ negativ	96	35%	35%	35%
Nuk kam ndonjë koment	14	5%	5%	5%
Total	271	100 , 0	100 , 0	100

Burimi: Pyetësi për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

Tabela 11. Cili është niveli i komunikimit ndërmjet zyrtarëve politikë në vend?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	totali
Nivel i lartë	185	68%	68%	68%
Ulët-Mesëm	78	29%	29%	29%
Nuk komunikojmë	8	3%	3%	100 , 0
Total	254	100 , 0	100 , 0	

Burimi: Pyetësi për personat e angazhuar në politikë në Republikën e Shqipërisë Verë, 2015

KONKLUSIONE

Politika shqiptare gjatë njëqind e kusur viteve të kaluara, që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë e deri më sot, duhet shikuar para së gjithash si një proces politik me të gjitha fazat që zakonisht i përmban një proces. Në fakt, të kuptuarit e thelbit të zhvillimeve politike dhe të sistemit politik të një shteti apo kombi bazohet në njohjen e fazave të atij procesi politik. Po ndodh shpeshherë, që vrojtuesit politikë të kohës së sotme, kur flasin për politikën shqiptare, në shikim të parë, e shohin atë si një fenomen që përkujton zënkat dhe konfliktet në skenën politike. Mirëpo, ky perceptim (më tepër asocues sesa i thellë) përfshin në vetvete vetëm një politikë të çastit nga spektri i përgjithshëm politik. Zënkat dhe konfliktet në skenën politike shqiptare, në parim, nuk kanë të bëjnë as me traditën e as me kulturën politike shqiptare. Ato janë vetëm një imazh i kohëpaskohshëm nga tërësia e procesit politik. Sikurse çdo proces politik, edhe ai shqiptar, përbëhet nga segmente të ndryshme, përfshirë ndonjëherë edhe zhvillime negative e atipike. Nuk duhet harruar se gjeneza e një procesi politik, në parim, është ekzistimi i shumëllojshmërisë së interesave, të cilat, ndonjëherë, mund të rezultojnë edhe me kërkesa dhe sjellje të ndryshme. Prapëseprapë, edhe përkaj imazheve të tilla atipike, tërësia e zhvillimeve politike shqiptare paraqet një proces politik që, në esencë, mbështetet në vlerat e paqes, demokracisë, konstruktivitetit dhe tolerancës.

Procesi politik njëqindvjeçar i shqiptarëve është një rrugëtim shumë i gjatë, tejet dinamik dhe aspak i rëndomtë. Pa marrë parasysh të gjitha lëkundjet, ngritjet e rëniet, ky proces politik, megjithatë në vazhdimësi, ka arritur që të sillet në kuadër të komizës së vet tipike dhe origjinale, që mbështetet në vlerat e universale dhe humanizmit. Kuptohet, këto dy kategori vlerash të përgjithshme i identifikojmë, nëse procesi i politikës shqiptare vrojtohet nga një perspektivë objektive e reale, duke e parë procesin nga një këndvështrim

më i gjerë e global e, jo vetëm, siç jemi të prirë shpeshherë, që gjërat fatkeqësisht ti shohim në kuadër të komizës më të ngushtë të një pikturë të vogël, çka na bën që aty të mashtrohemi. Procesi i politikës shqiptare fillon shumë më herët se në vitin 1912. Ky proces fillon qëkurse nis rrugëtimi i gjatë i ideimit të projekteve për themelimin e shtetit shqiptar dhe qëkurse nis beteja disashekullore për liri. Këto përgatitje janë të frymëzuara e të përcjella tërë kohën me mendimin politik të rilindësve shqiptarë. Porse si çdo herë, edhe deri në vitin 1912 (sikurse edhe tani në shumë procese) shpeshherë na mungon vlerësimi dhe zbatimi i hapit të fundit, sikurse edhe hapi që shpie drejt rrumbullakimit të simbolikes në proces. Kështu që viti 1912 duhet të konsiderohet si viti i zyrtarizimit dhe përmbylljes së simbolikes në shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar modern. Me këtë vit nis rrugëtimi i politikës moderne shqiptare.

Në fakt, kjo politikë që shënoi kohë më parë njëqmdvjetorin e vet, që nga fillimi profilizohet si një politikë moderne evropiane, e cila për fanar të vetin njeh mendimin politik humanist dhe universal të rilindësve shqiptarë, pra duke ndjekur e mbajtur gjithnjë rrugën e profilizimit të politikave të tjera moderne perëndimore të cilët po ashtu mbështesin politikat e tyre të mendimi politik dhe filozofik i iluministëve dhe humanistëve të dalluar evropianë. Megjithatë, ndryshe nga shumë popuj të tjerë ballkanikë dhe evropianë, në rastin shqiptar, epoka e Rilindjes përbën një lëvizje të gjithanshme kombëtare, jo vetëm në rrafshin kulturor, por edhe me një përmbajtje esenciale të re ideologjike, politike, ekonomiko--shoqërore, si dhe organizative në kuptim të procesit politik që fillon që para shpalljes së pavarësisë. Shpeshherë, ajo që i mungon tërësisë së procesit politik shqiptar gjatë këtyre njëqind viteve të shkuara, pa dyshim është kontributi dhe strukturimi i rolit të studimit politik në atë proces. Ka ndodhur që trashëgimia e vetme e qëndrueshme dhe e zbatueshme e mendimit politik shqiptar gjatë

shekullit të parë të politikës shqiptare të mbetet nga periudha e filozofisë politike të Rilindjes Kombëtare. Mendimi politik shqiptar ndërkohë artikullohet natyrisht nëpërmjet studimit dhe shkrimeve të individëve të shquar, siç janë: Tajar Zavalni, Branko Merxhani, Vangjo Nirvana, Ernest Koliqi etj. (Zavalani, 2008: 6), por jo edhe në formë të organizuar të studimit apo tubimit të ndonjë plejade të mendimtarëve rreth ndonjë platforme kombëtare politike.

Nën një rrugëtim të tillë të vagëlluar të mendimit politik gjatë shekullit të parë dhe, nën një patronazh shtetëror të qeverisjeve të ndryshëm okupues e diktatorial që, shumë më tepër e ka penguar sesa e ka lejuar studimin e mendimit politik shqiptar, natyrisht që pengesat janë reflektuar edhe në identifikimin e problemeve dhe defekteve të procesit politik shqiptar gjatë shekullit të parë. Procesi politik shqiptar është fare pak i studiuar. Fare pak është shkruar për të me një qasje shkencore politikologjike. Kryesisht është shkruar në aspektin historik apo vetëm janë cekur tiparet e politikës ditore. Dhe, mbase, ky fakt mund të ketë ndikuar jo vetëm në vështirësitë e të kuptuarit të defekteve të procesit politik, por mund të ketë qenë edhe një faktor i rëndësishëm, i cili ka ndikuar kohë pas kohe negativisht në pikat konvergjente dhe divergjente të mbarësisë së procesit politik. Për më tepër se dy shekuj radhazi, në vendet perëndimore po zënë vend diskutimet e avancuara filozofike të demokracisë parë nga këndvështrimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit politik, duke ofruar mjete për qytetarët për ti artikuluar botëkuptimet e veta brenda atyre shoqërive. Por, në rastin e vendeve ballkanike, përfshirë edhe shqiptarët, këtyre çështjeve nuk i është kushtuar sa duhet kujdes si në diskutimet dhe hulumtimet e shkencave politike, në debatet e përgjithshme shoqërore etj. Pothuajse në të gjitha periudhat e formave të ndryshme të qeverisjeve në mesin e shqiptarëve përfshirë edhe periudhën që nga vendosja e pluralizmit partiak, në hulumtimet shkencore nuk u

konsiderua sa duhet domosdoshmëria e tërheqjes së vëmendjes së interesave kërkimore politike. Si rezultat i kësaj neglizhence apo mungese të interesimit pasojat duket të jenë të shumëfishta edhe për vetë procesin politik. Mes tjerash, si rezultat i kësaj situate në mesin e shqiptarëve, akoma nuk janë teoretizuar madje as çështjet elementare të studimit të kësaj fushe, si dhe çështja e shkallës së konteksteve të ndryshme shoqërore që do të kishin promovuar procesin e mobilizimit shoqëror të demokracisë dhe pluralizmit politik përballë treguesve shqetësues të apatisë politike. Megjithatë, këto çështje nuk janë të vetmet që mbeten akoma pa u qasur dhe pa tërhequr një interesim të domosdoshëm teorik për të ndihmuar përfundimin e mbarëvajtjen e procesit politik demokratik. Përderisa në demokracitë funksionale nuk ka studim të mirëfilltë politik, rrjedhimisht nuk ka as politikë reale.

Shqiptarët janë ndër përjashtimet e rralla në botë nga ky parim duke pasur parasysh që në rastin e shqiptarëve krijimi i shkencave politike fillon vetëm pas rënies së komunizmit. Rrjedhimisht, është pothuajse minimal vëllimi i studimit të politikës shqiptare nga këndvështrimi i procesit politik, i cili do të kishte orientuar në mënyrë akademike e politikologjike ecurinë e kombit në kontekstin politik. Shqiptarët patën fatin e tillë që të jenë të shpëmdarë. Të njëjtin fat e patën edhe në kuptim të veprimit nën regjime komuniste pas Luftës së Dytë Botërore. Pastaj e patën fatin e hidhur që të jenë vazhdimisht të përçarë. Dhe, nën këto rrethana, frika e udhëheqjeve autoritare nga mendimi dhe studimi politik fatkeqësisht nuk ka munguar asnjëherë. Vetëm periudha e sistemit komunist përfshiu gjysmën e shekullit të parë të politikës së shqiptarëve, çka cungoi të drejtën e artikulimit, zhvillimit dhe studimit të mendimit politik real dhe të lirë. Përpos reprezaljeve, kjo periudhë gjysmëshekullore karakterizohet edhe me një frikë të paparë nga regjimet komuniste gjithandej kah ishin shqiptarët prej studimit të mundshëm

të shkencave politike. Regjimet politike të mbështetura në forma diktatoriale dhe komuniste të udhëheqjes është dëshmuar historikisht që kanë frikë nga studimi politik i lirë pa kontroll ideologjik, së paku për dy arsye: se masat në ato raste do të shihnin se paska edhe ideologji dhe mënyra të tjera të qeverisjes përpos despotizmit dhe diktaturës komuniste; dhe, së dyti, frika nga përhapja e ideve dhe leksioneve nëpërmjet studimit të formave të mobilizimit demokratik në mesin e rinisë e të masave të gjera për rrëzimin e pushtetit autoritar e diktatorial. Kjo ngecje në zhvillimin e mendimit politik, që shkaktohet nga moslejimi dhe mungesa e mundësive për inkurajimin e studimeve politike shqiptare, paraqet një pengesë jo vetëm për sistemimin e diturisë dhe mendimit politik shqiptar, po ashtu tani kur shqiptarët hyjnë në shekullin e ri të politikës, paraqet edhe zbrazëti për vetë procesin politik dhe mënyrat e politikëbërjes, qeverisjes e funksionimit të demokracisë. Në çfarë gjendje është sot mendimi politik shqiptar? Shekulli i ri i politikës shqiptare e gjen kombin me numër e cilësi diverse të universiteteve, katedrave politike, studiuesve shqiptarë, që ligjërojnë edhe jashtë vendeve të tyre; me forume të ndryshme ku flitet e lidhen me politikën shqiptare me mjaft zhurmë e polemikë, të cilat mund të jenë publicistike, por në asnjë mënyrë jo dhe shkencore. Nga ana tjetër, shumë pak shkruhet shkencërisht për politikën e shqiptarëve nga vetë studiuesit shqiptarë. Nëse vjen një vëzhgues i jashtëm dhe të pyet se cilat janë tiparet e mendimit politik bashkëkohor shqiptar, në mungesë të zhvillimit të një mendimi bashkëkohor politik, ne duhet sërish tu referohemi vlerave politike themeluese të Sami Frashërit, Naum Veqilharxhit dhe rilindësve të tjerë, ngase sot gjithandej në Ballkan ku jetojnë shqiptarë ne jemi disi në një krizë jo vetëm politike, por edhe krizë shoqërore. Kurse krizat shoqërore e institucionale zakonisht janë rrjedhoja të krizave intelektuale. Ne jemi në një krizë shoqërore, pasi duket kemi hyrë në një krizë të mendimit politik e ideologjik. Kemi

krizë të idesë për të ardhmen e kombit. Nën një mungesë të dukshme të një doktrine për kombin dhe nën rrethana të një krize intelektuale, çdokush e quan veten të zot dhe i ka dhënë kompetenca vetes për çdo gjë në kuadër të procesit politik, madje deri dhe në synimet për zhvendosjen e vlerave e të parimeve themelore të politikës shqiptare, si dhe synimeve për të krijuar një kulturë politike të zënkave e përçarjeve politike. Në kalimin nga shekulli i parë në atë të dytin të politikës shqiptare, kur kushtet e mundësitë për zhvillimin e përparuar të studimit të mendimit dhe procesit politik shqiptar janë shumë më të përshtatshme, mbetet një sfidë jo e vogël gjatë viteve të ardhshme edhe për shkencëtarët politikë që të fokusojnë hulumtimet e tyre rreth modeleve të qeverisjeve dhe formave të krijimit të politikave shqiptare, që të shtrijnë në një rrafsh empirik këto hulumtime dhe të dalin nga skemat e zakonshme të përzgjedhjes së ombrellës së hulumtimeve tani më të shfrytëzuara të integriteteve evropiane herë duke hulumtuar rastin e Shqipërisë, herë të Kosovës e herë Maqedonisë e që tanimë kanë vërshuar komunitetin akademik.

Në fakt, një hapësirë mjaft e gjerë e mendimit politik shqiptar, e formave të organizimit politik, udhëheqjes, modeleve të qeverisjes, vlerave (siç janë toleranca e rezistenca politike), të gjitha këto kanë mbetur akoma gati fare të paprekura nga hulumtimet shkencore. Këto potencialisht do ta ndihmonin kombin për identifikimin dhe planifikimin e fazave të ardhshme të procesit të politikës shqiptare të shekullit të ri. Nga ana tjetër, intensifikimi i hulumtimit shkencor politikologjik mbi procesin e politikës shqiptare, do ndihmonte për dimensionimin e vizioneve dhe të elitave të reja shqiptare. Atëherë, mbase, në mënyrë më të përhapur do të kuptohej me më pak konfuzion edhe ecuria e procesit politik shqiptar gjatë njëqind viteve të kaluara si dhe do të mund të kuptohej shumë më qartë se si duhet të marrë frymë e të kahëzohet ky proces në të

ardhmen; Atëherë, mbase, do të mund të përgatitej terreni që të fillohet edhe me lëndë mësimdhënie lidhur me mendimin politik shqiptar, apo politikën shqiptare, kulturën politike shqiptare, filozofinë politike shqiptare etj., ashtu siç kanë bërë universitetet dhe pedagogët e shumë demokracive të tjera. Dhe kjo, mbase, do të ishte tërësisht normale. Shqiptarët, sikurse edhe shumë popuj të tjerë të okupuar ndër shekuj, nuk kanë pasur rastin që të organizojnë rrjedhshëm procesin e tyre politik në mënyrë institucionale më shumë se njëqind vite dhe, fatkeqësisht, prej gjithë atyre viteve vetëm një periudhë e shkurtër i takon pluralizmit politik.

Shumica e partive politike të kësaj periudhe në vendet ballkanike kanë dalë nga transformimi i partive komuniste apo lidhjeve socialiste të mëparshme duke u riformësuar në parti të reja me profile socialiste ose socialdemokrate, nga njëra anë, dhe demokratike, nga ana tjetër.

Shumica e politikanëve të pluralizmit shqiptar ndodh të kenë qenë aktivë në politikë edhe në kohën e sistemit monist. Në kushtet e reja demokratike vazhdojnë të marrin pjesë në organizimin politik dhe janë edhe në vendimmarrje, por jo me parametra të mjedisve të reja demokratike, duke shërbyer akoma me metodat e vjetra që nuk korrespondojnë me realitetin e ri shumëpartiak. Ky është një faktor që mund të jetë një nga gjeneratorët e një panorame të demokracisë joliberalë sot në mesin e shqiptarëve; Studiuesit në disa rajone të botës po ngrenë debate teorike në shkencat politike dhe në studimet e demokracisë më konkretisht, duke pohuar se është në rritje numri i demokracive të zgjedhura që janë duke e keqpërdorur autoritetin e tyre dhe duke shkelur mbi të drejtat civile, duke i kategorizuar në radhën e demokracive liberale.

Shumica e demokracive në tranzicion në Ballkan konsiderohen për shumë përmasa të kenë tiparet e demokracive liberale, meqë në parim deklarohen të synojnë përforcimin

e demokracive liberale, kurse faktet flasin të kundërtën - për mungesë të funksionimit të vlerave elementare demokratike. Disa nga imazhet kryesore që e karakterizojnë skenën bashkëkohore partiake politike të shqiptarëve, ngjashëm me vendet e tjera të rajonit, rastisin që të jenë, në fakt, edhe imazhet kryesore që e mbizotërojnë pasqyrën dhe procesin politik shqiptar një shekull pas shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar, siç janë: niveli jo i kënaqshëm i kulturës politike, komunikimi i zbehtë politik, papërgjegjshmëria partiake, roli centralizues në procesin e vendimmarrjes politike, oligarkitë e theksuara të lidhshipeve partiake etj. Mirëpo, këto nuk janë sfidat e vetme të procesit të politikës shqiptare në kohërat më të reja që nga rënia e sistemit komunist e këtej.

Ekzistojnë edhe një sërë problemesh dhe sfidash të tjera të lidhura edhe me problemet e skenës partiake e që sistematizojnë anomalitë e procesit politik dhe nxisin mosbesimin për pjesëmarrje politike në këtë kapërcyell mes dy shekujve të politikës shqiptare. Para së gjithash, skena politike shqiptare gjithandej nuk është e përkufizuar sa duhet mirë. Ka shumë parti politike dhe aktorë të tjerë politikë, të cilët nuk kanë qartësi të mjaftueshme në programin e tyre politik e ideologjik. Në përgjithësi, këta aktorë politikë janë të fokusuar në çështjet ditore e rutinore nga historia e afërt, me improvizime politike e programe deklarative dhe me fushata emocionale, të cilat zakonisht pretendojnë që, nëpërmjet retorikës së ashpër, shpesh nacionaliste a me "flamurin" që valëvit lart për momentin subjektin, të cilit i përkasin, si luftën kundër korrupsionit e kriminalitetit, ta mbulojnë mungesën dhe shterpësinë e ofertave politike. Ndryshe nga prirja e natyrshme dhe tradicionale e politikës shqiptare, shumë rrethana të lidhura me ndikimet e formave autoritare të qeverisjeve dhe okupimeve kanë ndikuar që procesi politik shqiptar të mbetet mbrapa në kuptim të zhvillimit të kapaciteteve politike dhe që

të përshkruhet rrjedhimisht me një mungesë të profesionalizmit, mungesës e të cektësisë së njohurive politike dhe e organizimit bashkëkohor institucional, kryesisht me parti politike të pademokratizuara dhe të pareformuara, si dhe mungesë të lidërshiptit dhe vullnetit politik real (Latifi, 2008: 385). Përderisa prirja e politikës shqiptare gjatë mbarë procesit politik ka qenë e orientuar kah kultivimi i vlerave të partneritetit me kombet e tjera që buron nga parimet e filozofisë politike shqiptare humaniste dhe universale, çuditërisht çështja e partneritetit të brendshëm politik mes aktorëve dhe partive politike shqiptare brenda njëqind viteve të para të procesit politik shqiptar nuk është kultivuar me ndonjë përparësi të veçantë apo sukses gjithandej ku jetojnë shqiptarët. Gjithnjë është vërejtur një hezitim që shkon përtej rivalitetit politik kur rrethanat e kërkojnë dhe e bëjnë të domosdoshme mundësinë dhe interesimin minimal për kultivim të partneritetit politik brenda procesit politik shqiptar që është në kundërshtim me prirjet e përgjithshme dhe historike të politikës shqiptare. Në kalimin nga shekulli i parë në të dytin, procesi politik shqiptar ballafaqohet me sfidat përafërsisht të njëjta themelore të demokracisë liberale që janë bërë kronike edhe për popujt e tjerë ballkanikë dhe më gjerë atë evropian, me sfidat e ngritjes së apatisë politike që më së tepërmi reflektohet me formën e pjesëmarrjes së ulët në zgjedhje, pastaj me forma të ndryshme të dekurajimit dhe frikësimit për pjesëmarrje politike të qytetarëve para dhe gjatë proceseve zgjedhore, me rekrutim dhe përfaqësim të dobët në proceset politike (anomalitë sistematike në aspekt të përfaqësimit cilësor në Qeveri dhe Parlament).

Përderisa kemi marrë inputet bazike sa i takon elementeve përmbajtësore të variablave, komponentëve të diskursit për pyetësorët e shpërndarë, kemi bërë një analizë të përgjithshme me të gjithë komponentët e diskursit politik duke konsideruar se diskursi politik është i zhargonit jo të moderuar, pastaj si i tillë ndikimi në sjelljet sociale dhe

politike të qytetarëve, komponentët e diskursit politik karakterizohen nga dallime për sa i përket influencës së tyre dhe rezultativitetit mbi diskursit politik të liderit shqiptar me disa komponentë duke qenë më shumë influencues dhe rezultativ dhe me disa komponentë të tjerë duke qenë më pak influencues dhe rezultativ, modelimi i diskursit politik është drejt për së drejti i lidhur me kulturën e përgjithshme të vet liderit, ashtu siç edhe shihet nga rezultatet e mostrimit përkatëse dhe të tjera rezultate të nxjerra nga pyetësi me ndërmarrjet konsiderohet se të hipotezat e parashtruara janë vërtetuar.

Lideri e përshtat stilin e tij të lidërshipt sipas tipit institucionit që udhëheq dhe kontekstit situacional të detyrës aktuale. Nga kjo pikëpamje, këta faktorë përkufizojnë limitet dhe gradën e përgjegjshmërisë të cilitdo roli të lidërshipt.

Konceptet e lidërshipt transaksionues dhe transformues ilustrojnë vizionin e lidërshipt më shumë si një marrëdhënie se sa si një aktivitet i vetëm.

Liderët përfaqësojnë stile të ndryshme ku më të shquarat janë ato si drejtorë, motivues, koordinatorë, katalizatorë, zëdhënës dhe manaxherë krizash.

Përfundimisht, një lider luan një rol kryesor në ekuilibrimin e përplasjes së vlerave dhe në zhvillimin e një konsensusi mes vlerave të përgjithshme politike të shoqërisë dhe vlerave të cilat një organizatë ka formuluar për të realizuar synimet e saj.

Nga ana metodologjike ky punim bazohet në zgjedhjen e një rasti studimor siç është shoqëria post komuniste shqiptare duke qenë se Shqipëria mund të konsiderohet një shembull unik ndër vendet e Evropës Lindore e Qëndrore që po hedh pas krahëve një tranzicioni të stërzgjatur e të mundimshmëm në shumë aspekte. Në fakt periudha 1990-e deri më sot në vetvete nuk përbën një fenomen të pahasur dëndur në vendet e tjera që janë karakterizuar nga probleme të ngjashme, por ajo çka i fal veçanti këtij procesi shpesh shqiptar në tipologji, është reflektimi në të i periudhës totalitare, periudhë që në

gjykimin tim i shmanget skemave të regjimeve të tjera totalitare të vendeve që u gjetën pas Perdes së Hekurt. Hulumtimi i rolit të retorikës në ndërtimin e procesit të komunikimit mes politikës dhe publikut është thelbësor për të kuptuar dinamikën e kësaj marrëdhënie. Në ndihmë të këtij hulumtimi më kanë ardhur instrumente antropologjike siç janë intervistat, të cilat së bashku me fjalimet përbëjnë thelbin e analizës së kryer. Analiza e kryer vlen për të kuptuar më mirë të tërë procesin dhe sidomos lidhjet dhe marrëdhëniet e tij me klasën politike. Bëhet fjalë për një proces komunikimi të vendosur në një kuadër të ri si reflektim i marrëdhënieve të reja politiko-shoqërore të instaluara mes medias dhe politikës. Ajo çka kam synuar që në fillim të këtij punimi është kryerja e analizës empirike, analizë kjo që u bazua në dy elemente kryesorë: në intervistat e mara dhe në fjalimet e grupit kampion të ligjvënësve të intervistuar.

Vlerësoj që është e rëndësishme përzgjedhja e grupit kampion të të intervistuarve në një studim empirik dhe unë jam përpjekur të përftoj një të tillë sa më përfaqësues.

Për fat të keq më duhet të pranoj se përpos përpjekjeve, nuk mund të përfshij të tërë spektrin politik shqiptar me gjithë ndarjet e nëndarjet e tij dhe kompleksitetet që përfaqësojnë në grupin e të intervistuarve. Por unë jam udhëhequr nga parimi për të lundruar në mënyrë të balancuar sa më aq djathtas, për të sjellë formulën e përfaqësimit gjinor në politikë, për të mos mbetur peng e centralizimit të politikës në kryeqytet, por për të sjellë edhe refleksin se si shihet politika shqiptare në pasqyrën e komunikimit në të gjithë territorin shqiptar.

Për këtë kam intervistuar ligjvënës nga jugu në veri, nga perëndimi në lindje duke u thelluar edhe në shtresa të ndryshme brenda politikës. Në këtë listë kam përfshirë nga politikanë të karrierës tek “profanët” e politikës duke gjeneruar hipoteza dhe i argumentuar ato, por duke rezervuar gjithmonë të drejtën për të mos përgjithësuar

konkluzione të shtrira në hapësirë dhe në kohë si prerje tërthore e klasës politike shqiptare dhe kjo bëhet duke konsideruar numrin e këtyre intervistave.

Një nga tezat e shtjelluara gjatë këtij punimi është ajo se komunikimi dhe retorika në politikën shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri nuk është zhvilluar ndryshe nga hallkat e tjera të shoqërisë shqiptare. Hap pas hapi kam tentuar të shpalos një panoramë të gjerë të procesit të komunikimit në Shqipëri dhe të elementëve në të cilët bazohemi për ta ndërtuar atë. Teza kryesore ka lidhje me ndikimin e drejtpërdrejtë të retorikës në komunikim dhe të këtij të fundit në politikë duke marrë për bazë në analizën time një grup politikanësh të ndarë në tri rrafsh të ndryshme duke tentuar të zbuloj sa përfaqësues është ky komunikim dhe sa ndikon në zhvillimet politike përfshirë këtu edhe vetë fatin politik të subjekteve në fjalë. Unë nuk kam pretenduar të rindërtoj historinë e këtyre viteve përmes intervistave, por kam dashur të sjell dhe të parashtroj vizionin komunikues të politikës përmes tyre. Pra vlera e shtuar nuk qëndron në interpretimin tim, por në analizën e aktorëve të kohës pa të cilët ky komunikim do të ishte një rrugë vetëm me një drejtim.

Komunikimi nuk është një trup amorf që mund të transplantohet në politikën shqiptare i huazuar nga ndonjë strategji në gjuhë të huaj, ai është një proces shumë kompleks dhe i ndërlikuar, pasqyrues i pagabuar i një shoqërie dhe gjithë problematikës që ajo mbart.

Gjatë këtij punimi është kristalizuar teza se komunikimi dhe retorika në politikën shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit 1990-2009 në Shqipëri nuk është zhvilluar ndryshe nga hallkat e tjera të shoqërisë shqiptare. Unë kam sjellë përmes analizës së situatës së komunikimit në Shqipëri një vështrim të përgjithshëm, vështrim ky që përfshin rolin e medias si pjesë sendërtuese të procesit të komunikimit në shoqërinë

shqiptare pas viteve '90 duke u ndalur në tiparet e komunikimit.

Një kujdes i veçantë i kam kushtuar edhe analizës së funksioneve të medias në procesin e komunikimit duke u ndalur në llojet e komunikimit dhe marrëdhënien mes gjuhës dhe komunikimit. Nuk mund të mbetet jashtë kësaj analize edhe roli që luan feja dhe etnia si elementë të komunikimit në Shqipëri për tu ndalur në marrëdhënien komplekse mes medias dhe politikës. Analiza e impaktit mediatik në mënyrën sesi politikanët kornizojnë pozicionet e tyre në marrëdhënie me publikun pas ndryshimeve politike të viteve '90 është e rëndësishme përderisa studimi i medias na ofron një mënyrë për të deshifruar dhe zbërthyer kuptimin e një shoqërie në kompleks.

Ky është një argument më shumë në mbështetje të tezës së paraqitur më sipër për rolin dhe rëndësinë e medias në procesin e sendërtimit tëproçesit të komunikimit, proces ky që ka llojet e veta dhe nuk paraqitet kurrë linear dhe kurrësesi nuk mund t'i bëjë bisht e të mos ndikohet nga situata e përgjithshme politike, ekonomike dhe sociale që ka përjetuar Shqipëria që prej përmbysjes së regjimit totalitar dhe hyrjes në një proces transformimi shumëplanësh. Transformim ky që synon ndërtimin e institucioneve demokratike, aplikimin e ekonomisë së tregut dhe respektimin e shtetit ligjor ndërthurur me një mori ndryshimesh sociale të lidhura me transformimin e marrëdhënieve familjare edhe në raportin me moralin dhe fenë, elementë këta që nuk kanë kalaur pa lënë gjurmët e tyre.

Shqipëria e viteve 1991 do të përjetonte një ringjallje të mediave që asokohe identifikohesh me shtypin e shkruar dhe roli parësor dhe më thelbësori i medias në shoqërinë post komuniste ishte ai i shprehjes së lirë dhe pa autoçensurë dhe i dëgjimit të lajmeve nga më të larmishmet duke ngopur kështu një mungesë të kahershme duke i dhënë individit një dimension të ri, larg kolektivizmit të forcuar dhe duke ndjellë

dëshirën për të përmbushur atë boshllëk me çdo lloj informacioni, të nevojshëm e të panevojshëm. Një funksion tjetër i rëndësishëm i medias së lirë që prej fillimeve të saj vlerësohet edhe ai i stabilizuesit të një raporti mes publikut dhe politikës në kuptimin e saj më të gjerë.

Në një vend të sapodalë nga një tunel i gjatë dhe i mundimshëm monopartiak, shtypi luan rolin e ndërmjetësit për të trasmetuar dhe qartësuar idetë e reja politike që perthitheshin nga shoqëria e etur shqiptare, e etur për ide të reja, për pluritet mendimi larg klisheve bajate komuniste.

Së treti ia vlen të përmendet edhe roli i medias si një dritare me botën e përtej kufijve. E ngujuar në izolimin e saj absolut, shoqëria shqiptare e viteve '90 shfaqte simptomat e një pacienti klaustrofobik që nuk e nxë më hapësira që ka përreth dhe shfaq dëshirën për t'iu larguar mureve të qelqta të izolimit duke iu dorëzuar nevojës për të zbuluar botën, një mënyrë për të përmbushur në kohë dhe hapësirë atë çka kishin humbur në një gjysëm shekulli, një gjysëm shekulli jo pak i rëndësishëm për sa i përket zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë. Por ana tjetër e medaljes e përballi dëshirën për të zbuluar horizonte të reja me rregullat burokratike që kishte vendosur pjesa tjetër e Evropës për t'i bërë ballë valës së prurjeve nga vendet ish-komuniste.

Në Shqipërinë post komuniste politika mund të analizohet si prodhim i medias dhe në këtë mbrurje të publikut një rol të rëndësishëm luan edhe retorika. Për këtë arsye është trajtuar edhe raporti mes retorikës dhe komunikimit, raport ky që është zbërthyer më tej në të gjithë elementët e tij nga analiza e teksit që u krye në të tre grupet, në të cilat janë klasifikuar politikanët e intervistuar.

Duke qenë se kam dashur të zbërthej evolimin e retorikës dhe si ka ndikuar ky ndryshim i retorikës në procesin e komunikimit dhe si pasojë edhe në karrierën politike

të të intervistuarve, kam preferuar të zgjedh fjalime që datojnë fillimet e karrierës parlamentare për secilin dhe natyrisht edhe fjalime të mbajtuara në legjislaturën e fundit. Vihet re një lloj panorama e ndryshme pasi fillimet e karrierës politike datojnë në kohë të ndryshme për subjektet e përzgjedhura dhe natyrisht edhe kurbat e karrierës së tyre kanë kahe të ndryshme. Ajo çka vihet re është se kurba e karrierës nuk shkon në proporcion të drejtë me moshën apo vjetërsinë në politikë, përkundrazi.

Bie në sy gjatë analizave se ka një ndryshim thelbësor në retorikën dhe si rrjedhim edhe në procesin e komunikimit dhe është kjo mënyrë e ndërtimit të ligjërimit që bën dallimin mes politikanëve dhe peshës së tyre specifike në skenën politike. Në bazë të skemës narrative kanonike që kam përdorur për të analizuar tekstet në shqyrtim (intervistat dhe fjalimet në Parlament), kam konstatuar se në varësi të modalitetit të përdorur më shumë apo që dominon mbi të tjerët përcaktohet edhe lloji i ligjërimit. Duke qenë se tek subjekti i grupit të politikanëve të rrangut të parë modaliteti dominues është ai i aktualizuar (*di, duhet*), edhe lloji i ligjërimit do të determinohet prej tij. Këta elementë janë të pranishëm në intervistën dhe fjalët e Z. Blushi duke e bërë më të zbërthyeshme fazën e tretë të skemës narrative kanonike: performancën. Është tërësia e elementëve të sipërpërmendur, të cilë bëjnë dallimin në performancë duke e lidhur atë me fazën e fundit të skemës që është miratimi. Në bazë të skemës narrative kanonike dal në përfundimin se subjekti në fjalë e ka realizuar programin narrativ për t'u zgjedhur duke fituar edhe miratimin e publikut. Kjo është edhe arsyeja pse subjekti që prej përfshirjes në politikë ka qenë përherë i pranishëm me projektet e tij.

Ndërsa grupi i dytë përfshin fillimisht politikanë me një profil më të ulët politik, por gjithsesi aktivë në jetën politike në rrangje ministrash dhe ish- ministrash. Edhe subjektet e këtij grupi flasin me gjuhë thujtë të unifikuar në princip. Karakterizohen

nga një lloj ligjërimi standard që ka si kryefjalë të tij intergrimin euro-atlantik, ligjërime ky që kushtëzon performancën e tyre duke marrë edhe miratimin e publikut. Edhe në këtë rast programi narrativ është i realizuar dhe subjektet janë aktiv në jetën politike, por gjithësesi si pjesë e projektit të dikujt tjetër pa spikatur elementë lidhshpi si në grupin e parë.

Ndërsa politikanët e grupit të tretë karakterizohen nga fakti që të gjithë deputetët e këtij grupi janë për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk janë rizgjedhur në legjislaturën vijuese. Një tipar tjetër që karakterizon shumicën e intervistave dhe diskutimet e tyre në Kuvend është partizanizmi dhe tifoja politike që bëjnë, një prirje që në shumicën e rasteve bazohet në fraza të fryra emfatike, që vënë në shënjestër kundërshtarin politik dhe karakterizohen nga një kahje e fortë politike dhe në disa rastë ka veprim “Ilustrues” e lajkatar ndaj liderit politik të partisë përkatëse.

Vlen për t’u përmendur shumëllojshmëria e profesioneve fillestare, poetë, regjizorë, inxhinjerë që katapultohen në politikë pa ndonjë meritë të vecantë në këtë fushë. Për rrjedhojë edhe programi narrativ i tyre do jetë i çalë, ata nuk kanë një ambicje të fortë për t’ia përcjellë publikut pasi nuk ndiejnë të kenë bërë investime në këtë fushë. Në ndryshim nga subjekti i analizuar në grupin e parë të politikanëve, por edhe nga grupi i dytë, grupi i tretë i subjekteve që kemi në shqyrtim nuk flet jo vetëm për projekte, por gati gati ka humbur entuziasmin për të qenë edhe pjesë e një projekti të dikujt tjetër. Afër finishit të legjislaturës, ndihet një “ftohje” e tyre me politikën dhe me sa duket jo rastësiht asnjë prej tyre nuk është rizgjedhur në legjislaturën e re.

Duke përfunduar këtë analizë dua të theksoj se ajo çka bie në sy është rritja e numrit të deputetëve të intervistuar në proporcion të zhdrejtë me rëndësinë e tyre në politikë duke sjellë këtu shembullin e numrit minimal të subjekteve të intervistuar në grupin të

parë dhe numrin më të madh në grupin e tretë.

Ajo çka konkludoj është se retorika është e lidhur ngushtë me procesin e komunikimit dhe ky i fundit luan një rol kyç në politikën shqiptare duke përcaktuar edhe (mos)suksesin e subjekteve të analizuar.

Pra nuk është rastësi përputhja e realizimit të programit narrativ me progresin e tyre në politikë dhe këtu dua të veçoj diferencimin që ben analiza e fazës së kompetencës nëpërmjet identifikimit të modaliteteve dhe klasifikimi i ligjërimit sipas dominimit të njërit prej tyre. Gjithsesi në funksion të objektivave të komunikimit sugjerohet një lloj ligjërimit politik që të jetë i kuptueshëm dhe afër publikut dhe kjo bëhet edhe nëpërmjet përdorimit të dialekteve si shenjë e shkrirjes së akujve. Gjuhë e thjeshtë, e kuptueshme, me leksik të pastër e sintakse elastike që sintetizon ide sa më të thjeshta larg abstraktës si tipare të një ligjërimi të kuptueshëm dhe të pranueshëm, por që gjithsesi nuk e humbet përmbajtjen dhe elokuencën në përputhje me nivelin intelektual të subjektit.

BIBLIOGRAFIA

1. Adams, V. (1986) *Ihe Media and the Falklands Cam-paign*, London: Macmillan
2. Beha A. (2009) *Demokracia dhe komunikimi politik*, Revistë shoqërore e politike: trendet.net
3. Ajeti I. (1980) *Gjuha dhe mjete e informimit në “Çështje të nomës letrare”*, Prishtinë
4. Doja A. (1999) *Etniciteti, ndërtimi kombëtar dhe nacionalizmi në territorin etnik shqiptar: qasje antropologjike e konfliktit të marrëdhënieve ndëretnike*, *Ethnologia Balcanica: The Journal for Southeast European Anthropology*, New York: Waxman Verlag
5. Anderson, A.(1997), *Media, Culture and the Environment*, London, UCL Press
6. Ansolabehere, S., Iyengar, S. (1995), *Going Negative*, New York, Free Press
7. Ramadani A (2010), *Karakteristikat e një lloj lideri*, albaniapress. com
8. Hanah A., (1998) *Between Past And Future*, Tiranë, Onufri
9. Hanah A., (1998), *The Human Condition*. Chicago: University of Chicago Press
10. Fuga A. (2008), *Brirët e Dhisë*, Tiranë, Ora Botime
11. Fuga A., (2001) *Ikja nga kompleksi i Rozafës*, Pejë, Dukagjini
12. Fuga A., (2003) *Les mots dans la communication politique en Albanie*, Paris, L'Harmattan
13. Fuga A., (2003), *Majtas jo djathtas*, Tiranë, Ora Botime
14. Fuga A., (2008), *Media, politika, shoqëria*, Tiranë, Botime Dudaj
15. Fuga A., (2007), *Rrota e Mundimit*, Tiranë, Botime Dudaj
16. Fuga A., (2004), *Shoqëria periferike*, Tiranë, Ora Botime
17. Arterton F., (1984), *Campaign Organisations Confront the Media-Political Environment*, in Graber, B., *Media Power in Politics*, Washington, CQPress
18. Baerns, B., (1987), *Journalism Versus Public Relations'*, in Paletz, ed., *Political Communication Research: Approaches, Studies, Assessments*, Norwood, Ablex
19. Bagdikian, B. 1984, *Journalist Meets Propagandist'*, in Graber, ed., *Media Power in Politics*, Washington, CQPress

20. Barnett, S., Gaber, I. 2001, *Westminster Tales*, London
21. Baudrillard, J., 1983, *In the Shadow of the Silent Majorities*, New York, Cambridge, Polity Press
22. Bejleri, R., 2003, *Standardi gjuhësor në emisionet shqip të Radio Bullgarisë, në "Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë
23. Bennet, W. Lance, Entman, Robert M., 2001, *Mediated Politics: Communication in the Future of Democracy*, Cambridge University Press
24. Beqja I. 2009, *Situatën e vështirë ekonomike të vendit nuk do t'a përmirësoj as ndryshimi në*
25. Berger, P. 1976, *"Fjalët dhe mënyrat e veprimit"*, Koln
26. Berger, P., 2001, *Holy War*, New York, Simon & Schuster
27. Bernays, L., 1923, *Crystallizing Public Opinion*, New York, Boni and Liveright
28. Bloom, M., 1973, *Public Relations and Presidential Campaigns*, New York, Thomas Crowell
29. Bobbio, N., 1987, *The Future of Democracy*, Cambridge, Polity Press
30. Bolton, R., 1990, *Death on the Rock and Other Stories*, London, W. H. Allen
31. Bolland, E. J., 1989, *Advertising v. Public Relations'*, in *Public Relations*
32. Boorstin, D. J., 1999, *The Image*, London
33. Borici H., Bala V., 2008, *Gazeta "Flamuri i Shqipërisë"(1915-1916) zë në FESH*, Tiranë
34. Boriçi H., 1997, *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997) BPB*, Tiranë
35. Bruce, B., 1992, *Images of Power*, London, Kogan Page
36. Buda, A., 2008, *Anastas Byku, zëri në FESH*, Tiranë
37. Butler, D., Kavanagh D., 1988, *The British General Election of 1987*, London, Macmillan; *The British General Election of 1992*, London, Macmillan
38. Mayer C., 2003, *Politikat Krahasese*, Tiranë
39. Campbell, D., 1983, *War Plan UK*, London, Paladin
40. Carter McNamara, 1999, *General guidelines for conducting interviews*, Minnesota.

41. Chagall, D., 1981, *The New Kingmakers*, New York
42. Chambers, S., Costain, A., 2001, *Deliberation, Democracy and the Media*, London, Rowman & Littlefield
43. Chilton, Paul, 2004, *Analysing political discourse. Theory and praxis*. London, Routledge
44. Chippindale, P., Harrie, C., 1988, *Disaster the Rise and Fall of the News on Sunday*, London, Sphere
45. Chomsky, N., Herman, E., 1988, *Manufacturing Consent*, New York, Pantheon
46. Cloude, Lefort, 1993, *Demokracia dhe Totalitarizmi*, Tiranë, Arberi
47. Cockerell, M., 1988, *Live from Number 10*, London, Faber; Cockerell, M., Hennessey, P., Walker, D., 1984, *Sources Close to the Prime Minister*, London, Macmillan
48. Çabej, E., 1963, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes*, Tiranë
49. Çabej, E., 1981, *Për pastërtinë e gjuhës, "Gjuha jonë"*, Tiranë
50. Çeliku, M., 1969, *Çështje të normës morfologjike në letërsinë artistike pas Çlirimit*, Tiranë
51. Dibra K., 2005, *Kultura e të shkruarit në gazeta, në "Gjuha shqipe*, Prishtinë
52. Dodi, A., 1985, *Gjuha e folur letrare dhe norma e saj fonetike në etapën e sotme, "Gjuha jonë"*, Tiranë
53. Goldstein J. G., 2003, *International Relations*, Tiranë, Dituria
54. Graber, D. A., 1981, 'Political Language', in Nimmo and Sandcrs, eds, *Handbook of Political Communication*, Beverly Hills, Sage; *Mass Media and American Politics*, Washington, CQPress, 1984
55. Graber, D. A., 1984, *Media Power in Politics*, Washington, CQPress
56. Greenaway, J., Smith, S., Street, J., 1992, *Deciding Factors in British Politics*, London, Routledge
57. Gripsund J., 1992, *Aesthetics and the Politics of Melodrama*, in Dahlgren and Sparks, *Journalism and Popular Culture*, London, Sage
58. Habermas, J., 1989, *The Structural Transformation of the Public Sphere*, Cambridge, Polity Press

59. Halimi, M., 1983, *Mbi disa kalke në shtypin tonë dhe në mjete të tjera të informimit, "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe"*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës
60. Ilazi H., 2013, *Instituti Për Studime Sociale Dhe Humanistike*, Prishtinë, Njohja
61. Hoffmann, Hilmar, 1984, *Deutsch global. Neue Medien*, Koln
62. Vorpsi I., 2009, *Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik, Individuelles Masterstudium: Global Studies – a European Perspective*, Wien
63. Jäger S., 2001, *Kritische Diskursanalyse. Eine Einführung*, Duisburg, DISS
64. Jäger S., Link J., 1993, *Die vierte Gewalt. Rassismus und die Medien*, Diss
65. Jane R. dhe Jane L., 2003, *Qualitative Research Practice*, Sage, London
66. Gabszewicz J., Sonnac N., 2006, *L'industrie des medias*, Paris, Edition La Decouverte
67. Tenscher J., 1998, *Theorien, Trends Perspektiven në: Ulrich, Sarcinelli (Hg.), Politikvermittlung, und Demokratie, in der Mediengesellschaft*, Bonn
68. Killingsworth J., 2005, *M. Appeals in Modern Rethoric*, Southern Illinois University Press
69. John Keane J., 1991, *The Media and Democracy*, Polity Press and Blackwell Publishers
70. Jubani, A., 2012, *Fonetka akustike e shqipes*, Tiranë
71. Julia T. Wood, 2007, *Interpersonal Communication*, Wadsworth/Boston
72. Kostallari, A., 1973, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe drejtshkrimi i saj*, Tiranë
73. Kostallari, A., 1985, *Gjuha letrare shqipe, "FSHE"*
74. Krasniqi M., 2007, *Histori i gazetarisë shqiptare*, Prishtinë
75. Kress, G., 1993, *Against arbitrariness: The social production of the sign as a foundational issue in Critical Discourse Analysis*, në *Discourse & Society*, London
76. Kuçi V., 2002, *Kultura e të folurit në televizion (RTK, TV21, KTV), në "Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhësinë, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë
77. Lafe, E., 1973. *Probleme dhe detyra në fushën e kulturës së gjuhës, në "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës"*, Tiranë
78. Lafe, E., 2000, *Gjuha e medias sot-probleme dhe detyra, "Gjuha jonë"*, Tiranë

79. Magdalini V., 2013, *Çështje të zhvillimit të aftësive të drejtimit në arsimin Shqiptar mbas viteve '90*, Universiteti i Tiranës, Tiranë
80. Mansaku, S., 2000, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes, "Gjuha jonë"*, Tiranë
81. Pozzato M. P., 2008, *Semiotika e tekstit*, Tiranë, UET Press
82. Marinesku. A., 2000, *Kodi i sjelljeve të pëlqyeshme sot*, Tiranë
83. McLuhan M., Fiore Q., 1967, *The Medium is the Message*, London, Penguin Books
84. Mauro de T., 2000, *Il dizionario per la lingua italiana del terzo millennio*, Torino, Pavia, Bruno Mondadori
85. Mc Lean, 1996, *The Concise Oxford Dictionary of Politics*, OUP
86. Giovannetti P., 2004, *Retorica dei Media*, Milano, Edizioni Unicopli
87. Watzlawick P., 1978, *La realite' de la realite': confision, disinformation, communication*, Paris, Editions du Seuil
88. Perti J. Pelto, Gretel H. Pelto, 1978, *Anthropological Research. The structure of inquiry*, Cambridge University Press
89. Popkin, S., 1991, *The Reasoning Voter*, Chicago, University of Chicago Press
90. Poulantzas, N., 1975, *Classes in Contemporary Capitalism*, London, New Left Books
91. Pusey, M., 1978, *Jurgen Habermas*, London, Tavistock
92. *Raporti i Qendrës Shqiptare për Monitorimin e Medias (QSHMM) 25 shtator 2006*
93. *Revista filozofike dhe sociologjike "Thema"*, nr. 11, 1993.
94. Richard A. Krueger, 1998, *Moderating focus groups*, Thousand Oaks, CA
95. Robins, K., Webster, F., 1985, *The Revolution of the Fixed Wheel': Information, Technology and Social Taylorism'*, in Drummond and Paterson, eds, *Television in Transition*, London
96. Barthes R., 2008, *Aventura Semiologjike*, Dukagjini/Pejë
97. Rosenbaum M., 1997, *Soapbox to Soundbites*, London, Paigraive, Diacmillan
98. Rosenberg, S., McCafferty, P., 1987, *'The Image and the Vote: Manipulating Voter's Preferences'*, *Public Opinion Quarterly*
99. Sabato, L., 1981, *The Rise of Political Consultants*, New York, Basic Book
100. Scannell, P., Cardiff, D., 1991, *A Social History of British Broadcasting*, Oxford,

Basil Blackwell

- 101.Schiller, H., 1984, *Infornzation and the Crisis Economy*, Norwood, Ablex.,
Schlesinger, P., 1987, *Putting Reality Together*, London, Viethuen,. 1989,
'*Rethinking the Sociology of Journalism*', in Ferguson, ed., *Public Communication*,
London, Sage
- 102.Schlesinger, P., Tumber, H., 1994, *Reporting Crime: The Media Politics of Criminal
Justice*, Oxford, Clarendon Press
- 103.Schnrid, A., de Graaf, J., 1982, *Violence as Communication*, London, Sage
- 104.Schumpeter, J., 1950, *Capitalism, Socialism and Democracy*, New York
- 105.Silvester, C., 1993, *The Penguin Book of Interviews*, London, Viking
- 106.Sparks, C., 1992, *Popular Journalism: Theorics and Practices*, in Dahlgren and
Sparks, eds, *Journalism and Popular Culture*, London, Sage
- 107.Kvale S., 1996, *Interviews: A Introduction to Qualitative research Interviewing* Sage
Publications, Thousand Oaks California
- 108.Steinberg, C., 1958, *The Mass Communicators*, Westport, Greenwood Press,. Street,
J., 2001, *Mass Media, Politics and Democracy*, Houndmills, Palgrave
- 109.Shaw, E., 1994, *The Labour Party Since 1979: Crisis and Transformation*, London,
Routledge
- 110.Rrokaj Sh., 2012, *Mediatizimi i Historisë Dhe Historia E Medias*, ISSN: 2305-3828
- 111.Shkurta, Gj., 2003, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë
- 112.Shkurta, Gj.: 2006, *Kultura e Gjuhës*, SHBLU, Tiranë
- 113.Shkurta, Gj.: 2006, *Kundrime Gjuhësore*, Pegi, Tiranë
- 114.Shkurta, Gj.: 2006, *Überblick über die Entwicklung der Soziolinguistik in Albanien*,
Int'l.J.Soc. Lang
- 115.Shyles, L., 1986, *Televised Political Spot Advertisemene*, in Kaid et al., eds, *Vezu
Perspectives on Political Advertising*, Carbondale, Southern Illinois University Press
- 116.Balla, T., 2014, *Programi i NDI për Menaxhimin Politik, Politikani i Ri*, Prishtinë
- 117.Taylor, P., 1992, *War and the Media: Propaganda and Persuasion in the Gulf War*,
Manchester, Manchester University Press
- 118.Wengraf T., 2001, *Qualitative Research Interviewing. Biographic Narratives and
Semi-structured Methods*, Sage: London

119. Van Dijk, 1993, Teun, *Denying racism. Elite discourse and racism*. Në: *Racism and migration in Western Europe*. Oxford: Berg
120. Van Dijk, Teun, 1993, *Principles of critical discourse analysis*, Discourse & Society, London
121. Wayne Booth, 2004, *The rhetoric of Rhetoric. A Quest of Effective communication*, Blackwell Publishing, Oxford
122. Wodak, Ruth, Rudolf/Reisigl, Martin/Liebhart, Karin, 1999, *The discursive construction of national identity*. Edinburgh: Edinburgh University Press
123. Xhuvani, A., 1973, *Mbi thjeshtesinë e gjuhës, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës"*, Tiranë
124. Pango, Y. *Lidershipi. Profile psikologjike, liderët shqiptarë*, hermesnews. Org
125. Pango, Y. 2014, *Marrëdhëniet mes politikanëve; urrejtja në politikë*, mapo. Al
126. Çavo, Z. 2009, *Cilësitë personale të liderit*, Gazeta Shqip,
127. Degrand, A. *Suvenirs de la Haute Albanie*, Paris, 1901
128. Dida, A. 1996, *Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë*, Prishtinë
129. Elezi I, Kaçupi S, dhe Haxhia M. 1997, *Komentar i kodit penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë
130. Elezi, I. 1999, *Historiku i dënimit me vdekje në Shqipëri*, Tiranë
131. Elezi, I. 1989, *Krimet kundër jetës*, Tiranë
132. Gashi, R. 2003, *Politika ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989*, Prishtinë
133. Hadri , A. 1968, *Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941), Separat nga gjurmime Albanologjike*, Prishtinë
134. Hadri, A. 1971, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë
135. Halili, R. 1983, *Kushtet dhe faktorët social dhe individual të paraqitjes së krimit të vrasjes dhe dukurisë së gjakmarrjes*, Përparimi nr.4, Prishtinë
136. Halili, R. 2010, *Penologjia*, Prishtinë
137. *Historia e popullit shqiptar I*, Prishtinë, 1968

138. *Historia e popullit shqiptar II*, Prishtinë, 1968
139. Hoxha, H. 1970, *Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë*, Përparimi, nr.5. Prishtinë
140. Imbert, Jean, Levasseur, Georges, 1972, *Le povuoir, les juges et les burreaux*, Paris
141. Ismaili, H. 1971, *Besa u običajnom pravu Albanaca, Gjurmime Albanologjike*, nr.1. Prishtinë
142. Kaleshi, H., Dermaku, I., 1971, *Dokumente nga Arkivi i Vjenës mbi lidhjen e Pejës*, Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr.4-5, Prishtinë
143. *Kanune (vendime) të veçanta, Referate e kumtesa*, Tiranë, 1965
144. Krasniqi, M. 1963, *Savremene društveno-ekonomske promene na Kosovu i Metohiji*, Priština
145. *Krimet e Luftës në Kosovë gjatë vitit 1998-1999, Këshilli për Mbrotjtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut*, Prishtinë, 2010
146. Lazarević, L. 2006, *Komentar Krivičnog Zakonika Republike Srbije, Savremena Administracije, Beograd*
147. Milosavljević, M. 2000, *Seksualno nasilje nad djecom*, Sarajevë
148. Nova, K, 1965, *Zhvillimi historik i gjykimit në Shqipëri, Referate e kumtesa*, 1. Tiranë
149. Nushi, P. 1996, *Psikologjia*, Prishtinë
150. Nušić, B. 1902, *Kosovo, opis zemlje i naroda*, Novi Sad
151. Palaj, B. 1944, *Mbi kanunin e maleve, "Studime e tekste"* Dega I, Juridik, nr.1. Romë
152. Pupovci, S. 1972, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë
153. Pushkolli, F. 1977, *Lëvizja revolucionare dhe lidhja e sindikatave të Kosovës, 1919-1975*, Prishtinë
154. Qoba, L. 1963, *Kanuni Shqipëtarë sipas një dorëshkrimi të vitit 1868*, Drejtësia Popullore, nr.5, Tiranë
155. *Relacione mbi gjëndjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII, II*, Tiranë, 1965
156. Rexha, I. 1971, *Një dokument arkivor mbi pajtimin e gjaqeve midis fiseve të Gashit dhe të Shalës më 1890*, Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr.IV-V, Prishtinë

- 157.Rizaj, S., 1971 *Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr.4-5, Prishtinë, 235-236, dokument i shekullit XVIII ku flet mbi kufizimin e bjeshkëve të Deçanit si dhe mbi popullsinë e Deçanit, Lloçanit, dhe Carrabregut*
- 158.Rizaj, S. 1965 *Upravljanje majdanima na Kosovu i Metohiji i susednim krajevima za vreme turske vladavine, Godišnjak, Arhiva Kosova, br.1, Priština*
- 159.Rrahimi, Sh. 1969, *Vilajeti i Kosovës, Prishtinë*
- 160.Collins, C.A., 1992, 'Ma Anand Sheela: Media Power through Radical Discourse', in King, ed., *Postmodern Political Communication*, London, Praeger
- 161.Kuhn, D., 1991, *The skills of the argument*, Cambridge University Press
- 162.*Deklaratë për shtyp e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (01.08.2009)*
- 163.Dieckmann, W., 1969, *Sprache in der Politik. Einführung in die Pragmatik und Semantik der Politischen Sprache*, Carl Winter Universitätsverlag, Heidelberg
- 164.Edward P. J. Corbett, Robert J. Connors, 1999, *Classical Rhetoric for Modern Student* (4th ed. New York dhe Oxford: Oxford U. Press
- 165.Corner J. dhe Pels D., 2003, *Media and the Restyling of politics: Consumerism, Celebrity and Cynicism* W. Lance Bennet, *Lifestyle Politics and Citizen Consumers: Identity, Communication and Political Action in Late Modern Society*, Sage, London
- 166.Toska E., 2012, "Avokati I Popullit – Institucion Kushtetues", Universiteti i Tiranës, Tiranë
- 167.Pedler, E. 2002, *Sociologie de la Communication*, Edition Berytand Dreytuss, Nathan
- 168.Wodak, Ruth., 2006, *Critical Linguistics and Critical Discourse Analysis , në Handbook of Pragmatics*. Amsterdam u. a. : John Benjamins
- 169.Fairclough, N.; Wodak, R., 1997, *Critical discourse analysis, në T. Van Dijk (Hg.): Discourse. Studies: A Multidisciplinary Introduction. Vol. 2. London, Sage*
- 170.Fairclough, Norman, 2005, *Critical Discourse analysis, në: Marges linguistiques. M. L. M. S. Numéro 9, Saint Chamas*
- 171.Fairclough, N., 1992, *Discourse and social Change*. Cambridge: Polity Press
- 172.Fairclough, N., 2003, *Political Correctness: the Politics of Culture and Language, në Discourse & Society Volume: 14, Issue: 1, Sage Publications*
- 173.Ajeti, F., Machiavelli, N.: *Etika dhe politika: ndarja e etikës nga politika, Trendet. net, Revistë shoqërore e politike*

- 174.Ramadani, F., 2010, Politikanët shqiptarë dhe humbja e komunikimit me popullin, kosova-sot. Info
- 175.Ferraj, H., 2004, *Shkenca Politike*. Pegi, Tiranë
- 176.Fjala e Presidentit Topi në mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë
- 177.Giovanni, S., 1998, *Edhe Një Herë Për Demokracinë*. Dituria, Tiranë
- 178.Golding, P., Murdock, G., Schlesinger, P., 1986, *Communicating Politics*, Leicester, Leicester University Press
- 179.Meyer, T., Hinchman, L., 2002, *Media Democracy: How media colonize politics*, Cambridge Polity Press
- 180.Tiffen, R., 1989, *News and Power*, Sydney, Allen Unwin,. — *Scandal, Media, Politics and Corruption in Contemporary Australia*, Sydney, University of New South Wales
- 181.Van Dijk. Teun, 1991, *The interdisciplinary study of news as discourse*, në K. Bruhn-Jensen & N. Jankowski (Eds.), *Handbook of Qualitative Methods in Mass Communication Research*. London: Routledge
- 182.Wodak Ruth 2001: *What, CDA, is about. A summary, of its history important, concepts, and its, developments*. In: Wodak, Ruth/Meyer, Michael (Hrsg.): *Approaches to Critical Discourse Analysis*. London
- 183.Sabato, L., 1981, *The Rise of Political Consultants*, New York, Basic Books
- 184.Scammell, M., 1995, *Designer How Elections are Won*, London, Macmillan
- 185.Scannell, P., Cardiff, D., 1991, *Social History of British Broadcasting*, Oxford, Basil Blackwell
- 186.Seymour Ure, C., 1989, *Prime Ministers' Reactions to Television', Media, Culture and Society*
- 187.Hollstein, S., 2006, *Qualitative Netzwerkanalyse. Konzepte, Methoden, Anwendungen*, GWV Fachverlage GmbH, Wiesbaden
- 188.Van Dijk, Teun, 1997, *Discourse Studies. A multidisciplinary introduction*. London, Sage
- 189.Grandi, R., Vaccari, R., 2007, *Elementi della comunicazione politica*, Carocci,Roma
- 190.Richard A. Cherwitz, James W. Hixson, 1986, *Communication and Knowledge: An Investigation in Rhetorical Epistemology*, University of South Carolina Press

191. *Read Me, Arti i Të Votuarit*, Prill 19, 2013
192. Blumler, J., 1987, 'Election Communication and the Democratic Political System', in Paletz, ed., *Political Communication Research: Approaches, Studies, Assessments*, Norwood, Ablex
193. Simmons, H., Ylechliling, E., 1981, '*The Rhetoric of Political Movements*', in Nimmo and Sanders, eds, *Handbook of Political Communication*, Beverly Hills, Sage

SITOGRAFIA

1. Fjala e Ilir Metës mbajtur në Shkodër 03.03.2009: <http://www.24-orë.com/mobile/politika/2720.html>
2. Lubonja F., Dilemat e Operacionit Antidrogë: <http://perpjekja.blogspot.com/>
3. Adela Halo, Karakteristika të ligjëritimit politik në Shqipëri, 24 Janar, 2013, <http://al.ejo-online.eu/> (11. 01. 2015)
4. http://ps.al/index.php?option=com_content&task=view&id=2540&Itemid=161
5. <http://www.cec.org.al/2004/veprimtaria/2009/Gusht>
6. http://www.facebook.com/note.php?note_id=62271892053http://ps.al/index.php?option=com_content&task=view&id=2314&Itemid=74
7. http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/CivilSocietyAndMedia/2006/shtator/Rap_Med.html
8. http://www.freedomhouse.org/uploads/fop/2009/FreedomofthePress2009_tables
9. <http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11164>
10. <http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11084>
11. <http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=9529>
12. <http://www.minfin.gov.al/>
13. <http://www.president.al/shqip/info.asp?id=5102>
14. <http://www.top-channel.tv/rrethnesh.php>
15. <http://www.youtube.com/watch?v=fD7LZcbI-D8>
16. <https://randodevole.wordpress.com/2014/04/13/sharja-ne-politike-ii/>
17. https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&cad=rja&uact=8&ved=0CB8QFjAA&url=http%3A%2F%2Fdata.planetar.edu.al%2Ffiles%2FLEKSIONET%2520soc%2520politike306.docx&ei=rxveVIGYBoSxafDdgtAD&usq=AFQjCNG_RhfTeuoXeYhC4obuOFZë_4Yiaë&sig2=TnhdfSRbD6piC3hiTOl31g&bvm=bv.85970519,d.d2s

18. Smith, Adam. The Wealth of Nations,
<http://www.bibliomania.com/2/1/65/112/frameset.html>
19. Smith, Adam. *The wealth of Nations* <http://www.bibliomania.com/2/1/65/112/frameset.html>
20. Programi i qeverisë <http://www.mfa.gov.al/shqip/programi.asp>